



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në:

“Trajner i Përgatitjes Fizike”

Universiteti i Sporteve të Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Asc.Dr. Irena KOLA

Prof.Asc.Dr.Roland ÇEREPI

Nëntor / 2023

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Master Profesional në: “Trajner i Përgatitjes Fizike”

1	IAL aplikues:	Universiteti i Sporteve të Tiranës
2	Njësiabazëqë e ofron:	Departamenti i Sporteve Individuale
3	Emërtimi I programitstudimit:	Master Profesional në: “ Trajner i Përgatitjes Fizike”
4	Urdhëri/VKM I licencimit:	Urdhër i MASR Nr.355, datë, 17.09.2021
5	Urdhëri/VKM I riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA I akreditimit të parë:	-
8	Cikli I studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik (2 semestra)
10	Kreditetnë total (ECTS):	60 kredite ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shënoemërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7(shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	17 PAE / 0 PAK
18	Numri i studentëve:	18 studentë
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Sporteve, Tiranë është një Institucion publik i Arsimit të Lartë i krijuar me VKM Nr. 123 Prot. datë 17.02.2010 dhe i akredituar me VBA Nr. 2, datë 07.01.2022. Ky Universitet është hapur bazuar në Akademinë e Edukimit Fizik dhe Sporteve “Vojo Kushi” që prej vitit 1960. Dega e Edukimit Fizik ku ky Institucion ka zanafillën vjen që prej vitit 1958 bazuar në Institutin e “Histori Filologjisë”. Vendimi Nr. 57, datë 29.1.2020 “PËR DHËNIEN E STATUSIT TË VEÇANTË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS SI INSTITUCIONI I VETËM PUBLIK I ARSIMIT TË LARTË NË FUSHËN E SPORTIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” i jep status të veçantë këtij institucioni. Programi i studimit Master Profesional në: “Trajner i Përgatitjes Fizike” është hapur me Urdhër të MASR Nr.355, datë, 17.09.2021. Ky program studimi kalon procesin e akreditimit për herë të parë, ndërsa Institucioni është i akredituar nga ASCAL për një periudhë 6 (gjashtë) vjeçare deri më 06/01/2028. Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes ka në përbërje të vet tre departamente:

1. Departamenti i Sporteve Kolektive;
2. **Departamenti i Sporteve Individuale;**
3. Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit;

Departamenti i Sporteve Individuale; i cili ofron programin e studimit Master Profesional në: “Trajner i Përgatitjes Fizike” në vitin akademik 2022-2023 ka në përbërjen e vet 10 personel akademik efektiv (PAE), nga ku: 2 me Titullin “Prof.Dr.”, 3 me Titullin “Prof.As.”, 3 me gradën “Doktor Shkencash”, dhe 2 me Master Shkencor, ndërsa numri i personelit akademik me kontratë (PAK) është 1 me Master Shkencor. Programi i studimit ofrohet sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe për të fituar këtë diplomë duhen 60 kredite (ECTS). Kohëzgjatja e studimeve është 1 vit akademik dhe forma e studimit është me kohë të plotë. Programi i studimit Master Profesional në: “Trajner i Përgatitjes Fizike” është në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015 si dhe aktet nënligjore.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master Profesional në: “Trajner i Përgatitjes Fizike” ofrohet nga Departamenti i Sporteve Individuale, Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes në Universitetin e Sporteve të Tiranës, filloi me marrjen e dokumentacionit të ofruar nga intitucioni, si dhe ndarjen e punës për përgatitjen e pyetjeve dhe kërkesave për dokumentacion shtesë. ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Universiteti i Sporteve, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm.

Në kuadër të procesit të vlerësimit të jashtëm është përgatitur agjenda nga ASCAL dhe është kryer vizita në datat 20-21 Qershor 2023. Dy ekspertët e përzgjedhur shoqëroheshin nga një specialist i ASCAL. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof.As. Irena Kola dhe Prof.As. Roland Çerepi. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm, ky grup pune u asistua edhe nga Koordinatorja Teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli.

Bazuar në agjendën e përgatitur nga ASCAL u zhvilluan takimet me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe të Njesisë Bazë, grupin e vlerësimit të brendshëm, anëtarë të stafit akademik dhe studentët. Duke patur parasysh që GVB si dhe stafi akademik ishin të njëjtit persona u vendos që të zhvillohej një takim dhe jo dy të ndryshëm. Paralelisht, u zhvillua vizita në sekretarinë mësimore si dhe në ambientet e Fakultetit. Gjatë vizitës në Fakultet u panë klasa, laboratorë të ndryshëm si dhe biblioteka.

GVJ zhvilloi takime me përfaqësues të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Arkiv/Protokollit ku diskutoi mbi çështje të ndryshme ndërsa më pas zhvilloi një takim ku merrnin pjesë përfaqësues të Drejtorisë Juridike dhe i Zhvillimit të Kurrikulave, dhe përfaqësues të Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe Studentët. Me përfundimin e takimeve, GVJ takoi Drejtuesin e Departamentit ndërsa eksperti i ASCAL do të informonte koordinatoren Institucional mbi disa dokumenta shtesë. Në përfundim të vizitave, ekspertët në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, takimeve të zhvilluara si dhe vizitës në ambientet e Institucionit hartuan Raportin e Vlerësimit të Jashtëm.

Universiteti i Sporteve të Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 25.10.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 64 / 21 Prot, datë 25.10.2023. Universiteti i Sporteve të Tiranës përcjell në ASCAL më datë 01.11.2023, me anë të shkresës me Nr. 2788/2 Prot, datë 30.10.2023, “Mbi Raportin e Vlerësimit të Jashtëm”, ku konfirmon dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në: “Trajner i Përgatitjes Fizike”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti i Sporteve të Tiranës ofron programe studimi në përputhje me interesat kombëtare. UST i themeluar që prej vitit 1960 ka respektuar dhe ruajtur interesat kombëtare. UST operon duke respektuar ligjin e arsimit të lartë. Kjo reflektohet në Statutin e Universitetit, Rregulloren e Universitetit si dhe në programin e studimit Master Profesional në “Trajner i Përgatitjes Fizike”, të cilët respektojnë ligjin e arsimit të lartë. Programi i studimit është një program bashkëkohor që ruan vlerat akademike dhe kulturore kombëtare. Në Statutin e UST është e shprehur se veprimtaria e institucionit bazohet në Kushtetutën e Shqipërisë dhe Ligjin Nr 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. <i>Ref.1.Neni 35/1.2 (sfondi)Ligji LAL;</i> <i>Ref.2. Statuti UST-së;</i> <i>Ref.7, Neni 3 Programi i studimit;</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Master Profesional në: “Trajner i Përgatitjes Fizike” është një program që zbatohet për herë të parë në universitetet shqiptare dhe si i tillë është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit,si dhe fushën e veprimtarisë së tij që përputhen me kërkesat e tregut të punës. Objektivat për përbushjen e këtij qëllimi të rëndësishëm, janë të mirë përcaktuara në Nenin 48/123 të rregullores, si dhe Neni nr.7 i statutit të UST-së,që mundësojnë përgatitjen e studentëve me kompetencat, dhe aftësitë e nevojshme profesionale, që duhet të ketë në përfundim të programit studenti i diplomuar. <i>Ref.2. Neni 7 Statuti UST-së;</i>

	<p><i>Ref.3 Neni 48/ 1,2,3 rregullore e UST-së;</i> <i>VIZITA në UST</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Programi i studimit është në përshtatje dhe në zbatim të Planit Strategjik të menaxhimit të UST-së, Statutit dhe Rregullores së Institucionit, për përgatitjen e specialistëve të aftë, që i përgjigjen tregut të punës dhe sfidave e perspektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. UST është përgjegjëse për ofrimin e të gjitha programeve të studimit në fushën e edukimit fizik e sporteve, aktivitetit fizik për shëndetin, rekreacionit e rehabilitimit si dhe menaxhimit sportive. Programi i studimit është në përshtatje me statutin e UST.</p> <p><i>Ref. Nr. 2.1, Plani strategjik i UST;</i> <i>Ref. Nr. 2, Statuti i UST, neni 10;</i> <i>Ref. Nr. 3, Rregullorja e UST, neni 4;</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i ciklit të dytë të studimit, Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike”, është konceptuar dhe hartuar në përputhje me strategjinë e rritjes dhe të zhvillimit të vetë UST-së, që parashikon hapjen e programeve të reja të studimit. Hapja e këtij programi të ri studimi është në harmoni me strategjitë kombëtare të zhvillimit, të cilat përputhen jo vetëm me interesin kombëtar, por edhe me prirjet rajonale dhe ndërkombëtare të zhvillimit për këtë fushë mjaft speciale. Të gjitha këto u mundësuan dhe u finalizuan, duke u konsultuar me dokumentacionin e përzgjedhur vendas dhe ndërkombëtarë.</p> <p><i>Ref. Nr. 2.1, Plani strategjik i UST;</i> <i>Ref. Nr. 2, Statuti i UST, neni 10;</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Universiteti i Sporteve të Tiranës ofron programe studimi bashkëkohore që ruajnë vlerat akademike dhe kulturore në përputhje me interesat kombëtare.</i> - <i>Programi i studimit është hartuar në përputhje me qëllimin dhe misionin e institucionit si krijimi, transmetimi, zhvillimi, mbrojtja e dijes, etj.</i> - <i>Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit dhe është në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, Statutit dhe Rregullores së Institucionit.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet përcishtë	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.2																																										
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.																																										
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																									
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>Programi i Studimit të nivelit të dytë, Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike”, është hapur me urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Nr.355, datë 17-09-2021. Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes përbëhet nga tre departamente, njëri prej të cilëve është Departamenti i Sporteve Individuale.</p> <p>Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, si Njësia Kryesore për programin e studimit për vitin akademik 2022-2023 ka gjithsej 35 pedagogë, nga të cilët 32 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 3 pedagogë me kontratë (PAK), me kualifikimin e mëposhtëm:</p>																																									
	<table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th> <th colspan="2">Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>5</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof.Asoc</td> <td>7</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>13</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>7</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td>32</td> <td>3</td> </tr> </tbody> </table> <p>Ndërsa Departamenti i Sporteve Individuale, si njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit për vitin akademik 2022-2023, ka këtë paraqitje:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th> <th colspan="2">Departamenti i Sporteve Individuale</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>2</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof.Asoc</td> <td>3</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>3</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>2</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td>10</td> <td>1</td> </tr> </tbody> </table>			Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes		PAE	PAK	Prof.Dr	5	-	Prof.Asoc	7	-	Dr/PhD	13	-	Msc	7	3	Gjithsej	32	3	Kualifikimi i stafit	Departamenti i Sporteve Individuale		PAE	PAK	Prof.Dr	2	-	Prof.Asoc	3	-	Dr/PhD	3	-	Msc	2	1	Gjithsej	10
Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes																																									
	PAE	PAK																																								
Prof.Dr	5	-																																								
Prof.Asoc	7	-																																								
Dr/PhD	13	-																																								
Msc	7	3																																								
Gjithsej	32	3																																								
Kualifikimi i stafit	Departamenti i Sporteve Individuale																																									
	PAE	PAK																																								
Prof.Dr	2	-																																								
Prof.Asoc	3	-																																								
Dr/PhD	3	-																																								
Msc	2	1																																								
Gjithsej	10	1																																								

	<i>Ref 20. Tabelat përmbledhëse.tab nr. 1</i>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit janë në përputhje me fushën akademike të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes. Njësia Kryesore (Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes) i cili ofron këtë program studimi ka në përbërje të tij tre departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Sporteve Kolektive; 2. Departamenti i Sporteve Individuale; 3. Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit; <p>Sipas <i>nenit 5</i> të Rregullores së Njesisë Kryesore, departamentet janë ato njësi të cilat zhvillojnë mësimdhënien dhe punën kërkimore shkencore në fusha të përafërta me Njësinë Kryesore si dhe grupojnë disiplina mësimore respektive.</p> <p>Sipas VKM-së Nr. 57, datë 29.01.2020, programet e studimeve në UST hartohen nga njësitë bazë dhe paraqiten për miratim në Senatin Akademik.</p> <p><i>Ref. Nr. 2, Rregullore E FSHL-së;</i> <i>Ref. Nr. 6, Rregullore e Programit të Studimit;</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në: “Trajner i Përgatitjes Fizike”, është në përputhje me fushën akademike të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, ndërsa fusha specifike është në përputhje me njësinë bazë – Departamentin e Sporteve Individuale. Referuar RVB, ky program ofrohet në formën e një programi ndërsiplinor, ku janë të përfshira edhe njësitë e tjera të fakultetit.</p> <p><i>Ref. Nr. 2, Rregullore E FSHL-së;</i> <i>Ref. Nr. 6, Rregullore e Programit të Studimit;</i></p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Gjatë guidës në Institucion, në takimet e realizuara me stafin, nga diskutimi me studentet e përfshirë në këtë program studimi, dhe shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, GVJ konstatoi që programi i studimit dhe politikat e jashtme për mobilitetin e stafit dhe të studentëve, janë brënda profilit të këtij institucioni dhe se cilësia e këtij programi studimi, garantohet nga institucionet partnere me UST-në sikundër janë KOKSH, FSHF, Univeriteti i Sporteve Romë, Vjenë, Paris, Kopenhagen, Athinë, etj,</p>

	<p><i>Ref.7 Programi I studimit</i></p> <p><i>Ref.10, Politikat e jashtëmë për mobilitetin e stafit dhe të studentëve</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>GVJ, mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion, RVB, takimet me personat përgjegjës të Qendrës së Trajnimeve të Studentëve të programit të studimit të ciklit të dytë, “Trajner i Përgatitjes Fizike”, erdhëm në përfundimin që UST, ofron mjaftueshëm mundësi trajnimi për studentët e diplomuar, në bashkërendim me punëdhënësit që vetë institucioni ka hartuar marreveshje bashkëpunimi si Resorte, Klube Sportive, FSHF, KOKSH etj. Njëherazi, UST, ka ngritur një qendër të dedikuar brënda institucionit, qendër e cila ofron module trajnimi dhe trajnime në bashkërendim me politikat e DAR dhe ASCAP.</p> <p><i>Ref.19 Qendra e trajnimeve</i></p> <p><i>VIZITA në UST</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Institucioni ka kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike me staf akademik të brendshëm dhe me kontratë me experiencë dhe kryesisht me grada dhe tituj.</i> - <i>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit është në përputhje me fushën akademike të Institucionit dhe të të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit.</i> 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme</p>	<p>Referuar RVB-së, UST siguron marrëdhënie bashkëpunimi efçente ndërmjet njësisë kryesore dhe njësisë bazë, duke ndarë detyrat në mënyrë të qartë. Ndarja e detyrave krijon mundësinë</p>

<p>bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>për të përcaktuar përgjegjësitë dhe për të analizuar rezultatet e punës së çdo njësie.</p> <p>Nga vizita në UST mësuam se nëpërmjet akteve normative, garantohet marrëdhënie e frytshme bashkëpunimi midis njësive baze dhe atyre ndihmëse, duke respektuar hierarkinë institucionale dhe mirëkuptimin sipas detyrave dhe përgjegjësive të gjithë secilit. Zhvillohen analiza peridike për të vlerësuar cilësinë e produktit të tyre</p> <p><i>Ref.5, Rregullore e departamentit(Neni 3,pika 1);</i></p> <p><i>VIZITA në UST;</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>UST ka vendosur marrëdhënie institucionale bashkëpunimi me FSHF, KOKSH, Federatat Sportive të Atletikës, Basketbollit, Volejbollit dhe me faktorë të tjerë të brendshëm dhe të jashtëm, si kundër janë marrëveshjet e bashkëpunimit me Universitet e Sportit të Romës, Parisit, Vjenës, Kopenhagenit, Athinës etj, por edhe me faktorë të biznesit, Resorte, Qendra Trajningu etj, të cilat mbështesin realizimin me sukses të programit të studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në Trajner i Përgatitjes Fizike dhe mbikqyrjen e tij në vijimësi.</p> <p><i>Ref.10, Politikat e jashtme për mobilitet të stafit dhe studentëve(Marrëveshjet)</i></p> <p><i>VIZITA në UST</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>GVJ, mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion si dhe nga takimi me përfaqësuesit e njësisë bazë gjatë vizitës në UST, konstatoi që për realizimin e Programit të studimit të Ciklit të dytë, Master Profesional në “Trajner i Përgatitjes Fizike”, janë nënshkruar marrëveshje të posaçme me FSHF, KOKSH dhe me faktorë të tjerë të fushës së sportit dhe përgatitjes atletike, me qëllim realizimin e praktikave profesionale mësimore si dhe për të ndihmuar kërkimin shkencor nga ana e studentëve.</p> <p><i>Ref.10, Politikat e jashtëme për mobilitet të stafit dhe studentëve(Marrëveshjet)</i></p> <p><i>VIZITA në UST</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e</p>	<p>GVJ, mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe nga takimi me përfaqësuesit e njësisë bazë gjatë vizitës në UST,</p>

<p>studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>konstatoi që për realizimin e Programit të studimit të Ciklit të dytë, Master Profesional "Trajner i Përgatitjes Fizike", Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes në bashkëpunim me NJSBC-në dhe drejtoritë përkatëse, të cilat mbulojnë mardhëniet me faktorë vëndas dhe të huaj, por dhe ato me AIUMNI-in, harton raporte analitike për përfitimet që burojnë nga këto mardhënie bashkëpunimi, në ndihmë të programit të studimit. Institucionet eprore informohen në mënyrë periodike me raportet përkatëse.</p> <p><i>Ref.10, Politikat e jashtëme për mobilitet të stafit dhe studentëve(Marrëveshjet)</i></p> <p><i>VIZITA në UST</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Institucioni siguron marrëdhënie bashkëpunimi efçente ndërmjet njësive kryesore dhe njësive bazë, duke ndarë detyrat krijon mundësinë për të përcaktuar përgjegjësitë dhe për të analizuar rezultatet e punës së çdo njësie.</i> - <i>Institucioni ka një numër marrëveshesh bashkëpunimi me institucione homologe vendase dhe të huaja si dhe me institucione të tjera publike dhe private për të realizuar objektivat studimore si në procesin e mësimin ashtu edhe në realizimin e praktikave mësimore.</i> 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>
<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË


Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit të cikli dytë MP në “Trajner i Përgatitjes Fizike”, është i organizuar në lëndë sipas kategorisë (A, B, C, D, E), lëndë dhe module, sipas Ligjit 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë” si dhe Udhëzimit Nr.41 të MASR datë 24.01.2018, si dhe VKM Nr.824 datë 24.12.2021 “Për miratimin e kodit të cilësisë në arsimin e lartë”. Plani mësimor është i organizuar në 1 vit akademik, 2 semestra, 30 kredite çdo semestër, 60 kredite gjithë programi. 1 kredit ekuivalentohet me 25 orë mësimore, 12 ore ne auditor dhe 13 ore individuale.</p> <p><i>Ref.7, Programi Studimit</i></p> <p><i>VIZITA në UST</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit të cikli dytë MP në “Trajner i Përgatitjes Fizike”, përmes syllabuseve dhe strukturës mësimore dhe praktikës, synon disa objektiva të rëndësishme që lidhen me formimin e qëndrueshëm të koncepteve të zbatueshme dhe të thelluara, të lidhur ngushtë me profesionin, nëpërmjet kurseve teorike e praktike, që i aftësojnë studentët në profesionin përkatës, vecanërisht në fushën e përgatitjes atletike dhe kalkulimit të ngarkesave të studjuara fizike e funksionale.</p> <p>Këto objektiva janë të përcaktuara edhe në “Rregulloren e programit të studimit. Nga ana tjetër është krijuar mundësi për intership të zgjeruar, pranë operatorëve kryesorë të tregut të punës, përfshirë korporata dhe shoqata profesionale etj.</p> <p><i>Ref.7, Programi Studimit (Seksioni A,Pika)</i></p> <p><i>VIZITA në UST</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblylëse.</p>	<p>GVJ, gjatë guidës në institucion, në takimet e realizuara me stafin e njësisë bazë, por edhe takimi me perfaqësinë e studentëve, nisur nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultojnë qartë se Programi i Studimit të Ciklit Dytë Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike” ka të përcaktuar qartë ngarkesën në kredite të praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblylëse.</p> <p><i>GVJ, sygjeron që Dpartamenti, të krijojë mundësinë që praktika profesionale të marrë më shumë kredite, për rëndësinë që ajo ka në formimin profesional të studentëve master.</i></p> <p><i>Ref.7, Programi Studimit</i></p>

	<i>VIZITA në UST</i>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	N/A
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	N/A
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Nga vizita në UST, takimet me stafin drejtues dhe ndihmës, shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, u informuam se UST, gëzon status të veçantë dhe për këtë arsye, forma e organizimit të studimeve, praktika që ndiqet për pranimin e studentëve në institucion, politika e financimit të tyre, realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë) të përcaktuara dhe në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse të arsimit si dhe në akte të tjera rregulluese të UST-së.</p> <p><i>Ref.1, Ligji i IAL (Neni 2A,B,D)</i></p> <p><i>VIZITA në UST</i></p>

<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Referuar RVB, Programi i studimit të Ciklit të dytë, Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike”, është unik dhe i vetëm në Republikën e Shqipërisë dhe si i tillë, nuk ka akoma ndonjë program të ngjashëm në këtë fushë.</p> <p><i>Ref.1, Ligji i IAL (Neni 2A,B,D)</i> <i>VIZITA në UST</i></p>		
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Referuar RVB, dhe vizitës në institucion Programi i studimit të Ciklit të dytë, Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike”, është në proces të shoqërimit të tij me kodin përkatës.</p> <p><i>Ref.7,Programi i Studimit</i> <i>VIZITA në UST</i></p>		
<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>N/A</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë vlerësuar në kredite në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</i> - <i>Programi i studimit Master Profesional Trajner i Përgatitjes Fizike ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e detyrimeve përmbyllëse dhe praktikën profesionale, kreditet e së cilës nevojitet të rishihen.</i> 		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																								
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike” është Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes. Fakulteti i cili ka në përbërje 3 njësi bazë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Departamenti i Sporteve Kolektive; ▪ Departamenti i Sporteve Individuale; ▪ Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit; <p>Njësia kryesore përmbush detyrimet duke respektuar Statutin dhe Rregulloret përkatëse për organizimin, strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p> <p>Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, si Njësia Kryesore për programin e studimit për vitin akademik 2022-2023 ka gjithsej 35 pedagogë, nga të cilët 32 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 3 pedagogë me kontratë (PAK), me kualifikimin e mëposhtëm:</p> <table border="1" data-bbox="663 936 1468 1205"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th> <th colspan="2">Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>5</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof.Asoc</td> <td>7</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>13</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>7</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td>32</td> <td>3</td> </tr> </tbody> </table> <p>Departamenti i Sporteve Individuale si njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit në vitin akademik 2022-2023 ka këtë paraqitje:</p> <table border="1" data-bbox="663 1406 1468 1675"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th> <th colspan="2">Departamenti i Sporteve Individuale</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>2</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof.Asoc</td> <td>3</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>3</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>2</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td>10</td> <td>1</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>Ref. Nr. 20, Tabelat përmbledhëse</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>	Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes		PAE	PAK	Prof.Dr	5	-	Prof.Asoc	7	-	Dr/PhD	13	-	Msc	7	3	Gjithsej	32	3	Kualifikimi i stafit	Departamenti i Sporteve Individuale		PAE	PAK	Prof.Dr	2	-	Prof.Asoc	3	-	Dr/PhD	3	-	Msc	2	1	Gjithsej	10	1
Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes																																								
	PAE	PAK																																							
Prof.Dr	5	-																																							
Prof.Asoc	7	-																																							
Dr/PhD	13	-																																							
Msc	7	3																																							
Gjithsej	32	3																																							
Kualifikimi i stafit	Departamenti i Sporteve Individuale																																								
	PAE	PAK																																							
Prof.Dr	2	-																																							
Prof.Asoc	3	-																																							
Dr/PhD	3	-																																							
Msc	2	1																																							
Gjithsej	10	1																																							
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në</p>	<p>Departamenti i Sporteve Individuale i cili ofron këtë program studimi ka në përbërjen e vet 2 personel ndihmës akademik i cili asiston në ofrimin e këtij program studimi.</p>																																								

fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	<i>Ref. Nr. 20, Tabelat përmbledhëse</i>			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Sipas <i>Nenit 13</i> i Rregullores së Njesisë kryesore përcaktohen të gjitha dispozitat dhe detyrimet e koordinatorit të programit të studimit. Ky person i cili duhet të jetë anëtar efektiv i departamentit propozohet nga Drejtuesi i Njesisë Bazë dhe emërohet/shkarkohet nga Drejtuesi i Njesisë Kryesore. Me vendimin Nr. 14 datë 04.10.2022 është marrë vendimi nga Drejtuesi i Njesisë Kryesore për koordinatorin e programit të studimit. <i>Ref. Nr. 4, Rregullore E FSHL-së;</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - <i>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</i> - <i>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për mbarëvajtjen e aktiviteteve të procesit mësimor, praktikat mësimore apo proceset laboratorike.</i> - <i>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit ka koordinator programi i cili është përgjegjës për realizimin e programit mësimor, monitorimin e mbarëvajtjes së zhvillimit të mësimit dhe angazhohet dhe kujdeset në ruajtjen e cilësisë së mësimdhënies.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, UST dhe Departamenti i Sporteve Individuale, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Dokumentacioni i depozituar është i nevojshëm dhe i plotë për të organizuar programin e studimit. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit disponon Rregulloren e Universitetit, Rregulloren e brendshme të Dekanatit të Fakultetit, Rregulloren e programit të studimit.</p> <p><i>Ref. Nr. 3, Rregullore UST-së;</i></p> <p><i>Ref. Nr. 4, Rregullore E FSHL-së;</i></p> <p><i>Ref.7,Programi Studimit;</i></p> <p><i>Ref.5, Rregullore e Departamentit;</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit MP në Trajner i Përgatitjes Fizike, është organizuar sipas kërkesave të VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”. Lëndët janë të grupuara sipas kategorive dhe përqindjeve të krediteve të Tabelës nr.1, shtojca 1, VKM nr.41, datë 24.01.2018. Programet e studimit janë të organizuar në :</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Lëndë bazë A me 6 kredite= 10 % ➤ Lëndë Karakterizuese B me 24 kredite = 40% ➤ Lëndë ndërdisciplinore integruese C me 18 kredite = 30% ➤ Lëndë plotësuese D me 6 kredite = 10 % ➤ Lëndë përmbyllëse E me 6 kredite =10 % <p><i>Ref. Nr. 20, Tabelat përmbledhëse, tab 9</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike,” jepet informacioni i nevojshëm për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Në këtë program regjistrohen vetëm personat që zotërojnë diplomë të ciklit të parë Bachelor në “Shkencat e Lëvizjes” ose “Aktivitet Fizik për Shëndet e Rekreacion”, fituar pranë fakulteteve të UST-së, ose diploma të ngjashme të fituara jashtë vendit.</p> <p><i>Ref.2,Statuti I UST-së</i></p>

	<i>Ref.6,Rregullore e programit të studimit(Neni 10,11)</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, rezulton se programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për syllabuset, për praktikat mësimore, seminarët, punën individuale etj. Të gjitha këto janë në koherencë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Syllabuset janë të hartuara në bazë të udhëzimit përkatës. <i>Ref.7, Programi I Studimit</i> <i>Ref.6, Rregullore e e Programit të Studimit</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Gjatë vizitës në UST, nga takimet me drejtuesit e njesisë kryesore dhe mbështetur në dokumentacionin e servitur, GVJ u informua që Programi i studimit të Ciklit të Dytë, Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike”, është në vitin e parë të zhvillimit dhe në këtë kuptim, ka nevojë për një kohë të mjaftueshme, që të analizohet dhe mbi të dhënat e përfituara, që ky program të përditësohet sikundër e kërkon rregulli cdo fillim viti akademik, me qëllim përmirësimin dhe përditësimin e tij, duke ndjekur kuadrin rregullativ ligjor në fuqi (Ref.2, Statuti I UST-së, Neni 75) dhe pas miratimit, arkivohet në dosje në shqip dhe anglisht. <i>Ref.2, Statuti I UST(Neni75)</i> <i>Ref.6,Rregullore e programit të studimit</i> <i>VIZITA në UST</i> <i>Ref.7,Programi i Studimit</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon rregullore, planin e studimit, kurrikulën, syllabuset, etj për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</i> - <i>Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</i> - <i>Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për, seminarët, detyrat e kursit, projektet e kursit, provimi apo</i>

	<i>orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit.</i>		
hkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve	GVJ, gjatë vizitës në UST dhe mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion, konstatoi që emërtimi i lëndëve, përmbajtja e lëndëve dhe e praktikave profesionale të programit të studimit të Ciklit të Dytë, Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike” mundësojnë thellimin e njohurive të studentëve për studime të mëtejshme, garantojnë mundësi për punësim të tyre në tregun e punës brenda vendit, por dhe jashtë vendit. Faktor ndihmues, për arritjen e këtij qëllimi, është edhe kualifikimi i lartë i stafit drejtues ku përfshihen Prof., Prof.As.Dr, dhe mjaft pedagogë me gradën Dr.Shk. <i>Ref.6,Rregullore e programit të studimit(Neni 1,6,7)</i> <i>VIZITA në UST</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Gjatë guidës në UST, nga takimet e zhvilluara me stafin, studentët dhe administratën mbështetëse GVJ u informua qe Programit i Studimit të Ciklit të Dytë, Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike” është i ndarë në dy semestra, në një vit akademik, me 60 ECTS, ku një kredit është 25 orë mësimore, që garanton sigurimin e cilësisë së programit të studimit dhe të nxënit, por dhe stimulon kërkimin shkencor të studentëve. <i>Ref.7,Programi Studimit</i> <i>VIZITA në UST</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e	Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion, rezultoni që programi studimit është hartuar për të qenë i ngjashëm deri në masën 80% me programet e ngjashme të së njëjtës fushë ndërkombëtare, gjë që mundëson mobilitetin e studentëve të

<p>përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>diplomuar. Kjo ngjashmëri është e dukshme te struktura e programit të studimit, në raportin midis vëllimit orë teori dhe orë praktikë, duke garantuar për studentët aftësi profesionale, kompetence në zgjidhjen e detyrave, mundësi për tu përfshirë me sukses në tregun e punës.</p> <p><i>Ref.6, Rregullore e programit të studimit(Neni 7, Pika 7/1)</i> <i>Ref.7, Programi I Studimit</i> <i>Ref.10, Politikat e jashtëme për mobilitet të stafit dhe studentëve</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>GVJ, gjatë takimit me drejtuesit e njesisë kryesore, (FSHL dhe Departamenti i Sporteve Individuale), mbështetur edhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatoi se raporti teori-praktikë, në programin e studimit të Ciklit të Dytë, Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike”, janë të harmonizuar dhe mundësojnë arritjen e objektivave formues të studentëve, garantojnë mundësi punësimin, pas përfundimit të studimeve dhe njëherazi mundësojnë studentët në transferimin e krediteve por edhe në mobilitetin e tyre, brënda rajonit dhe në BE, në bazë të marrveshjeve që UST ka nënshkruar.</p> <p><i>Ref.7,Programi I Studimeve</i> <i>VIZITA në UST</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>GVJ, gjatë vizitës në UST dhe mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion, konstatoi që programi i studimit sapo mbylli vitin e parë dhe në baze të kuadrit rregullator të UST-së, (<i>Ref.6, Rregullore e Programit të Studimit Neni 1</i>), Syllabuset e lëndëve, programet e lëndëve dhe modulet, do të përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, konform rregullores, me synim që studentët të marrin kompetencat e duhura, sipas kërkesave të tregut të punës, duke ju dhënë literaturën bazë më të fundit që është në qarkullim. Stafi drejtues i njesisë bazë, e pohoi këtë fakt gjatë takimit me GVJ</p> <p><i>Ref.6, Rregullore e Programit të Studimit(Neni 1) VIZITA në UST</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>GVJ në takimet e realizuara me stafin e njesisë kryesore dhe me studentët master, konstatoi që programi i studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara nga programi, <i>Ref.6, Rregullore e Programit të Studimit(Neni 1)</i>, mbasi përmbajtja e programit të studimit, fushat e përzgjedhura të cilat synojnë njohjen e organizmit të sportistit, ndërtimin dhe funksionet e tij fiziologjike lidhur me aktivitetin motor, metodat</p>

	<p>moderne të vlerësimit, kalkulimi laboratorik i të dhënave, plotësojnë objektivat e trajnerit teknik, që ai të përgatisë me kompetencë profesionale, fizikisht sportistë të sporteve individuale, për të arritur rezultat maksimal në performancë, duke garantuar parametrat e ruajtjes së shëndetit afatgjatë të sportistit.</p> <p><i>Ref.6, Rregullore e Programit të Studimit(Neni 1) VIZITA në UST</i></p>						
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>GVJ, mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion, takimet me drejtues të FSHL dhe Departamentit të Sporteve Individuale, konstatoi se raporti teori-praktikë, në programin e studimit, është në përputhje dhe mundëson arritjen e objektivave formues të studentëve master, ndihmon transferimin e studentëve dhe mobilitetin e tyre për punësim brenda dhe jashtë, pas përfundimit të studimeve.</p> <p><i>GVJ sygjeron që formimi praktik i studentëve të marrë përparësi.</i></p> <p><i>Ref.7,Programi I Studimeve</i> <i>Ref.10, Politikat e jashtëme për mobilitet të stafit dhe studentëve VIZITA në UST</i></p>						
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Emërtimi i lëndëve është në përputhje me brendësinë e temave, raporti midis hapsirës së lëndëve teorike me ato praktike, janë sipas legjislacionit në fuqi. - Programi i studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional. Lëndët janë të shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit. - GVJ, sygjeroi që formimi praktik i studentëve të thellohet më tej në vijim dhe ky propozim u pranua ngastafi drejtues i FSHL dhe Departamenti i Sporteve Individuale. 						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>GVJ, mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion, dhe takimet me stafin drejtues, konstatoi se FSHL dhe Departamenti i Sporteve Individuale, kanë marrë në vëmendje propozimet e institucioneve partnere FSHF, KOKSH, Federatat Sportive, ALUMNI, trajnerë teknikë, dhe aktorë të tjerë ndërkombëtarë (EUSA) me të cilët UST bashkëpunon, garanton përmirësimin e programin e studimit në vijimësi, ndikuar edhe nga drejtimet që do të marrë në vijimësi gjithashtu kërkesa e tregut të punës, e cila ndjek dinamikën e saj të ndryshimit.</p> <p><i>Ref.7,Programi I Studimit(Seksioni G)</i></p> <p><i>Ref.10, Politikat e jashtëme për mobilitetin e stafit dhe të studentëve</i></p> <p><i>VIZITA në UST</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>GVJ u informua gjatë vizitës në institucion si dhe nga takimet e realizuara me studentët, se nevoja për të përmirësuar përmbajtjen e programit të studimit ka nxitur dhe përfshirë në diskutim studentët dhe strukturat e tyre.</p> <p>ALUMNIT, të cilët japin mendimet e tyre për përmirësimin e programit të studimit, në takimet që zhvillohen në departamentin e sporteve individuale, por edhe nëpërmjet komunikimit online (https://ust.edu.al/master-profesional-3/)</p> <p>Njësitë përgjegjëse FSHL dhe Departamenti i Sporteve Individuale, i kanë reflektuar këto ide dhe mendime që vijnë nga studentët apo strukturat e tyre, si asete që ndihmojnë përmirësimin e programit të studimit në vijimësi.</p> <p><i>Ref.10, Politikat e jashtëme për mobilitetin e stafit dhe të studentëve</i></p> <p><i>VIZITA në UST</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të</p>	<p>GVJ nisur nga dokumentacioni që u vu në dispozicion nga njësia përgjegjëse, por edhe nga takimet e realizuara me drejtues të FSHL, konstatoi që njësia bazë për mbarëvajtjen e programit të studimit në bashkëpunim me shoqata dhe federata sportive (FSHF, KOKSH) institucione homologe të arsimit të lartë,(EUSA) brënda</p>

<p>ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>dhe jashte shqipërise, së bashku me aktore privatë dhe publikë (Bashkia Tiranë) që kontribuojnë në fushën e sportit, shërbejnë si faktor ndihmues në përditësimin dhe përmirësimin e këtij programi studimi në vijimësi.</p> <p><i>Ref.10, Politikat e jashtëme për mobilitetin e stafit dhe të studentëve</i></p> <p><i>(Marrëveshjet)</i></p> <p><i>VIZITA në UST</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit, duke nxitur diskutime si dhe marrëveshjet me institucione të tjera publike dhe private, profesionistë që ftohen të japin leksione, etj.</i> - <i>Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, tërheq mendimet e studentëve në fund të semestrave në lidhje me lëndët dhe aspekte të mësimin.</i> 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Standardi II.6</p>	
<p>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>GVJ, mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion, si dhe nga takimet e realizuara me drejtuesit e njesisë bazë, konstaton se programi i studimit përcakton qartë me dokumentacion të rregullt, <i>(Ref.5, Rregullore e Departamentit të sporteve individuale Neni 8, 9)</i> prioritetet dhe objektivat kryesore të studimit. Vëmendje i është kushtuar kërkimit shkencor në terren dhe për këtë qëllim shërbejnë disa laboratorë modern, të fituara nga projektet të ndryshme, laboratorë të profilizuar, ku studentët mund të zbatojnë ide novative, në përputhje me objektivat madhore të institucionit.</p> <p><i>Ref.5, Rregullore e Departamentit të sporteve individuale(Neni 8,9)</i></p> <p><i>VIZITA në UST</i></p>

<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, si dhe nga takimet e realizuara me stafin drejtues të njësisë baze, u informuam që Departamenti i Sporteve Individuale, në zbatim të udhëzimeve në fuqi, nxit, bashkërendon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor. Pedagogët e përfshirë në program, gëzojnë liri akademike në fushën e vecantë të studimit, duke zgjedhur vetë literaturën e duhur, temat e studimit etj, të garantuara dhe në aktet rregullative të UST-së. Këtë liri akademike e ka gëzuar cdo titullar lënde, në hartimin e syllabuseve, të leksioneve, ndarjen e krediteve, përzgjedhjen e literaturës etj</p> <p><i>Ref.5, Rregullore e Departamentit të sporteve individuale Programi i Studimit (Ref.,8.9)</i></p> <p><i>VIZITA në UST</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>GVJ konstatoi që programi i studimit, mundëson, dhe i motivon studentët që të angazhohen në kërkimin shkencor dhe studime shkencore, individualisht dhe në grup, duke u përfshirë në projekte që ata vetë i ndërmarrin, për shkak të karakterit aplikativ që ka vetë programi, ose dukë u përfshirë brënda projekteve që departamenti ose fakulteti janë inkluduar. UST ka në dispozicion sisteme të automatizuara, si TIMS, GOOGLE CLASRUM, që studentët të mbahen në kontakt me pedagogët udhëheqes gjatë kërkimit shkencor.</p> <p><i>Ref.8, SBC</i></p> <p><i>VIZITA në UST</i></p>
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>GVJ, mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion, konstatoi që UST, mbështet financiarisht, realizimin e aktiviteteve, studimore, kërkimore dhe shkencore në përbërje të Departamentit të Sporteve Individuale.</p> <p>Ky aktivitet mbështetet në një praktikë shkresore korrekte dhe të kontrollueshme. DSI, ka në planin e tij të veprimit, të sigurojë të ardhura nga pjesmarrja në projekte, nga shërbime me karakter akademik-shkencor, të ardhurat i rialokohen departamentit për përmiresimin e infrastructures së brëndëshme.</p> <p><i>Ref.5, Rregullore e Departamentit të Sporteve individuale(Neni 7)</i></p> <p><i>VIZITA në UST</i></p>

Konkluzione	GVJ konstaton se:			
	<ul style="list-style-type: none"> - Programi i studimit përcakton qartë në rregullore prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. - Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore, për financimin e të cilave njëjësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njëjësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	GVJ, u informua gjatë vizitës në UST nga realizimi i takimeve me drejtuesit e njesisë bazë dhe me grupin studentor, që Njëjësia përgjegjëse për realizimin e programit të studimit dhe FSHL, ka krijuar grupe lëndore, të mbështëtura dhe të asistuar nga stafi akademik, në zbatim të Rregullores së Departamentit të Sporteve Individuale <i>Neni 7, 8, 9</i> , duke i përfshirë ata në projekte kërkimore e shkencore brënda UST-së. Në shërbim të këtij qëllimi, institucioni bashkëpunon edhe me struktura të tjera të përaferta si FSHL, për përmbushjen e objektivave në aspektin kërkimor dhe shkencor me studentin në qendër. <i>Ref.5, Rregullore e Departamentit të Sporteve individuale (Neni 7,8,9)</i> <i>VIZITA në UST</i>
Kriteri 2. Njëjësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Për realizimin e objektivave të programit të studimit GVJ, konstaton se Departamenti i Sporteve Individuale dhe FSHL, angazhon stafin akademik për tju përgjigjur nevojave që lidhen me diskutimin dhe analizën e veprimtarisë së kërkimit shkencor, ecurisë së projekteve ku institucioni është pjesë, me synim për ta përmirësuar dhe abdetuar këtë prodhimtari produktive. Përfshirja e studentëve në këtë process analizë është konkrete dhe e dokumentuar në praktikë shkencore të DSI.

	<p><i>Rregullore e Departamentit të Sporteve individuale (Neni 7.Pika 1.c)</i></p> <p><i>Ref.20, Tabelat Përmbledhëse</i></p> <p><i>VIZITA në UST</i></p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>GVJ, gjatë vizitës ne Institucion, u informua që UST, FSHL, Departamenti i Sporteve Individuale, kanë organizuar veprimtari me karakter studimor e shkencor, si konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare me pjesmarrje të gjerë, ka organizuar simpoziume, tryeza të rrumbullakta (Round Table) në fushën që lidhet me programin e studimit. Studentët janë përfshirë në këto veprimtari shkencore, duke marrë pjesë me prezantime të punëve të tyre si individualisht ashtu edhe të punëve të realizuara në në grup, duke i ndihmuar ata të përmbushin objektivat në këtë aspekt të jetës akademike.</p> <p><i>Rregullore e Departamentit të Sporteve individuale (Neni 7.Pika 1.c)</i></p> <p><i>Ref.20, Tabelat Përmbledhëse</i></p> <p><i>Guida në UST</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>GVJ, gjatë vizitës në institucion u informua që Programi i studimit të Ciklit të Dytë, Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike” është unik në tregun kombëtar për momentin, sepse ky program, për herë të parë, po zhvillohet pranë UST, në FSHL dhe Departamentin e Sporteve Individuale (me urdhër vendimi të MAS, nr.355, dt 17-09-2021), dhe për këtë qëllim ai përgatit dhe diplomon profesionistë që konkurojnë me të ngjashmit e tyre në tregun ndërkombëtar dhe në rajonal të punës.</p> <p><i>Ref.7, Programi I Studimit (Pika G)</i></p> <p><i>VIZITA në UST</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Për përmbushjen e objektivave të Programit të studimit njësia bazë, Departamenti i Sporteve Individuale dhe FSHL, (<i>Ref.6, Rregullore e programit të studimit (Neni 33)</i>), mban lidhje me partnerët me të cilët e ka hartuar këtë program studimi, (FSHF, KOKSH, EUSA, Federata e Aletikës, Federata e Basketbollit, Federata Volejbollit, si dhe rrjetet profesioniste) etj, duke zbatuar të gjitha rekomandimet e tyre, urdherat ligjore të dala në funksion te shoqatave të trajnerëve, federatave etj, me objektiv që në përfundim të studimeve, studentët të kenë mundësinë e marrjes së licencës se këtij profesioni dhe punësimin në tregun e punës.</p>

	Ref.6, Rregullore e programit të studimit (Neni 33) Guida në UST			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	GVJ, mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion, konstatoi që programi i studimit nuk është akoma një profesion i rregulluar me ligj, në kuadrin ligjor shqiptar dhe atë evropian (<i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>) Institucioni është në kërkim të zgjidhjes së këtij problemi, në bashkpunim edhe me partnerët dhe është vënë në rrugën e zgjidhjes së shpejtë dhe përfundimtare Ref.3, Rregullore e UST-së (Neni 47) VIZITA në UST			
Konkluzione	GVJ konstaton se: <ul style="list-style-type: none"> - Njësia përgjegjëse mbështet grupet e lëndëve dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore si dhe ofron pëdorimin e infrastrukturës për realizimin e objektivave të projekteve. - Programit i mungon pranimi i tij si profesion i rregulluar! IAL është në rrugën e zgjidhjes së shpejtë dhe përfundimtarë, në bashkrendim edhe me partnerët dhe ministrinë përgjegjëse për plotësimin e aktit të munguar pjesërisht. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
		X		

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>GVJ, mbështetur në RVB, konstaton se mësimdhënia, trasmetimi i dijes dhe informacionit, realizohet me anën e leksioneve, seminareve, ushtrime/laboratorë, seanca të praktikave profesionale të zhvilluara në auditor, praktikë profesioanle si dhe provimi final i formimit.</p> <p>Format e mësimdhënies dhe mësimnxënies për këtë program studimi janë të strukturuar si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Leksione 275 orë ▪ Seminare 125 orë ▪ Ushtrime/laboratorë 121 orë ▪ Seanca të praktikave profesionale të zhvilluara në auditor 60 orë; <p>Totali 581 orë</p> <p>Mungon praktika profesioanle nuk ka asnje ore dhe nuk ekziston ne program si lende me vete.</p> <p>Diploma/Provim Formimi (Detyrime permbyllesë) (E) 10-20% kredite = 6 kredite <i>mungojnë oret.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron që në planin mësimor të shprehen orët e diplomes, dhe gjithashtu të përfshihet në program si lëndë me vete praktika profesionale e cila nuk ekziston aktualisht në program, por vetëm si praktik lëndore e inkorporuar në lëndë të ndryshme profesionale që përmbledh 10 % të krediteve .</i></p> <p><i>Ref, 20. Tabelat përmbledhëse, tab nr. 9;13</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>GVJ, mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe evidencat përkatëse, konstatoi që përmbushja e Programit të studimit të Ciklit të Dytë, Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike”, është arritur nëpërmjet aktivizimit të vazhdueshëm të studentëve, nëpërmjet orëve mësimore interaktive, që ngjallin interes te studentët pjesmarrës, por edhe duke u fokusuar te ndërveprimi pedagog-student, gjë që sjell rritjen e interesit të</p>

	<p>studentëve për tu përfshirë në këto veprimtari, jo vetëm si pjemarrës, por mbi të gjitha si palë ndërvepruese dhe përfituese. Këto veprimtari pëlqehen dhe mirëprehen nga studentët, duke e vlerësuar këtë si mundësi alternative të mësimdhënies dhe mësimnxenies produktive në pormimin e tyre profesional dhe shkencor.</p> <p><i>Ref.2, Statuti I UST-së: Plani Strategjik Sfondi (Sigurimi I Cilësisë)</i></p> <p><i>Ref.4, Rregullore e FSHL-së</i></p> <p><i>Ref.8,SBC, Kreu 1, Neni 4</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Gjatë guidës në institucion, nga studimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga takimet e realizuara me drejtuesit e njesisë kryesore FSHL dhe DSI, si dhe me grupin studentor, u informuam qe UST-ja organizon në mënyrë periodike trajnime, (<i>Ref.nr.19, Qendra e Trajnimeve</i>) të personelit akademik, kryesisht në aspektet didaktike të mësimdhënies, ka nxitur përdorimin e metodave inovative, krahas atyre tradicionale, në përputhje me fushen e studimit. Hartimi i syllabuseve, i metodave të mësimdhënies, përzgjedhja e literaturës,e sistemit të kontrollit dhe e vlerësimit të dijës,këshillimi akademik dhe tutorial, realizohen nëpërmjet udhëzuesve të hartuar posacërisht për këtë qëllim</p> <p><i>Ref.4, Rregullore e FSHL-së(Neni 106,107)</i></p> <p><i>Ref.8,SBC, Kreu 1, Neni 4</i></p> <p><i>VIZITA në UST</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit është i përbërë nga pedagogë me tituj dhe grada. Pedagogët janë kompetent në ofrimin dhe shpjegimin e njohurive të nevojshme në fushën e sportit.</p> <p>Harmonizimi sipas situatës, i metodave interaktive me ato tradicionale, ka përbërë bazën për të rritur interesin e studentëve, mendimin kritik dhe mendimin krijues, pjesmarrjen në debate ku spikat respekti reciprok, besimi i ndërsjellë në arritjen e suksesit etj. Në këtë drejtim ndihmon edhe infrastruktura bashkëkohore që është në dispozicion të zhvillimit të mësimdhënies.</p> <p><i>Ref.8, SBC:Kreu 2, Standarti 5,6</i></p> <p><i>VIZITA në UST</i></p>

<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>GVJ, bazuar në RVB, bazuar në evidencat e paraqitura, gjatë guidës në UST, si dhe në takimet e realizuara me drejtuesit e njesisë kryesore FSHL dhe DSI, u informuam se vjelja e mendimit të studentëve dhe përfshirja e tyre në rritjen e cilësisë së mësimdhënies në Programin e studimit të ciklit të dytë, Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike”, është synim i UST-së. Shqetësimet që janë ngritur nga studentët, për problematika që ata i ka shqetësuar, janë marrë në vëmendje nga drejtuesit e departamenteve dhe janë trajtuar me seriozitet si në departament, ashtu dhe në senatin e UST, apo në rektorat, duke reflektuar mendimet dhe sygjërimet e tyre, për çështjet e ngritura nga ana e studentëve.</p> <p><i>Ref.8, SBC:Kreu 2, Standarti 2,3</i></p> <p><i>VIZITA në UST</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>GVJ, bazuar në RVB, në dokumentacionin përkatës në takimet e realizuara me stafin, dhe përfaqësuesit e grupit studentor, konstatoi që UST, ka të organizuara struktura në nivel institucional, që promovojnë përmirësimin e mësimdhënies, të cilat koordinojnë veprimtarinë me departamentin e sporteve individuale. Këto Aktivitete kanë synuar rritjen e cilësisë së mësimdhënies, dhe zhvillimin e metodave të reja innovative.etj. Kjo strukturë trajnon edhe personelin akademik, në bazë të një program.UST, me moton Back to Eork, në fillim të cdo viti akademik, planifikon trajnime me qëllim përditësimin e rifreskimit të stafit akademik.Struktura dhe njësia përgjegjese, Departamenti i Sporteve Individuale dhe FSHL, kanë mbështetur zhvillimin e metodave të reja inovative e modern, gjatë përmbushjes së progamit të studimit.</p> <p><i>Ref.8, SBC:Kreu 3, Neni 8,9,10</i></p> <p><i>VIZITA në UST</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>IAL ka vënë në dispozicion të studentëve infrastrukturën e nevojshme, një staf mjaft profesional dhe të kualifikuar, për realizimin e procesit të mësimdhënies mbështetur në metoda inovative dhe praktikat më të mira, që mundësojnë formimin praktik dhe shkencor të tyre, nëpërmjet përfshirjes në</i>

	<i>veprimtari kun në qendër është vetë student me gjithë personalitetin e Tij.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ, mbështetur në RVB, në takimet e realizuara me drejtuesit e njesisë kryesore, si dhe referencat e vëna në dispozicion konstatoi se kriteret dhe mënyra e testimit dhe e vlerësimit të njohurive, në Programin e studimit të ciklit të dytë, Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike”, janë përcaktuar qartë në rregulloren programin e studimit si dhe nga rregullorja e provimeve dhe e diplomimit. Kriteret dhe mënyra e diplomimit, bëhen publike dhe u njoftohen studentëve gjatë javës së orjentimit, nga shërbimi i kujdesit dhe këshillimit të vazhdueshëm nëpërmjet koordinatorit dhe drejtorisë së kujdesit për studentin. Transparenca e procesit të informimit përmbushet plotësisht nëpërmjet informimit elektronik dhe formave të tjera të dukshme si faqja zyrtare e UST-së, etj.</p> <p><i>Ref.3, Rregullore e UST-së</i></p> <p><i>Ref.5, Rregullore e Departamentit të Sporteve Individuale VIZITA në UST</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Gjatë guidës në institucion, mbështetur në RVB, në takimet e realizuara me drejtuesit e njesisë bazë si dhe me studentët e programit të studimit, GVJ u informua që studentët janë njohur me syllabusin e lëndës nga ana e pedagogëve lektorë. Ata janë njohur dhe me afatet se kur duhet të plotësohet cdo detyrim nga ana e studentit për përgatitjen dhe likuidimin e lëndës përkatëse në përfundim të modulit mësimor. Këtë proces e ka ndihmuar shumë edhe përdorimi i platformës PITAGORA, por dhe faqja zyrtare e UST-së. Këtë fakt GVJ e konstatoi në terren, në takimin me studentët e përfshirë në programin e studimit.</p> <p><i>Ref.6, Rregullore e Programit të studimit(Neni 24,25,26)</i></p>

	<i>VIZITA në UST</i>			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	GVJ, bazuar në referencat e vëna në dispozicion, dhe nga takimet e realizuara me drejtuesit e njesisë kryesore, u informua që parashihen forma të ndryshme të kontrollit të dijeve për testimin e aftësive profesionale dhe shkencore të studentëve. Dhe njeherazi duke i dhënë mundësi studentëve të shfaqin personalitetin e tyre. Këto forma i japin mundësi pedagogut të zgjedhi atë që është më optimal për vlerësimin përfundimtar. Vlerësimi i studentit bëhet në vijimësi dhe synon të nxisë motivimin e studentit të mësojë gjatë tërë vitit akademi dhe të përfitojë vlerësime periodike për ecurinë e tij. Në këtë mënyrë arrihet në një vlerësim më të mirë për studentin nga pedagogu. <i>Ref.6, Rregullore e Programit të studimit (Neni 24,25,26)</i> <i>Ref.7, Rregullore e studimit (pika 1)</i> <i>VIZITA në UST</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> <i>IAL ka krijuar rregullore dhe procedura të posacme të testimit dhe të vlerësimit të njohurive profesionale e shkencore të studentëve, që studentët të shpalosin gjithë aftësitë e tyre. UST ka krijuar të gjithë hallkat e domosdoshme administrative dhe ligjore, që mundësojnë mbarvajtjen e programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në	GVJ, gjatë guidës në UST, nga takimet e realizuara me stafin drejtues të njesisë kryesore dhe me studentët, u informua që në rregulloren e programit të studimit, shprehet qartë harmonizimi i disa elementeve që rregullojnë vlerësimin e dijeve të studentëve, njohurive dhe aftësive profesionale të studentit, dhe kjo bëhet e mundur duke përdorur një metodikë të mirë përcaktuar e cila mbështetet në rezultatet nga provimi i ndërmjetëm, rezultatet nga

<p>syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>niveli i diskutimit që student bën në seminar si dhe realizimi i detyrave të kursit, pjesmarrja e tij në prezantime, pjesmarrja në projekte, ese,që mbyllen me provimin përfundimtar. Këto forma i behen me dije studentëve që në fillim të lëndës, nga pedagogu përkatës.</p> <p><i>Ref.6, Rregullore e programit të studimit, (neni 26)</i></p> <p><i>VIZITA në UST</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>GVJ, gjatë vizitës ne institucion, mbështetur edhe në referencat që na u vunë në dispozicion, konstatuam që njësia përgjegjëse për përbushjen e programit të studimit, Master Profesional, “Trajner i Përgatitjes Fizike” dhe UST-ja, bashkëpunon me AADF (Albanian-American Development Foundation) dhe është duke u zbatuar një projekt i ri vlerësimi elektronik “Clean SCORE” i cili përbën risi si një program rigoroz dhe kompakt.</p> <p><i>Ref.12, Marrveshja me CLEAN SCORE</i></p> <p><i>VIZITA në UST</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga vizita në UST takimet e realizuara me pedagogë dhe drejtues, mbështetur në referencat e vëna në dispozicion, GVJ konstatoi që vlerësimi përfundimtar i lëndës, bëhet në përputhje me syllabusin e lëndës dhe me aktet ligjore në fuqi. Për trajtimin e ankesave të studentëve (në rastet kur ka ankesa nga ana e studentëve) në shkallë të fundit, përgjegjësi i departamentit, në zbatim të rregullores, ndërton një komision me tre antarë, të cilët shqyrtojnë ankesën dhe marrin vendim me shumicë të thjeshtë.</p> <p><i>Ref.6, Rregullore e programit të studimit, (neni 24)</i></p> <p><i>VIZITA në UST</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Mbështetur në RVB, në takimet e realizuara në UST, me student dhe drejtues të njesisë kryesore DSI dhe FSHL, mbështetur në referencat e disponuara, u informuam që pedagogu i lëndës, shoqëron me shënim përkatës vlerësimin e studentit kur është i nevojshëm, me qëllim që studentit të ketë mundësi të vetë korrigjohet dhe të përmirësojë mangësitë e tij. Për këtë qëllim shërbejnë edhe seancat sqaruese që organizohen për këtë qëllim, në të cilat studentit mund të marrë informacion më të hollësishëm për notën dhe vlerësimin dhe kjo i ka ndihmuar studentët të përmirësohen dhe vetë korrigjohen për të ardhmen.</p> <p><i>Ref.7, Programi I studimit (Pika 1)</i></p>

	<i>VIZITA në UST</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra	Mbështetur në RVB, në takimet e realizuara në UST, me studentët dhe drejtues të njesisë kryesore DSI dhe FSHL, mbështetur në referencat e disponuara, njësia përgjegjëse ka marrë masa që të ndalë plagjiaturën, apo mundësinë e kopjimit nëpërmjet përdorimit të celularit brenda provimit, duke mbajtur në sallën e provimit vetëm personat përgjegjës në detyrë, duke sekretuar provimet nga ana e sekretarisë mësimore, me qëllim që korigjimi të ruaj privatësinë. Kur janë gjetur raste, është ndëshkuar me notën 4 të studentit që është kapur me kopjim. <i>Ref.4, Rregullore e FSHL-së (Neni 117/1) VIZITA në UST</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	GVJ, mbështetur në referencat që na u vunë në dispozicion, konstatoi se bëhen përpjekje serioze që rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore të studentëve, të bazohen në meritë. Dorëzimi i rezultateve të provimit bëhet në rrugë elektronike dhe nota kalon direct e tek student në kohë reale. Dorëzimi bëhet prënda dy javëve dhe në riprovime, brenda një jave. Pas shpalljes së notës, pedagogu nuk ka të drejtë të ndërhyjë për ta ndryshuar notën, pasi vetë sistemi regjistron saktësisht cdo ndërhyrje për korigjim dhe ndryshim jashtë kohës së korigjimit. <i>Ref.5, Rregullore e Departamentit të sporteve individuale (Neni 19, 20, 21, 22)</i> <i>Ref.6, Rregullore e programit të studimit (Neni, 24,25,26)</i> <i>VIZITA në UST</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	GVJ, mbështetur në referencat që na u vunë në dispozicion, si dhe nga takimet e realizuara me administratën, me studentët dhe drejtuesit e njesisë bazë, konstatoi që UST garanton kërkesën e studentëve për tu njohur me vlerësimin që ata marrin në provim, me të drejtën që ata gëzojnë për rishikimin e vlerësimit të tyre kur e shikojnë të nevojshme, sipas rregullave që përfshihen në statut. Studenti nëpërmjet sistemit Online, merr notën në kohë reale, e cila pasohet me një seance sqaruese nga ana pedagogut, për të qartësuar cdo student, pasi nota edukon. <i>Ref.6, Rregullore e programit të studimit (Neni, 24,25,26)</i> <i>VIZITA në UST</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më	Nga vizita në institucion, takimet e realizuara me studentë, drejtues të njesisë kryesore dhe mbështetur në referencat që na u vunë në dispozicion, GVJ konstatoi që rregullorja e programit të

<p>pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>studimit, i mundëson studentit ti drejtohet me shkrim departamentit nëse ai nuk është dakort me vlerësimin e pedagogut. Pas seancave sqaruese, komisioni i ngritur posacërisht, (komisioni i vlerësimit) bën vlerësimin përfundimtar të rastit, që mund të jetë i njejtë, më i lartë ose më i ulët, duke zbatuar transparencë të plotë edhe shkresore e cila arkivohet sipas rregullores.</p> <p><i>Ref.6, Rregullore e programit të studimit (Neni, 24,25,26)</i></p> <p><i>VIZITA në UST</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <p><i>IAL siguron vlerësim të drejtë dhe transparen, bazuar në meritën e cdo student, duke përfshirë edhe procesin e ankimimit, për ndjekjen e të cilit janë funksionale, instancat që marrin dhe e trajtojnë problemin kur shfaqet, në kohë dhe mbështetur në rregullore e ligj.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Standardi III.4</p> <p>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>GVJ, mbështetur në referencat e vëna në dispozicion dhe nga takimet e realizuara me drejtuesit e njesisë bazë, konstatoi që programi i studimit, garanton thellimin e njohurive, për aftësi të thelluara profesionale si dhe aftësi të veçanta të studentëve që ata shfaqin në aspektin e interes shkencor dhe hulumtimit shkencor. Këto qëllime janë renditur qartë në dokumentacionin përkatës dhe shërbejnë si piketa orjentuese për stafin akademik realizues.</p> <p><i>Ref.7, Programi I studimit (Seksioni A/1)</i></p> <p><i>VIZITA në UST</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe</p>	<p>Pamë në UST si GVJ që programi i studimit, ka si qëllim parësor, thellimin e njohurive dhe aftësive profesionale në fushën e përgatitjes fizike të sportistëve. Por ka edhe tema që lidhen ngushtë me IT, në trajnimin sportiv dhe kalkulimeve të thelluara që masin dhe vlerësojnë parametrat fiziologjikë dhe</p>

<p>ndërveprimet (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>mikrobiologjike të ushtruesve, gjatë seancave stërvitore që ata ushtrojnë në mbikqyrjen e stafit pedagogjik</p> <p><i>Ref.7, Programi I studimit (Seksioni A/1)</i></p> <p><i>VIZITA në UST</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, në takimet e realizuara me drejtuesit e njesisë kryesoredhe bazuar në dokumentacionin në dispozicion, GVJ konstatoi se kompetencat dhe aftësitë profesionale që fitojnë studentët e programit të studimit, Master Profesional, Trajner i Përgatitjes Fizike, janë të plota dhe se syllabet e cdo lënde brenda programit të studimit, analizohen dhe shqyrtohen nga pedagogët përkatës, përpara përfundimit të lëndës), me synim që studentët të kuptojnë çfarë kanë përfituar, dhe në cilat aspekte nuk kanë përmbushur pritshmëritë e tyre profesionale dhe shkencore.</p> <p><i>Ref.7, Programi I studimit (Seksioni A/1)</i></p> <p><i>VIZITA në UST</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Gjatë vizitës në UST, GVJ pa nga afër filozofinë e stafit pedagogjik, ku moto është “studenti në qendër”. Gërshetimi i njohurive teorike me aftësimin praktik i cili zë mbi 20%. Ka lëndë që zhvillohen në laboratorë dhe terrene të UST të cilat janë të mirë paisura. Puna në grup mundëson shkëmbimin e ideve innovative midis vetë studenteve dhe me pedagogët përkatës.përfshirjen e studentëve në studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe projekte innovative. Mobiliteti i studentëve nëpërmjet Programeve “Erasmus” ka funksionuar shumë mirë dhe ka dhënë rezultate konkrete</p> <p><i>Ref.10, Politika e jashtëme për mobilitet të stafit dhe të studentëve</i></p> <p><i>VIZITA në UST</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë</p>	<p>Gvj, gjatë guidës në institucion, nga takimet e realizuara me stafin drejtues të njesisë bazë, mbështetur në dokumentacionin përkatës konstatoi që UST ka siguruar marrëveshje bashkëpunimi me kompani, Federata Sportesh, Komitete Olimpikë dhe Universitete Sportive nga më prestigjozet nderkombëtare në fushën e sportit,</p>

strukturës së programit të studimit.	të cilët, në bazë të marrveshjeve, angazhojnë personellet e tyre akademike në trajnime, në lexione të hapura në laboratorë dhe në terren dhe po ashtu mundësojnë mobilitet stafi dhe studentësh etj. <i>Ref.5, Rregullore e Departamentit të Sporteve Individuale (Neni 8,9)</i> <i>VIZITA në UST</i>						
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Gjatë vizitës në institucion, në takimet e realizuara me drejtuesit e njesisë kryesore, bazuar në dokumentacionin në dispozicion, GVJ konstaton që UST nxit zhvillimin e ideve novative të studentëve, i nxit ata drejt studimeve të përparuara kërkimore dhe i mbështet financiarisht ato për ti realizuar këto projekte me sukses. <i>Ref.6, Rregullore e programit të studimit (Neni 6,7)</i> <i>VIZITA ne UST</i>						
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> <i>Programi i Studimit të ciklit të dytë, Master Profesional "Trajner i Përgatitjes Fizike"garanton rritjen e aftësive të thelluara krijuese dhe zbatuese si dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të thelluara të studentëve master, mbështetur në ide innovative e zhvilluese.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Gjatë guidës ne UST, nga takimet e realizuar me stafin drejtues të njesisë kryesore dhe me studentët master, si dhe mbështetur në referencat e disponuara, GVJ u informua që UST, ka hartuar procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse të studentëve në fund të vitit akademik. Këto detyrime përmbyllëse institucioni i publikon, para realizimit të tyre. Për këtë qëllim shërben rregullorja e diplomimit dhe rregullorja e programit të studimit e cila me rend metodik pasqyron tërë procesin nga aplikimi deri te

	<p>formati i dorëzimit, që është mbrojtja e diplomës dhe vlerësimi i komisionit të provimit.</p> <p><i>Ref.6, Rregullore e Programit të studimit (Neni 32,33)</i></p> <p><i>VIZITA ne UST</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Nga takimet e realizuar me stafin drejtues të njesisë kryesore dhe me studentët master, mbështetur në referencat, GVJ, gjatë vizitës në UST, konstatoi që njësia përgjegjëse për përmbushjen e programit të studimit Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike”, asiston studentët që përgatisin punim diplome. Pedagogu udhëheqës, e orjenton studentin, i rekomandon literaturën e duhur, fazat metodike që duhet të ndjekë deri në finalizimin me sukses të projektit. Me të njëjtin zell ndihmohen edhe studentët që i nënshtrohen provimit të përgjithshëm përfundimtarë, pra studentët që nuk realizojnë temë diploma.</p> <p><i>Ref.5, Rregullore e Departamentit të Sporteve individuale (Neni 9, pika H)</i></p> <p><i>VIZITA ne UST</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>GVJ, mbështetur në RVB, referencat në dispozicion, si dhe gjatë vizitës në UST konstatoi që, programi i studimit Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike” me kohë zgjatje 1 vit akademik / 2 semestra, për vetë specifikën e tij, është konceptuar si një rast studimor kompleks. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar është mbështetur në testimin e njohurive që studentët pjesëmarrës, kanë përvetësuar gjatë gjithë ciklit akademik, që lidhet me nevojën e studentit për të zbatuar njohuritë kryesore të përvetësuar, për të dhënë zgjidhje me sukses provimit përfundimtar. Nga ana tjetër, Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit, bazohet në testimin e njohurive të dhëna gjatë gjithë vitit akademik, duke i dhënë hapsirë studentëve të shfaqin plotësisht çfarë ata kanë përvetësuar gjatë gjithë ciklit akademik një vjeçar.</p> <p><i>Ref.6, Rregullore e Programit të Studimit (Neni 24,25,26)</i></p> <p><i>VIZITA ne UST</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, bazuar në RVB, në referencat e vëna në dispozicion si dhe nga takimet e realizuara me drejtues të FSHL dhe DSI, GVJ konstatoi që personeli akademik dhe posaçërisht udhëheqësi i diplomës, është garantues i cilësisë së punimit të diplomës dhe se punimi i studentit nuk mund të pranohet për</p>

<p>asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>mbrojtje pa firmën e yij. Pedagogu udhëheqës, ndjek një rrugë metodike të tillë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përcakton objektin e studimit; - Dobinë e punimit; - Caktimi i tematikës që do trajtohet; - Ndërton strukturën e punimit; - Shqyrton parimet parësore dhe dytësore ku do mbështetet studimi; - Harton punimin e diplomes; - Orjenton debatin pas përfundimit të studimit; <p><i>Ref.4, Rregullore e FSHL (Neni 74)</i> <i>Ref.6, Rregullore e Programit të Studimit (Neni 32,33)</i> <i>VIZITA ne UST</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>GVJ, gjatë vizitës në institucion, konstatoi se planifikimi dhe vlerësimi i veprimtarive kërkimore në FSHL, pa nga afër laboratorët modernë ku studentët zhvillojnë një pjese të mirë të kërkimit shkencor. Gjatë këtij procesi, studentët asistohen për kryerjen e matjeve, të analizave dhe testeve. Të dhënat e vjelura, i nënshtrohen një procesi korrekt të përpunimit kompjuterik të të dhënave që dalin nga kërkimi shkencor i studentit ose grup i studentëve, si diagrama, kurba etj.material ky që pasqyrohet në temën e studimit të studentit.</p> <p><i>Ref.4, Rregullore e FSHL (Neni 117, Veprimtaritë kërkimore në FSHL)</i> <i>Ref.4, Rregullore e FSHL (Neni 118, Planifikimi dhe Vlerësimi I Veprimtarive Kërkimore në FSHL)</i> <i>VIZITA ne UST</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p>	<p>GVJ, konstatoi që studentit vlerësohet me notë, në përfundim të dy formave të përmbylljes së diplomës, me temë diploma dhe me provim përfundimtarë. Kalendarit akademik parasheh dy sezone të mbrojtjes së diplomës. Studenti ka të drejtë të futet dy herë në provimin e diplomës. Kur studentit nuk e merr provimin edhe për herën e dytë, atëherë ai në bashkërendim me udhëheqësin shkencor, duhet të ndërrojë temën e diplomës për një mundësi tjetër alternative.</p> <p><i>Ref.6, Rregullore e programit të studimit (Neni 24,25,26)</i> <i>VIZITA ne UST</i></p>

<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Gjatë vizitës në UST, GVJ konstatoi që në përfundim të diplomës, studenti, pajiset me diplomë dhe me suplementin e Diplomës të miratuar nga MASR. Studentit i vihet në dispozicion një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar</p> <p><i>Ref.6, Rregullore e programit të studimit (Neni 33)</i> <i>Ref.18, Diplomë +Suplimenti</i> <i>VIZITA ne UST</i></p>		
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>GVJ, mbështetur në referencat në dispozicion, konstatoi se UST-ja arkivon një kopje të dokumentacionit të studentit në arshivën e institucionit dhe këtë dosje e paraqet ose e konfirmon rast pas rasti, informacion për studentin nëse ato kërkohen. Ky proces ishte mjaft i organizuar dhe i matrikulluar, sipas rregulloreve dhe ligjeve në fuqi, me qëllim që dosja e studentit të garantohet institucionalisht dhe mbrohet.</p> <p><i>Ref.3, Rregullore e UST-së</i> <i>VIZITA ne UST</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <p><i>IAL, ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit që ndjek ciklin e dytë të studimeve Master Profesional "Trajner i Përgatitjes Fizike" dhe e shoqëron atë me dokumentacionin e nevojshëm, sipas rregulloreve dhe legjislacionit në fuqi</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.6</p> <p>Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies</p>	<p>Referuar RVB-së, dhe dokumentacionit në dispozicion GVJ konstaton se njësitë përgjegjëse të programit të studimit, nga</p>

<p>dhe përftimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>bashkëpunimi me faktorë të tregut të punës dhe kontratat e nënshkruara për këtë qëllim, mundëson kryerjen e praktikës profesionale, pranë institucioneve pritëse të cilët disponojnë në fondin e tyre bazë moderne laboratorike. Ndërsa vetë UST, ka në fondin e saj laboratorë që janë në dispozicion të procesit akademik dhe shërbejnë për realizimin me sukses të praktikave profesionale, praktikat dhe punë laboratorike ku studentët mastër ushtrojnë thellimin e njohurive të tyre të kërkimit shkencorë dhe profesional.</p> <p><i>Ref.6 Rregullore e funksionimit të fakultetit, (Neni 16) VIZITA ne UST</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>GVJ, mbështetur në referencat në dispozicion, konstatoi që institucionet me të cilat UST ka marrëveshje bashkëpunimi, (si brenda vendit ashtu edhe me partnerë ndërkombëtarë), studentëve u mundësohet kryerja e praktikën pranë tyre, që u mundëson atyre të informohen dhe njihen me format, metodat dhe teknologjitë më të fundit bashkohore, me qëllim përfitimin maksimal dhe rritjen dhe thellimin e kompetencave profesionale në fushën që ata studiojnë.</p> <p><i>Ref.10, Politika e jashtëme për mobilitetin e stafit dhe pedagogëve VIZITA ne UST</i></p>
<p>Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>	<p>GVJ, mbështetur në referencat në, konstatoi që studentët e programit të studimit, Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike”, praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë periudhës së studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme, bashkë shoqëruar me vlerësimin përkatës të trajnerëve. GVJ bazuar dhe në referencën 20: <i>Tabela përmbledhëse Tab.9: dhe Plani mësimor 2022-2023</i>, konstaton se praktika profesionale nuk ekziston aktualisht në program, që duhet të përmbledh 10 % të krediteve sipas VKM 41 Lëndë plotësuese (D) por ekziston vetëm si praktik lëndore e inkorporuar në lëndë të ndryshme profesionale. Pedagogu mbikqyrës i praktikës profesionale lëndore dorëzon pranë departamentit të sporteve individuale, formularin e vlerësimit të studentit, krahas formularit të vetë vlerësimit nga studentit dhe vlerësimi përfundimtar i studentit, bëhet para një komisioni të posaçëm vlerësimi, i ngritur për këtë qëllim.</p> <p><i>GVJ sygjeron përfshirjen e lëndës praktikë profesionale si lëndë më vete që duhet të përmbledh 10 % të krediteve sipas VKM 41 në</i></p>

	<p><i>kategorinë e Lëndëve plotësuese (D), në ndryshimet prej 20% që bëhen cdo fundviti sipas udhëzimeve të MAS.</i></p> <p><i>Ref.5, Rregullore e Departamentit të Sporteve Individuale</i></p> <p><i>Ref.6, Rregullore e Programit të Studimit</i></p> <p><i>VIZITA ne UST</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <p><i>IAL ka vënë në dispozicion të Programit të Studimit një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive, nëpërmjet praktikës laboratorike dhe praktikës profesionale, si brenda bazës laboratorike të vetë UST-së, ashtu edhe në klinika e laboratorë, pranë institucioneve me të cilat janë lidhur marrveshje bashkëpunimi dy e më shumë palësh.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për	GVJ, bazuar në RVB, evidencat, vizita në institucion, konstatoi se Personeli akademik efektiv, i angazhuar në realizimin e programit të studimit, të Ciklit të Dytë, Master Profesional në Trajner i Përgatitjes Fizike, janë me grada dhe tituj shkencor duke përmbushur të gjitha kërkesat ligjore në fuqi. Pedagogët e angazhuar në këtë program studimi, janë të kategorisë “Profesor”

nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Referuar evidencës së tabelave përmbledhëse tab nr. 6, të dhënat për stafin e angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi për gjatë vitit akademik 2022- 2023 janë si vijon:

Kualifikimi i stafit	Programi i studimit	
	PAE	PAK
Prof.Dr	3	-
Prof.Asoc	7	-
Dr/PhD	6	-
Msc	1	-
Gjithsej	17	0

Përbërja e stafit akademik me tituj dhe grada përbën dhe një nga pikat e forta të këtij institucioni për programin e studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike”.

Ref. 14. Marrëveshjet (Ngarkesa).pdf

Ref. 5 Rregullore e Departamentit të Sporteve Individuale (Neni 13)

Ref. 20. Tabelat përmbledhëse. tab 6 pdf

Vizita në institucion

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Referuar shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion GVJ, konstaton se personeli akademik efektiv, i cili është i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike”, ka ngarkesë mësimore të përcaktuar në kontratën e punës me UST-ne si dhe, në përputhje me Vendim Nr. 41. Pedagogët që japin mësim në këtë program studimi kanë të paktën gradën shkencore “Doktor” dhe **100%** e ngarkesës mbulohet nga personeli akademik efektiv (PAE). Pedagogët e angazhuar në mësimdhënie janë edhe udhëheqës të temave të diplomës së studentëve.

GVJ gjatë vëzhgimit të ngarkesës mësimore që mbulon stafi akademik vë re se kjo ngarkesë është më e lartë për disa pedagog një dispropocion në shpërndarjen e ngarkesës mësimore.

GVJ sygjeron një rishpërndarje të ngarkesës mësimore për stafin akademik sipas ligjeve në fuqi dhe sipas trajnimeve dhe formimit profesional të stafit akademik.

Ref. 14 Marrëveshjet (Ngarkesa)

Ref. 20. Tabelat përmbledhëse.pdf

<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p><i>Vizita në institucion</i></p> <p>GVJ, bazuar në takimin me drejtues të institucionit si dhe referencat e vëna në dispozicion, vuri re se, UST si një IAL publik, ka kontrata pune për të gjithë stafin akademik me kohë të plotë, që i përket kategorisë “Lektor”, ose “Profesor” sipas ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015. Sic është përshkruar edhe në Kriterin 1 të këtij standardi, UST angazhon vetëm staf akademik me tituj dhe grada, për programin e nivelit të dytë Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike”.</p> <p>GVJ bazuar në këto të dhëna të cilësisë së stafit akademik mendon, se institucioni garanton qëndrueshmëri të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit. GVJ në takimin me stafin e burimeve njerëzore, konstatoi se stafi akademik që nga dita e parë e lidhjes së kontratës së punës me UST-në, i garantohej mbulimi me sigurime shoqërore dhe shëndetësore, duke u deklaruar në organet përkatëse brenda 48 orëve.</p> <p><i>Ref.5. Rregullore e Departamentit të Sporteve Individuale (Neni 13)</i></p> <p><i>Ref. 14 Marrëveshjet (Ngarkesa)</i></p> <p><i>Ref. 20. Tabelat përmbledhëse.pdf</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterë të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ, gjatë takimit me zyrën e burimeve njerëzore, takimin me shefin e departamentit, referencat e vëna në dispozicion vuri re se, UST ka politika dhe procedurë korrekte për rekrutimin e stafit akademik, të bazuar në rregulloren dhe Statutin e UST, në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, Kodin e Procedurave Administrative, LAL të IAL Publike në 80/2015.</p> <p>Politikat dhe procedurat e rekrutimit të stafit akademik përcaktohen nga evidentimi i nevojave për personel të ri sipas programit të studimit ,deri tek vlerësimi i performancës së personelit akademik. Procedura e rekrutimit bëhet me propozim nga departamenti sipas nevojave dhe me miratim nga Rektori. Kriteret propozohen në varësi të vendit të lirë nga struktura përkatëse (Drejtuesi i Departamentit).</p> <p>Kriteret (të përgjithshme dhe preferenciale) dhe dokumentat që duhen si dhe dead line shpallen publikisht, njoftimet bëhen në faqen zyrtare të universitetit, në rrjetet sociale dhe në APP dhe</p>

	<p>përzgjedhja bëhet me konkurs dhe për çdo vend vakant të shpallur. Pranimi i dokumentave bëhet vetëm me rrugë postare. GVJ sic konstatoi vren se, institucioni ndjek procedura ligjore të rregullta dhe transparente të rekrutimit të personelit akademik sipas programit të studimit, mbështetur në kriteret dhe procedurën për punësimin e personelit akademik dhe ndihmës akademik dhe kjo e mbështetur në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, Statutin e Rregulloret e UST-së.</p> <p>Institucioni ka një strukturë të posaçme të emërtuar Zyra e Burimeve Njerëzore e cila ka krijuar një bazë të dhënash për personelin dhe vendet e lira të punës. Përzgjedhja e personelit bëhet, duke marrë në konsideratë mungesat në stafin e brendshëm (sipas kërkesës së departamentit), si dhe ngarkesën mësimore. UST pas mbarimit të dad-line, formon një komision ad-hoc për shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur në rrugë postare me praninë edhe të një përfaqësuesi nga burimet njerëzore. Pas shqyrtimit të dosjes bëhet pikëzimi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, dhe pas kësaj bëhet dhe intervista me gojë (kandidati paraqet një leksion në gjuhë të huaj , kryesisht anglisht).</p> <p>Komisioni bën tabelën përmbledhëse dhe përcakton fituesin dhe jo fituesin të cilin e sqaron për rezultatet e marra (me goje ose me e-mail). Komisioni informacionin ja dërgon dekanatit dhe ky i fundit e përcjell në rektorat i cili kthen përgjigjen për lidhjen e kontratës dhe kostove financiare për kandidatin fitues.</p> <p><i>Ref. 5 Rregullore e Departamentit të Sporteve Individuale (Neni 13,14)</i></p> <p><i>Ref. 9 Burimet Njerëzore</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ gjatë takimit me drejtues të institucionit, takimin me stafin akademik dhe ndihmës akademik si dhe referencat e vëna në dispozicion, konstatoi se, pranë çdo departamenti ka të angazhuar 2 (dy) Personel Ndhmës Akademik, përgjegjës për mirëmbajtjen e ambienteve laboratorike dhe ambienteve të tjera mësimore për programin e studimit. Të drejtat dhe përgjegjësitë e personelit ndihmës mësimor janë të parashikuara në rregulloren e UST. Personeli ndihmës mësimor në bashkëpunim me pedagogët e lëndëve siguron mirëmbajtjen e kabineteve për kryerjen e labortoreve, praktikave mësimore dhe ben grafik sipas orareve</p>

	<p>mësimore që të mos ketë mbivendosje të studentëve në të njëjtën orë. Performanca e tyre matet edhe me anë të pyetësorëve anonim që bëhen dy here në vitë, para sezonit të cdo semestri, si dhe performances vjetore që bëhet nga shefi i Departamentit.</p> <p><i>Ref. 5, Rregullore e Departamentit të Sporteve Individuale (Neni 14)</i></p> <p><i>Ref.19. Qendra e Trajnimit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>GVJ në takimin me drejtues të institucionit, zyrën e burimeve njerëzore, dokumentacionin e vënë në dispozicion, u konstatua se Zyra e Burimeve Njerëzore (ZBNJ) është njësi e ngarkuar me përgjegjësi direkte për ruajtjen e dosjeve personale apo dokumentacionin e të gjithë personelit akademik dhe ndihmës akademik, të angazhuar në programin e studimit. Zyra e BNJ ruan dhe administron një informacion të hollësishëm për personelin. GVJ -së ju vunë në dispozicion nga Zyra e BNJ, të dhënat të depozituara në formë të printuar (dosje fizike të personelit akademik dhe ndihmës akademik me kërkesë të GVJ-së) si dhe një pjesë e tyre dhe në formë elektronike. Pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore gjendet i gjithë dokumentacioni në lidhje me stafin akademik, atij ndihmës akademik dhe administrativ. Pranë zyrës së burimeve njerëzore ruhen dosjet e PE , të cilat up date cdo fund viti me aktivitetin shkencor dhe CV e vitit përkatës. Njësia bazë dhe kryesore mban evidencë për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për secilin semestër dhe vit akademik, qoftë të printuar por edhe në formë elektronike, si dhe ngarkesën , performancën e personelit ndihmës akademik dhe administrativ.</p> <p><i>Ref. 6 Rregullore e Programit të Studimit (Neni 13,14)</i></p> <p><i>Ref. 9 Burimet Njerëzore</i></p> <p><i>Vizitë në institucion</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në</p>	<p>GVJ bazuar në RVB konstaton se, UST disponon kapacitete akademike, si dhe marrëveshje me institucione të tjera, që operojnë në këtë fushë si me: Federate Shqiptare e Futbollit, Federate Shqiptare e Basketbollit, Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, Shoqatës "Program Of Special Olympiks Shqipëtar", University of Rome "Foro Italico", me UMT etj. Gjithashtu GVJ, konstaton se, UST ka në dispozicion personel të mjaftueshëm e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe</p>

<p>praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>veprimtari të tjera specifike sipas programit të studimit, të Ciklit të Dytë Master Profesional“Trajner i Përgatitjes Fizike”.</p> <p><i>Ref. 4 Rregullore e FSHL-së (Neni 69)</i></p> <p><i>Ref. 6 Rregullore e Programit të Studimit (Neni 22)</i></p> <p><i>REF.10. Politikat e Jashtme për mobilitetin e stafit dhe studentët.pdf</i></p> <p><i>Ref. 20. Tabelat përmbledhese (tabela Nr.5 Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese)</i></p> <p><i>Vizitë në institucion</i></p>			
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>GVJ, gjatë takimit me studentët programit të studimit, të Ciklit të Dytë Master Profesional“Trajner i Përgatitjes Fizike”, konstatoi se, studentët në përmbushje të detyrimit të kryerjes së praktikës profesionale, mbikqyren nga një përfaqësues i institucionit, ku ata kryejnë këtë praktikë, mbi bazën e marrëveshjeve specifike që UST, ka me këto institucione, gjë e cila u pohua edhe gjatë takimit me studentët e programit të studimit të cilët u shprehën të kënaqur me këtë praktike pune të ndjekur nga UST-ja.</p> <p>GVJ, bazuar në RVB dhe vizitën në institucion, vuri re gjithashtu se, personeli mbikqyrës në ambientin pritës, për realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, është ndihmues ndaj studentëve, në përmbushjen e detyrimeve dhe raportin përfundimtar të praktikës, si dhe në marrjen pjesë në procesin e vlerësimit të tyre,për praktikën profesionale. Studenti vlerësohet me notë para një komisioni të ngritur nga drejtuesi i departamentit dhe vlerësimi bëhet bazuar në performancën e praktikës të sjellë nga mbikqyrësi i praktikave studentore si dhe provimi me gojë (tema praktike) pra komisionit.</p> <p><i>Ref. 6 Rregullore e Programit te Studimit (Neni 22,23)</i></p> <p><i>Ref.10 Politika e jashtme per mobilitetin e stafit dhe studentet</i></p> <p><i>Vizitë në institucion</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <p><i>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, është me grada dhe tituj të cilat përmbushin standardet sasiore dhe cilësore, në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td style="background-color: #cccccc;">Përmbushet pjesërisht</td> <td style="background-color: #cccccc;">Përmbushet kryesisht</td> <td style="background-color: #cccccc;">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>GVJ gjatë guides në institucion, vëzhgimit të ambienteve konstatoi se UST ka hapsirat e nevojshme për zhvillimin sa më bashkëkohor të programit mësimor, bazuar në numrin e studentëve si dhe infrastrukturën e këtyre ambienteve. Hapsirat mësimore janë pajisur me paisjet e nevojshme didaktike për zhvillimin e leksioneve, seminareve, laboreve dhe orëve praktike. Sallat e leksioneve janë pajisur me PC dhe projektor për prezantimin e leksioneve me Power Point. UST ka gjithashtu në dispozicion salla të kapaciteteve të ndryshme, duke akomoduar studentët sipas llojit të veprimtarisë dhe në përputhje me normativat në fuqi, si dhe me natyrën specifike të programit të studimit.</p> <p><i>Ref. 6 Rregullore e Programit të Studimit (Neni 7)</i></p> <p><i>Ref. 20. Tabelat përmbledhese (tabela Nr.16 mjediset e fakultetit/njësia bazë)</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>GVJ, bazuar në vëzhgimin që u realizua në UST, konstatoi se UST ka aktualisht në përdorim laboratorë mësimorë dhe auditorë të pajisur me mjete audio visive si PC, projektorë dhe foni në rastin e sallave të leksionit. Laboratori i informatikës që është një sallë me sipërfaqe 46 m², është i pajisur me softwarët përkatës në mënyrë që t'i shërbejnë sa më mire studentëve dhe stafit akademik të programit të studimit. GVJ në takimin me drejtuesit e institucionit u informua se UST ka investuar në mënyrë të vazhdueshme për përmirësimin e infrastrukturës së IT, e cila ndihmon stafin dhe studentët në procesin mësimor, si dhe shtimin e aparaturave të teknologjisë bashkëkohore në fushën e kontrollit dhe trajnimit të përgatitjes fizike të sportistëve. Gjithë kjo infrastrukture është realizuar edhe në vazhdimësi falë dhe rikonstrukSIONIT përgjatë viteve në bazë të specifikave të programeve të studimit që ofron, i cili garanton infrastrukturën e nevojshme dhe cilësore për procesin e mësimdhënies. UST për të</p>

	<p>rritur transparencën ndaj studentëve, privatësinë, kontrollin në zbatimin e syllabuseve, kohës mësimore, informacioneve të detajuara për studentin nga dita e regjistrimit në UST deri në diplomimin e tij, bazuar dhe në urdhëresat e MAS përdor Sistemin PITAGORA</p> <p><i>Ref. 2.1 Plani Strategjiki UST-së (Sfondi)</i></p> <p><i>Ref.19. Qendra e Trajnimit.pdf</i></p> <p><i>Ref. 20. Tabelat përmbledhese (tabela Nr.16 mjediset e fakultetit/ njësia bazë)</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>GVJ bazuar në guidën në institucion dhe referencat e vëna në dispozicion konstaton se, UST ka infrastrukturën dhe paisjen me aparaturat përkatëse për zhvillimin sa më korrekt të mësimin në Programin Master Professional “Trajner i Përgatitjes Fizike”. Mësimi zhvillohet në terrene sportive, palestra, laboratorët e fiziologjisë, biomekanikës, biokimisë dhe gjenetikës, të cilët janë të pajisur me aparatura, instrumenta bashkëkohore. Gjithashtu lëndët teorike zhvillohen në salla të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektore, foni dhe internet. Mirëmbajtja dhe azhurnimi i këtyre pajisjeve bëhet ngastafi i IT-se. Gjithashtu, programet kompjuterike në laboratorët e përshkruar më sipër iu janë përshtatur programeve mësimore, duke instaluar programet aplikative, që kërkohen nga departamentet përkatës mësimorë.</p> <p><i>Ref. 2.1 Plani Strategjiki UST-së (Sfondi)</i></p> <p><i>Ref. 20. Tabelat përmbledhese (tabela Nr.16 mjediset e fakultetit/ njësia bazë)</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion vuri re se në mesin kryesore ndodhet një laborator i informatikës me sipërfaqe 46 m², një sallë internet me sipërfaqe 36 m² i cili është i pajisur me PC, internet dhe softwaret e nevojshëm për kërkimin shkencor në shërbim të studentëve dhe stafit akademik, sic është SPSS, të pajisur me programe profesionale, sipas natyrës së programit të studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike”. Pajisjet e tjera kompjuterike dhe laboratorët e biomekanikës dhe fiziologjisë, janë të pajisur me softwete të dedikuara për kërkimin shkencor dhe procesin akademik në fushën e sportit dhe trainimit.</p> <p><i>Ref. 20. Tabelat përmbledhese: (tabela Nr.16,17)</i></p>

	<i>Vizita në institucion</i>		
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	<p>GVJ bazuar në referencat e vëna në dispozicion si dhe takimin me drejtues të institucionit mendon se, UST garanton jo vetëm infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor dhe veprimtarive praktike, por edhe bashkëpunim me institucione publike dhe jo publike, organizata kombëtare dhe ndërkombëtare të tjera në funksion të praktikave profesionale të studentëve.</p> <p>GVJ gjatë takimit me drejtues të institucionit, u informua se UST ka marrëveshje bashkëpunimi refruar, me institucione të arsimit të lartë, që operojnë në fusha të njëjta apo të ngjashme me UST, me Federata sportive të ndryshme kombëtare, KOKSH, specifikisht për këtë program studimi me FSHF, me përfaqësues biznesi e kompani që operojnë brenda fushave, me të cilët UST bashkëpunon në përshtatje me natyrën e programit të studimit.</p> <p><i>Ref. 2.1 Plani Strategjiki UST-së (Sfondi)</i></p> <p><i>Ref.20. Tabelat përmbledhese: (tabela Nr.5 Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese),</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>		
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <p><i>IAL vë në dispozicion të studentëve, mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të programit të studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional "Trajner i Përgatitjes Fizike".</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e	GVJ bazuar në dokumentat e vëna në dispozicion, vizitën në institucion, u informua se studentët kanë në dispozicion një game të gjërë tekstesh dhe literature shtesë të cilat përditësohen

<p>programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>vazhdimisht. Pedagogët cdo vit përditësojnë ciklin e leksioneve dhe e depozitojnë atë ne Departamentin përkatës. UST ka akses edhe në disa biblioteka online U-library, ku studentët dhe stafi akademik mund të lexojnë dhe të shkarkojnë shumë libra qoftë për literaturën bazë, poashtu dhe për literaturën e rekomanduar, sipas syllabuseve të lëndëve, me anë të përdorimit të manualit për përdorimin e bibliotekës digjitale. Në bibliotekë, kishte një numër të madh librash dhe literature të pasur si në format të printuar por edhe në formë elektronike rreth 1435 libra, si dhe punime shkencore si më poshtë:</p> <p>disertacione 98 punime, mikroteza të punimeve studentore 105; atlase të ndryshme 11, lista të titujve periodike 305, materiale audiovizive 30. Librat janë kryesisht në dy gjuhë, anglisht dhe shqip, janë të grupuara sipas tematikave dhe programeve të studimit. Rinovimi me titujt e rinj përzgjidhen sipas nevojave dhe kërkesave të studentëve dhe stafit akademik.</p> <p>Biblioteka e UST, cdo vit akademik kërkon nga departamentet pasqyrimin e ndryshimeve të bëra në literaturën bazë dhe të rekomanduar nga titullarët e lëndëve dhe moduleve, që përditësojnë syllabuset e tyre me literature bashkëkohore.</p> <p><i>Ref.20. Tabelat përmbledhese: (tabela Nr.17 të dhëna të plota për platformën on line/struktura e teknologjisë së informacionit/ biblioteka/ biblioteka on line)</i></p> <p><i>Ref. 11. Funkzioni i Bibliotekës.pdf</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Gjatë takimit me stafin akademik GVJ konstatoi, se për çdo program lënde përditësohej literatura me botime të viteve të fundit. Në fund të çdo syllabusi, ka rubrikën e literaturës bazë dhe literaturës së rekomanduar, dhe stafi akademik cdo fillim viti akademik sipas lëndëve përkatëse përditëson temat e leksioneve, përditëson dhe literaturën përkatëse bazë dhe të rekomanduar. Pedagogu bën kërkesën në mbledhjen e departamentit për literaturën e përditësuar, këto kërkesa përcillen në njësinë kryesore dhe planifikohen në planin vjetor të përditësimit të bibliotekës. GVJ konstaton se UST, në cdo vit në plan buxhetin e institucionit planifikohet edhe fondi për pasurimin e bibliotekës me libra dhe literaturë të 10 viteve të fundit.</p> <p><i>Ref. 5 Rregullore e Departamentit të Sporteve Individuale Neni 9 pika g)</i></p>



	<p><i>Ref.20.Tabelat përmbledhese: (tabela Nr., 9, 16)</i></p> <p><i>Ref. 11. Funksioni i Bibliotekës.pdf</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se, UST ka një bibliotekë universitare, e cila ka mjedise të mjaftueshme, një hapsirë 38 m² që ju shërben studentëve të programit të studimit dhe mund të shfrytëzohet lirisht nga studentët që ndjekin këtë program studimi dhe kanë mundësi të konsultojnë apo shkarkojnë libra sipas literaturës bazë apo të rekomanduara, sipas orareve të funksionimit të këtij institucioni. Biblioteka ofron hapësira të dedikuara për studentët për leximin si dhe një fond të pasur të librave universitarë. GVJ sic është shprehur dhe më lart konstaton se biblioteka e UST zotëron gjithsej 1435 libra, nga këto në shqip janë 378 tituj dhe në gjuhë të huaj 1057.</p> <p><i>Ref. 11. Funksioni i Bibliotekës.pdf</i></p> <p><i>Ref.20.Tabelat përmbledhese: (tabela Nr. 9, 16, 17)</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ gjatë takimeve në institucion konstatoi se UST ka vënë në dispozicion përdorimin e librarive elektronike ku studentët mund të konsultohen me materiale ndërkombëtare sipas manualit të përdorimit elektronik të bibliotekës. Biblioteka e Universitetit është e pasur me tekste universitare, libra e revista shkencore në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore të parashikuara për student të programit të studimit. GVJ konstaton se biblioteka e UST zotëron gjithsej 1435 libra, nga këto në shqip janë 378 tituj dhe në gjuhë të huaj 1057.</p> <p>Biblioteka e UST furnizohet vazhdimisht me botime periodike që në bibliotekë UST janë, lista të titujve periodike 305. GVJ në takimin me studentët u informua se studentët kanë të gjithë akses në bibliotekë fizikisht dhe on line. Studentët dhe stafi akademik në mënyrë periodike shrytëzojnë literaturën fizikisht në bibliotekë, e cila pasurohet vit pas viti. Gjithashtu kanë akses në librarin elektronik me anë të Sage, Koha, Ebsco dhe Pubmed Biblioteka e institucionit zotëron edhe katalogun e librave elektronik icili lehtëson gjetjen e literaturës në gjuhë të huaj që janë me shumicë.</p> <p><i>Ref. 11. Funksioni i Bibliotekës.pdf</i></p>

	<p><i>Ref.20.Tabelat përmbledhese: (tabela Nr., 16 17)</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ, bazuar në referencat si dhe takimin me drejtues të institucionit, stafin akademik, studentët dhe punonjësit e bibliotekës konstaton se, UST mbështet dhe përditëson literaturën në bibliotekë qoftë me libra fizik por edhe me anë të burimeve online sipas kërkesave të pedagogëve dhe studentëve. UST ka në bibliotekë rreth 31 botime periodike, në gjuhë të huaj (anglisht, frëngjisht, italisht). Të gjithë pedagogët dhe studentët e programit të studimit, kanë akses pa pagesë në biblioteke fizikisht cdo ditë sipas orarit të bibliotekës, nga ora 8.00- 20.00, si dhe nëpërmjet linkut që i jepet nga biblioteka cdo studenti dhe pedagogu për tu futur on line.</p> <p><i>Ref. 11. Funksioni i Bibliotekës.pdf Biblioteka është në fuksion të studentve dhe personelit akademik. ebsco.com/academic-libraries, Pubmed.ncbi.nlm.nih.gov</i></p> <p><i>Ref.20.Tabelat përmbledhese: (tabela Nr.17 të dhëna të plota për platformën on line/struktura e teknologjisë së informacionit/ biblioteka/ biblioteka on line)</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>GVJ, konstaton se biblioteka e UST-së është e pajisur me PC në mënyrë, që studentët të kenë mundësi të aksesojnë bibliotekat online të vëna në dispozicion nga UST. UST ka në dispozicion të studentëve një sallë internet me sipërfaqe 38 m² dhe bibliotekën. Biblioteka është e pajisur me 12 kompjutera dhe programe kompjuterike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve dhe stafit akademik.</p> <p><i>Ref. 11 Biblioteka është në funksion të studentëve dhe personelit akademik. Shih infrastrukturën (12 kompjutera)</i></p> <p><i>Ref.20.Tabelat përmbledhese: (tabela Nr.17 të dhëna të plota për platformën on line/struktura e teknologjisë së informacionit/ biblioteka/ biblioteka on line)</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe</p>	<p>GVJ, gjatë vizitës në UST konstatoi dhe vuri re të afishuar mënyrën e organizimit të punës në bibliotekë. GVJ u informua nga punonjësit e bibliotekës se për mbarëvajtjen e punës, bëhet një grafik orari që të mos ketë mbingarkesë në bibliotekë, si dhe orarin e punës. Biblioteka në UST është e hapur në shërbim të studentëve sipas programeve si dhe stafit akademik cdo ditë jave, nga e Hëna</p>

<p>të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>në të Premte nga ora 8:00-20:00. Gjatë sezonit të provimeve biblioteka e UST-së, funksionon edhe ditën e shtunë, me orar të zgjatur sipas nevojave të studentëve për literaturë. Oraret e shërbimit në bibliotekë janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor, duke ditur se studentët e programit të studimit, mësimin e zhvillojnë mbas dite prandaj orari është deri në ora 20.00 ose dhe të shtunave në rast nevojë. GVJ nisur nga numri i studentëve të programit të studimit (18), mendon se janë kapacitet e mjaftueshme për shfrytëzimin sa më të mirë të saj.</p> <p><i>Ref. 11 Biblioteka është në funksion të studentëve dhe personelit akademik. Shih infrastrukturën (12 kompjutera)</i></p> <p><i>Ref.20. Tabelat përmbledhese: (tabela Nr.17 të dhëna të plota për platformën on line/struktura e teknologjisë së informacionit/ biblioteka/ biblioteka on line) (tabela Nr.21 Cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve)</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>GVJ në takimin me drejtues të institucionit, me studentët me stafin akademik, me punonjësit e bibliotekës vuri re një shfrytëzim maksimal të hapsirave të bibliotekës nga studentët dhe stafi akademik. Punonjësit e bibliotekës qëndrojnë në dispozicion të tyre për hapjen e kartelave individuale për librat fizikë, ose për të ndihmuar në aksesimin on line për literatura të ndryshme. GVJ u informua nga punonjësit e bibliotekës, se ata bëjnë raport cdo fundviti mbi shfrytëzimin e kapaciteteve të bibliotekës numrin e librave fizikë të qarkulluar nga studentët dhe stafi, shfrytëzimin e bibliotekës on-line, inventarizimin e librave fizikë si dhe kërkesa për fond biblioteke (fizike dhe on-line), bazuar edhe në kërkesat e cdo departamenti sipas programeve, moduleve përkatëse bazuar në përditësimin e syllabuseve të programit të studimit.</p> <p>GVJ në dokumentat e vëna në dispozicion, konstatoi se në raportin vjetor financiar ekziston dhe fondi i bibliotekës, tabela Nr.18 të ardhurat dhe financimete ndryshme për tre vitet e fundit për zërin Libra, i cili miratohet nga Bordi i Administrimit të UST.</p> <p><i>Ref. 11 Biblioteka është në funksion të studentëve dhe personelit akademik</i></p> <p><i>Ref.20. Tabelat përmbledhese: (tabela Nr.17 të dhëna të plota për platformën on line/struktura e teknologjisë së informacionit/ biblioteka/ biblioteka on line) (tabela Nr.18 të ardhurat dhe financimete ndryshme për tre vitet e fundit)</i></p>

	<i>Vizita në institucion</i>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <p><i>IAL vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme, për këtë program studimi dhe ka literaturën e nevojshme (literature shqip dhe në gjuhë të huaj), jo vetëm për lëndët e përgjithëshme, por edhe për lëndët profesionale, në mbështetje të mësimdhënies dhe të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se UST disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. GVJ bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, dhe vizitës në institucion, konkludon se UST ka struktura që nisin nga njësia bazë, sekretaria e cila disponon informacionin që lidhet me studentët mbi aktivitetin e tyre akademik nga hyrja në institucion deri në përfundim të studimeve (diplomimit). UST ka në dispozicion rregjistrat themeltar (fizik) që në si GVJ i vëzhguam gja të takimit me sekretarinë mësimore, por ka në funksion edhe systemin e Pitagorës i cili është sistemi i lidhur me QSHA dhe RASH.</p> <p>UST e ruan këtë data bazë, duke konsideruar këto të dhëna si pikë e fortë reference për të bërë dhe përpunime statistikore në vazhdim për cilësinë e studentëve në hyrje dhe deri në diplomim. USTpërvec sistemit të Pitagorës, menaxhon aktivitetin e brendshëm edhe me platformën on-line U-TRANSPARENCA, i cili është në bashkëpunim me AKSHI-n, me një kontratë pa limit.</p>

	<p><i>Ref. 1, Ligji I IAL; Neni 49 "Funksionet e Bordit të Administrimit"</i></p> <p><i>Ref.6, Rregullore e Programit të Studimit; Neni 10 "Kriteret e pranimit" dhe Neni 11 "Regjistrimet".</i></p> <p><i>Ref.20. Tabelat përmbledhese: (tabela Nr.17 të dhëna të plota për platformën on line/struktura e teknologjisë së informacionit/ biblioteka/ biblioteka on line)</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion, me stafin e IT- së, studentët dhe stafin akademik konstatoi se, sistemi për menaxhimin e informacionit PITAGORA është i aksesueshëm dhe nga personeli akademik që e përdor atë për aktivitetin në kuadër të procesit të mësimdhënies (leksione, seminare, praktika, detyra kursi, provime të ndërmjetme, provimin përfundimtar) Sistemi i Pitagorës gjithashtu i mundëson studentit të përditësohet në kohë reale me të gjithë informacionet që pedagogu hedh në sistem si vlerësime, frekuentim, silabusin e lëndës etj. GVJ, vë re se sistemi i brendshëm i menaxhimit është hallkë kryesorenë UST, jo vetëm në administrimin e informacionit dhe të dokumentacionit të ruajtur, në lidhje me aktivitetin e personelit akademik dhe atij ndihmës akademik, apo personelit administrativ dhe partnerëve të përfshirë në realizimin e programit të studimit, or edhe për të bërë të mundur kontrollin periodik të aktivitetit mësimor të gjithë strukturave të përfshira në procesin mbarëvajtjes së procesit mësimor.</p> <p><i>Ref.1. Ligji i IAL-së.pdf</i></p> <p><i>Ref.3. Rregullore e UST-së.pdf</i></p> <p><i>Ref.4. Rregullore E FSHL-së.pdf</i></p> <p><i>Ref.5. Rregullore e Departamentit të Sporteve Individuale.pdf</i></p> <p><i>Ref.6. Rregullore e Programit të Studimit.pdf</i></p> <p><i>Ref.20. Tabelat përmbledhese: (tabela Nr.17 të dhëna të plota për platformën on line)</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ, gjatë guides në institucion, në takimet e realizuara me stafin, studentët, sekretarinë, IT etj, konstatoi se funksionet e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit kanë të bëjë në me komunikimin e vazhdueshëm dhe në kohë reale midis stafit akademik dhe studentëve, duke bërë të mundur shkëmbimin e materialeve literaturës, njoftimeve mes pedagogut dhe studentëve. I gjithë informacioni dhe aktiviteti pedagog - studentë, nga ky system</p>

	<p>menaxhimi i ruan aktivitetet e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, apo personelit administrative. Në system janë të hedhura të dhënat për strukturën akademike, të dhënat e studentit vlerësimet kohë pas kohe deri në diplomim pranimin. Systemin elektronik të Pitgorës e përdor shumë dhe ndihmon në mbarëvajtjen dhe dokumentimin elektronik të punës edhe sekretaria mësimore, ku hedh të dhënat për studentët që nga regjistrimi, transferimet, vlerësimet sipas lëndëve dhe viteve, diplomimin etj. Drejtoria e financave ka akses në system për të dokumentuar menaxhimin e tarifave të programit të studimit, bursat për studentët e programit të studimit.</p> <p><i>Ref.20. Tabelat përmbledhese: (tabela Nr.17 të dhëna të plota për platformën on line)</i></p> <p><i>Ref. 41. Akses online në systemin PITAGORA)</i> https://ust.pitagora.rash.al/login?fac_id=10000</p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>GVJ, bazuar në RVB, guidës në institucion, takimin me drejtues të institucionit konstaton se, UST për mbarëvajtjen e procesit mësimor, bashkëveprimin institucional staf akademik, ndihmës akademik, administratë dhe studentëve bëhet e mundur komunikimi dhe shkëmbimi i materialeve didaktike krahas sistemit të Pitagorës ka në funksion edhe platformën e Microsoft Teams, që mundëson komunikimin interaktiv dhe shkëmbimin të informacionit, të materialeve didaktike dhe informacionit në formë njoftimesh ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p> <p><i>Ref.20. Tabelat përmbledhese: (tabela Nr.17 të dhëna të plota për platformën on line)</i></p> <p><i>Ref. 41. Akses online në systemin PITAGORA)</i> https://ust.pitagora.rash.al/login?fac_id=10000</p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Në takimin me drejtues të institucionit dhe punonjësit e IT, u informuam se, sistemi i Pitagorës bën të mundur monitorimin e procesit të mësimdhënies, administrimit e provimeve dhe të vlerësimeve. Ky sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale të çdo anëtari të stafit akademik. Sistemi elektronik i informacionit gjithashtu shmanë vonesat në informim të studentëve për rezultatet e vlerësimit dhe rrit transparencën e mësimdhënies dhe të vlerësimeve përkatëse. Ky sistem me të dhënat</p>

	<p>e hedhura, gjithashtu ndihmon institucionin për një përpunim statistikor të të dhënave.</p> <p><i>Ref.5. Rregullore e Departamentit të Sporteve Individuale.pdf</i> <i>Ref.6. Rregullore e Programit të Studimit.pdf</i> <i>Ref.20. Tabelat përmbledhese: (tabela Nr.17 të dhëna të plota për platformën on line)</i> <i>Ref. 41. Aksesi online në systemin PITAGORA)</i> https://ust.pitagora.rash.al/login?fac_id=10000 <i>Vizita në institucion</i></p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion, takimit me stafin, studimin e faqes zyrtare të institucionit konstaton se, institucioni ka në administrim faqen zyrtare https://ust.edu.al/njoftim-per-vazhdimin-e-aplikimeve-per-masterin-profesional-trajner-i-pergatitjes-fizike, të cilat janë në përputhje me politikat e transparencës dhe politikat e privatesisë sipas legjislacionit në fuqi. Përmbajtja e faqes ofrohet në dy gjuhë njëra është në gjuhën shqipe dhe tjetra anglisht. Platforma e U-Transparencës është një tjetër hapësirë elektronike ku shfaqet informacioni dhe vendime të ndryshme të institucionit. Llogaritë në rrjetet shoqërore janë gjithashtu mundësi informimi për njoftime të ndryshme.</p> <p><i>Ref.1. Ligji i IAL-së.pdf</i> <i>Ref.3. Rregullore e UST-së.pdf</i> <i>Ref.4. Rregullore E FSHL-së.pdf</i> <i>Vizita në institucion</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <p><i>UST, disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit Master Profesional "Trajner i Përgatitjes Fizike".</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.5



Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentat e vëna në dispozicion, RVB, takimi me drejtues të njësisë kryesore dhe takimi me punonjësit e zyrës ekonomike, konstatoi se ekziston një raport financiar për mbulimin e shpenzimeve në nivelin institucional i cili hartohet mbi bazën e kostove dhe financimeve. Tek financimet hyjnë granti i akorduar nga pushteti qendror dhe fondet jopublike të cilat janë në rritje nga viti në vit. Granti i akorduar është i plotë dhe siguron financim për të gjithë programin e studimit, duke mbuluar kostot deri në përfundim të programit. Institucioni bazuar dhe në udhëzimet e MAS, garanton bursa për studentët ekselentë, po ashtu për studentët me prindër invalid ose ndihmë ekonomike. Shpenzimet për program të dytë studimi mbulohe nga tarifat e shkollimit. Të ardhurat e gjeneruara nga institucioni në formë tarifash shkollimi, donacionesh, sponsorizimesh, et., shkojnë gjithashtu në mbështetje të programit të studimit duke siguruar infrastrukturë mbështetëse për procesin mësimor, si hapësira, mjete, pajisje e të tjera si këto. Institucioni bazuar dhe në udhëzimet e MAS, garanton bursa për studentët ekselentë, po ashtu për studentët me prindër invalid ose ndihmë ekonomike. Institucioni po ashtu mbështet financiarisht dhe pedagogët për kërkim shkencor edhe/ose publikim artikujsh dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore.</p> <p><i>Ref.17 Financa; Pasqyrat financiare të vitit 2021; Situacioni I shpenzimit 2021-2022; Akt-rakordimi I të ardhurave për 2021-2022.</i></p> <p><i>Refrencës 20.Tabelat përmbledhese</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>

<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Bazuar në, dokumentat e vëna në dispozicion, takimit me drejtuesit e njësisë kryesore GVJ, u informua se në cdo fund viti bëhet plani i financimit nga njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit bazuar në orët e programit të studimit. Plani i financimit të programit përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës dhe aksesin në bibliotekat on-line, materiale dhe pajisje laboratoritrike.</p> <p>Ky plan financiar i dërgohet senatit të universitetit nga njësia kryesore, Senati Akademik miraton propozimin e Rektoratit, dhe ia kalon më pas Bordit të Administrimit për miratim. Bordi i Administrimit nga ana e tij miraton planin financiar dhe ngarkon Administratorin dhe Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e tij. Plani i financimit hartohet në nivel institucional. Është duke u punuar që në të ardhmen të hartohen plane financimi në rang programi studimi. Në këtë plan planifikohen fonde për kërkimin shkencor ,projektet vendase , apo të huaja të përfituara, si dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit</p> <p><i>Ref.17 , Financa “Plan buxhetor afat mesëm për vitin 2023-2025 për UST-në miratuar me Vendimi Bordit të Administrimit Nr. 36, dt.01.08.2022”</i></p> <p><i>Refrencës 20.Tabelat përmbledhese</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>GVJ u informua nga drejtuesit e institucionit se institucioni harton pasqyra financiare të hollësishme brenda afateve të parashikuara për deklarimin e dorëzimit e pasqyrave financiare. GVJ u informua se, në fund të cdo programi studimi, institucioni rishikon koston e një programi studimi, që mund të rezultojë në një ndryshim eventual të financimit. GVJ u informua se institucioni cdo fund viti pasi vlerëson koston e studimit dhe në bazë të vitit të mëparshëm propozon kuotat e studimeve për cdo program si dhe koston e studimeve përkatëse. Këto kuota dhe kosto propozohen nga njësitë bazë, dërgohen në njësinë kryesore dhe miratohen në senatin akademik istitucional. Institucioni bën auditim të brendshëm cdo fund viti dhe po ashtu pret auditim nga jashtë institucionit. Raporti i auditit i përcillet edhe Bordit të Administrimit. Auditet në përgjithësi bëhen nga MAS, pothuaj cdo vit për infrastrukturën dhe</p>

	<p>financat. I gjithë aktiviteti financiar i institucionit, është subjekt auditimi nga MAS. Misioni i auditimit të brendshëm apo të jashtëm konsiston në auditimin e zbatimit të rekomandimeve të mëparshme, auditimin e organizimit dhe mbajtjes së kontabilitetit, auditimin e krijimit dhe menaxhimit të të ardhurave, etj. Institucioni me marrjen e raportit të auditit merr masa për hartimin e një plan veprimi me qëllim implementimin e rekomandimeve dhe sugjerimeve të grupit të auditit. Raporti i auditit përcillet edhe Bordit të Administrimit. Auditet në përgjithësi bëhen nga MAS, të cilat bëhen pothuaj cdo vit për infrastrukturën dhe financat e UST.</p> <p><i>Ref.1. Ligji i IAL-së.pdf</i></p> <p><i>Ref.3. Rregullore e UST-së.pdf</i></p> <p><i>Ref. 17 Financa; Vendimi I Bordit të Administrimit, Nr. 60, dt.21.12.2022.</i></p> <p><i>Ref.17, Financa "Plan buxhetor afat mesëm për vitin 2023-2025 përUST-në miratuar me Vendimi Bordit të Administrimit Nr. 36, dt.01.08.2022".</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>GVJ u informua nga drejtuesit e institucionit se institucioni dorëzon në mënyrë periodike pasqyrat financiare në nivel institucional, ende jo në nivel programi. Plani financiar i hartuar parashikon që të garantojë vazhdimësinë e ofrimit të programit të studimit. GVJ konstatoi se, në mes dhe në fund të një program studimi, institucioni rishikon koston e një program studimi, që mund të rezultojë në një ndryshim eventual të financimit, përse i përket propozimit për koston e studimeve përkatëse si dhe kuotat e studimeve për cdo program, këto kuota dhe kosto propozohen nga njësitë bazë, dërgohen në njësinë kryesore dhe miratohen në senatin akademik institucional.</p> <p><i>Ref.17 Financa;Akt rakordimi i të ardhurave për periudhën Janar-Dhjetor 2022-2023".</i></p> <p><i>Refrencës 20.Tabelat përmbledhese: (Tabela Nr.13 Ngarkesa totale në auditorë e studentëve për format e mësimdheënies në programin e studimit;</i></p> <p><i>Tabela Nr.18 Të ardhurat dhe financime të ndryshme të tre viteve të fundit;</i></p> <p><i>Tabela Nr.19 Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik në rang departamenti/fakulteti;</i></p>

	<i>Tabela Nr.20 Të dhëna për bashkëpunime kombëtare dhe ndërkombëtare të institucionit)</i>			
	<i>Vizita në institucion</i>			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	GVJ bazuar në takimin me drejtuesit e institucionit, dokumentat e vëna në dispozicion mendon se UST, garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programit të studimit. GVJ, gjithashtu, konstaton se, buxheti financiar fillon të hartohet që në muajin shkurt të çdo viti dhe miratohet nga Rektorati, Senati Akademik dhe Bordi Administrimit. Për zbatim të këtij buxheti, ngarkohet Administratori dhe Drejtorja e Financës dhe Buxhetit. Projekt buxheti hartohet në mënyrë të tillë ku përcaktohet çdo muaj një raport i saktë i të ardhurave dhe shpenzimeve, duke përcaktuar dhe rezervat e nevojshme për shpenzimet që kanë prioritet në vazhdimësi. Për çdo veprim blerje dhe shitje Drejtorja e finances dhe Buxhetit, pajiset me urdhër të miratuar nga Administratori. Veprimet e UST-së kryhen vetëm nëpërmjet sistemit të Thesarit dhe atij bankar duke siguruar transparencë të plotë të shpenzimeve. GVJ gjatë takimit me drejtues të institucionit, u informua se, UST dëshmon ka qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen. Ref. 17 <i>Financa</i> ; “ <i>Grandi i mësimdhënies për vitin 2023</i> ”.			
	<i>Vizita në institucion</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> <i>UST garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve për programin e studimit Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike”.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>GVJ gjatë bashkëbisedimit me drejtues të institucionit, studentët, koordinatorin e programit, sekretarinë mësimore, RVB, referencave të vëna në dispozicion konstatoi se ky institucion harton politika dhe procedura të sakta gjatë vitit akademik të studentëve (në hyrje dhe në përfundim të studimeve), në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi. Ndiqet një radhë pune si më poshtë: në bazë të Dekreteve të nxjerra çdo vit nga Ministria Shqiptare e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Procesi i pranimeve në UST organizohet në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi. Pranimi në këtë program studimi është me numër të caktuar kuotash. Çdo vit senati i UST miraton kuotat e pranimit, kriteret e pranimit, vendet e disponueshme, për të gjitha kategoritë dhe publikohen në faqen e internetit të institucionit. Për sa më sipër kuotat për cdo kategori studentësh caktohen çdo vit dhe publikohen në faqen e internetit nëpërmjet njoftimeve të pranimit sipas Ligjit të Arsimit të Lartë në Shqipëri Nr. 80/2015 si dhe dhe dekretet e vendimeve të nxjerra çdo vit nga Ministria Shqiptare e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të cilat përcaktojnë procedura të regjistrimit dhe afatet përkatëse. Një kopje e këtyre vendimeve të Senatit Akademik në formë shkresore-letër dhe në formë elektronike dërgohet në MASR.</p> <p>Procedurat e pranimit bëhen të njohura në faqen zyrtare të UST me anë të shpalljeve dhe njoftimeve të pranimit, të cilat përmbajnë informacione të hollësishme për vendet e disponueshme dhe kriteret e pranimit. Po ashtu në kuotat e pranimit, ka kuota të caktuara jo vetëm për shtetas të Shqipërisë dhe vendeve jo nga BE, kuota për transferime, të gjithë studentët të cilët duan të rregjistrohen në UST për programin e studimit. Kriter që duhet të plotësoj studentit është që të ketë mbaruar nivelin bachelor të studimeve në shkencat sportive si psh në fizioterapi, edukim fizik etj .Studentët nga hyrja deri tek diplomimi i tyre është i rregulluar në bazë të akteve ligjore e nënligjore në fuqi të ardhura nga MAS, rregullores dhe statutit të institucionit, rregullores së fakultetit dhe</p>

	<p>rregullores së programit të studimit, të hartuara e të përditësuara vazhdimisht në përputhje të këtij legjislacioni. Institucioni dhe njësia përgjegjëse për ofrimin e programit kujdeset që të ndjekë ecurinë e studentit gjatë gjithë procesit, duke hartuar dhe zbatuar politika dhe procedura përkatëse</p> <p><i>Ref.2 Statuti(Misioni)</i></p> <p><i>Ref.4, Rregullore e FSHL-së; Neni 5,68</i></p> <p><i>Ref.6, Rregullore e programit të Studimit; pika 10, 11</i></p> <p><i>Ref. 13. Sekretaria.pdf</i></p> <p><i>Ref.13.1 Sekretaria.pdf</i></p> <p><i>Ref.13.2 Sekretaria.pdf</i></p> <p><i>Ref.13.3 Sekretaria.pdf</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vlerësimit të referencave, vizitës në institucion, GVJ konstati se UST nëpërmjet politikave dhe procedurave, garanton barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët dhe studentët e programit të studimit. Institucioni respekton të drejtat dhe barazinë e çdo individ, duke respektuar bindjen fetare; origjinën sociale, përkatësinë ndaj një grupi të caktuar; orientimi seksual dhe identiteti gjinor; bindjen fetare etninë; etj. Gjatë vizitës në institucion u konstatuan, facilitete në auditoret për aksesueshmërinë e tyre nga personat me aftësi të kufizuara. Në takimin me sekretarinë konstatuam se ekzistonin rregjistra të cilat tregonin të gjithë praktikën e rregjistrimit apo të crregjistrimit të studentëve fitues sipas kriterëve të paracaktuara, pa bërë dallime se kujt i përkisnin këto kuota (student shqipëtar, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë dhe Bosnjë– Hercegovinës). Pavarësisht këtyre kuotave të miratuara, në këto vite nuk ka patur rregjistrime, po ashtu ka dhe kuota të miratuara dhe për personat me aftësi ndryshe, por përsëri nuk ka patur rregjistrime. Kjo tregon barazi institucionale për çdo student.</p> <p><i>Ref. 13. Sekretaria.pdf</i></p> <p><i>Ref.13.1 Sekretaria.pdf</i></p> <p><i>Ref.13.2 Sekretaria.pdf</i></p> <p><i>Ref.13.3 Sekretaria.pdf</i></p> <p><i>Ref.6, Rregullore e programit të Studimit; pika 10, 11</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>

Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.

GVJ gjatë shqyrtimit të RVB dhe takimit me drejtuesit e institucionit , u informua se, para çdo viti akademik, në afatet e përcaktuara nga MASR organizohen “ditët e informimit të maturantëve” për programet bachelor dhe Master që ofron UST. Staf i ngarkuar për informim organizon takime, shpërndan fletëpalosje ku sqarohen të interesuarit me informacionin e nevojshëm për kriteret e pranimit apo për çështje të tjera të lidhura me të. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike janë lehtësisht të aksesueshme edhe në web e UST, por jo vetëm, procedurat i bëhen të ditura të interesuarve në zyrën e sekretarisë mësimore në oraret e përcaktuara për sqarime dhe shërbime dhe gjatë këshillimit e orientimit të ofruar nga zyra përgjegjëse në rang fakulteti e institucioni. Kriteret dhe procedurat përkatëse për ofrimin e programit të studimit janë hartuar në mënyrë që të jenë të kuptueshme, dhe njëkohësisht të aksesueshme, çka i jep procesit transparencë të plotë. Në fillim të cdo viti akademik realizohet procedura e regjistrimit dhe transferimit të studentëve udhëzimeve dhe legjisllacionit në fuqi. Institucioni parashikon dhe regjistrimin e studentëve të huaj sipas kriterëve të përcaktuara në kuadrin ligjor.

Website i programit të studimit. Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike”. – UST.

Ref.2 Statuti(Misioni)

Ref.4, Rregullore e FSHL-së; Neni 5,68

Ref.6,Rregullore e programit të Studimit; pika 10, 11

Vizita në institucion

Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.

GVJ bazuar në dokumentat e dorëzuar nga institucioni dhe takimi me studentët vëren se kriteret, procedurat e përzgjedhjes dhe pranimit të studentëve, përparimi përgjatë kursit të studimit, transferimi, njohja e studimeve të mëparshme ose të pjesshme, vlerësimi i dijeve dhe diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku pasi janë të përcaktuara në rregulloret e studimit të Fakultetit dhe departamentit si dhe online në web e UST. Gjatë intervistës me studentët u konfirmua se institucioni ndjek një politikë të orientimit dhe këshillimit të tyre. Informacioni është i aksesueshëm nga burime si: sekretaria mësimore, faqja zyrtare është gjithashtu e aksesueshme on-line ku gjenden dhe aktet rregullatore, të cilat i vihen në dispozicion studentëve.

	<p><i>Ref.2 Statuti(Misioni)</i></p> <p><i>Ref.4, Rregullore e FSHL-së; Neni 5,68</i></p> <p><i>Ref.6,Rregullore e programit të Studimit; pika 10, 11</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik institucioni merr pjesë në fushatat e informimit të organizuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (open day), fletushka të ndryshme, marketing në studio dhe media të ndryshme, duke bërë informimin e publikut të interesuar për diplomat që menaxhon UST-ja, programet, masterat, kuotat, kritret përkatëse, për cdo program studimi, përmes portalit U albania dhe faqes zyrtare të univesitetit.</p> <p>GVJ u informua se, e gjithë procedura që nga aplikimi deri te pranimi i studentëve është publike dhe relizohet në mënyrë fizike sipas vendimeve të MAS për pranimet e studentëve në nivel të dytë Master. Kuotat e pranimit ishin për vitin akademik 2020-2021 ishin 80 studentë, ndërkoh që për tu hapur ky program studimi duhen 15 studentë të rregjistruar, dhe për vitin akademik 20212-2023 janë rregjistruar 18 studentë.</p> <p><i>Ref.13. Sekretaria.pdf : Të dhënat për kriteret , kuotata dhe tarifafinanciare për studeime cikli I dytë, Master Profesional“Trajner i Përgatitjes Fizike” – UST</i></p> <p><i>Ref.13.2 Sekretaria.pdf</i></p> <p><i>Ref.13.3 Sekretaria.pdf</i></p> <p><i>Ref.6, Rregullore e programit të Studimit; pika 10,11</i></p> <p><i>Ref.2 Statuti(Misioni)</i></p> <p><i>Ref.4, Rregullore e FSHL-së; Neni 5,68</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni, GVJ konkludon se institucioni parashikon kuota të posaçme dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konkludon se institucioni parashikon kuota të posaçme dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara, bazuar dhe në Ligj Nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri” Ligji Nr. 96/2017 “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe</p>

	<p>Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara si dhe udhëzimet e vazhdueshme të MAS. Kuotat e miratuara nga MAS janë 80 studente vendim Nr.20, datë 11.03.2022, pavarësisht se për vitin 2022-2023 janë rregjistruar 18 studentë.</p> <p><i>GVJ sygjeron të punohet më shumë me marketingun, në media të ndryshme dhe fletushka për programin e studimit cikli i dytë, Master Profesional "Trajner i Përgatitjes Fizike" – UST</i></p> <p><i>Ref.13. Sekretaria.pdf : Të dhënat për kriteret , kuotata dhe tarifatat financiare për studeime cikli I dytë, Master Profesional "Trajner i Përgatitjes Fizike" – UST</i></p> <p><i>Ref.13.2 Sekretaria.pdf</i></p> <p><i>Ref.13.3 Sekretaria.pdf</i></p> <p><i>Ref.6, Rregullore e programit të Studimit; pika 10,11</i></p> <p><i>Ref.2 Statuti(Misioni)</i></p> <p><i>Ref.4, Rregullore e FSHL-së; Neni 5,68</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>GVJ, gjatë vlerësimit konstatoi se UST harton dhe publikon kriteret dhe kuotat dhe përzgjedhjen për kandidatët nga shtetet e tjera, pavarësisht se deri tani nuk ka rregjistrime nga shtete të tjera dhe as me aftësi të kufizuar. Institucioni informon përmes faqes zyrtare kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera përmes kuotave të vecanta. Institucioni para çdo viti akademik planifikon kuotat, kriteret sipas programit, infrastrukturës së institucionit, numrit të stafit akademik pas propozimeve nga dekanati, kalojnë në rektorat dhe miratohen në senat dhe dërgohen për miratim në MAS.</p> <p><i>Ref.13. Sekretaria.pdf : Të dhënat për kriteret , kuotata dhe tarifatat financiare për studeime cikli I dytë, Master Profesional "Trajner i Përgatitjes Fizike" – UST</i></p> <p><i>Ref.13. Sekretaria.pdf : Të dhënat për kriteret , kuotata dhe tarifatat financiare për studeime cikli I dytë, Master Profesional "Trajner i Përgatitjes Fizike" – UST</i></p> <p><i>Ref.13.2 Sekretaria.pdf</i></p> <p><i>Ref.13.3 Sekretaria.pdf</i></p> <p><i>Ref.6, Rregullore e programit të Studimit; pika 10,11</i></p> <p><i>Ref.2 Statuti(Misioni)</i></p> <p><i>Ref.4, Rregullore e FSHL-së; Neni 5,68</i></p>

	<i>Vizita në institucion</i>		
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	GVJ bazuar në dokumentat e dorëzuar nga institucioni, takimi me stafin, sekretarinë mësimore, studentët e programit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike”, zyrën e burimeve njerëzore, konkludon se në fillimin e çdo viti akademik, realizohen procedurat përkatëse të ndihmës ekonomike dhe bursave për shtresat në nevojë, sipas udhëzimeve të ardhura nga MAS si dhe me vendim të Bordit të Administrimit UST. <i>Ref.6, Rregullore e programit të Studimit; pika 10,11</i> <i>Ref.2 Statuti(Misioni)</i> <i>Ref.4, Rregullore e FSHL-së; Neni 5,68</i> <i>Vizita në institucion</i>		
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> <i>UST harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit, bazuar në ligjshmëri dhe udhëzimet e ardhura nga MAS, si dhe referencat, vizita në institucion dhe RVB.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVJ, duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, rregullores së programit të studimit, faqes zyrtare të web si dhe takimit me përfaqësues të tij, GVJ konkludon se i gjithë informacioni i plotë dhe i hollësishëm gjendet në rregulloren mësimore të programit të studimit dhe aktet e tjera rregullatore. Gjatë takimit me studentët, GVJ konstatoi se ata njihen me rezultatet e tyre nëpërmjet platformës online Pitagora dhe sistemi TIMS Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për kohëzgjatjen e programit të studimeve si dhe mundësinë e transferimit të

	<p>studimeve, instrumentat e realizimit të vlerësimit të njohurive për lëndë të ndryshme, komponentët përbërës të vlerësimit total të lëndës, organizimi i provimeve, realizimi i praktikave, diplomimi, ndërpreja dhe rifillimi i studimeve, etj. Studentët informohen edhe nëpërmjet posterave dhe takimet në ditët e hapura me maturanët. Po ashtu në ditën e parë të fillimit të vitit akademik studentët realizojnë takim me drejtues të fakultetit si dhe pedagogë ku ata kanë mundësinë të njohin infrastrukturës, auditorët, të drejtat dhe përgjegjësië, programin e studimit dhe modulet përkatëse etj. Institucioni vë në dispozicion sekretarinë mësimore, Studenti akseson ecurinë akademike përmes llogarisë së tij në platformën Pitagora, ku ruhen të dhënat akademike ndër vite dhe studenti informohet për procedurat e përparimit akademik dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrin.</p> <p><i>Ref.6, Rregullore e programit të Studimit; pika 10,11</i></p> <p><i>Ref.2 Statuti(Misioni)</i></p> <p><i>Ref.4, Rregullore e FSHL-së; Neni 5,68</i></p> <p><i>Ref.5, Rregullore e Departamentit të Sporteve Individuale ;Neni 20</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>GVJ vlerëson se UST informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Kjo realizohet nëpërmjet Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Sekretaria mësimore pranë njësisë kryesore (fakultetit) dhe Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë informojnë studentët në lidhje me procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p> <p>Institucioni për të bërë të mundur ekuivalentimin e programeve të studimeve për studentët që duan të transferojnë studimet në UST, ngrre një komision i cili bën ekuivalentimin lëndëve bazuar në programin e studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike”, në UST, aktualisht nuk kishte një rast konkret i ardhur me transferim nga ndonjë institucion tjetër.</p> <p>Studenti i cili dëshiron të transferojë studimet në UST, informohet për të gjitha procedurat, kriteret që ndiqen në rastin e transferimit të studimeve, ekuivalentimin dhe vitin në të cilin ky student i transferohen studimet. Gjithë procedura e transferimeve menaxhohet mbi bazën e dokumenteve, si plani mësimor dhe</p>

	<p>programet e lëndëve, si dhe procedurat e parashikuara në rregulloret e studimeve të institucionit.</p> <p><i>Ref.6, Rregullore e programit të Studimit; pika 10,11,neni 25</i></p> <p><i>Ref.2 Statuti(Misioni)</i></p> <p><i>Ref.4, Rregullore e FSHL-së; Neni 5,68</i></p> <p><i>Ref.5, Rregullore e Departamentit të Sporteve Individuale ;Neni 20</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ, bazuar në dokumentacionin referues, gjatë vizitës në sekretarinë mësimore konstatoi se institucioni disponon dosjen personale (regjistrin) të çdo studenti, në të cilën janë të detajuara informacionet nga dita e regjistrimit deri te procedurat e vlerësimit të dijeve. Po ashtu rregullorja e institucionit, syllabuset parashikojnë elementet përbërës të vlerësimit dhe peshën specifike të tyre në raport me vlerësimin total, të cilat janë të reflektuara në programin dhe silabusin e lëndëve si vlerësimi për lëndët teorike: vlerësimi i detyrimeve të lëndës 20%, detyra e kursit 10-30%, provimi përfundimtar 50-70%, vlerësimi për lëndët praktike: vlerësimi i vazhdueshëm 30%, provimi praktik 35%, provimi përfundimtar 35%. Në fillim të vitit akademik,që ditën e parë pedagogu spjeron përmbajtjen e syllabusit të lëndës dhe studentëve u vihet në dispozicion , duke patur parasysh temat, seminarët, provime të ndërmjetëme , provime praktike, detyrime lëndore dhe provimi përfundimtar.</p> <p><i>Ref.6, Rregullore e programit të Studimit; pika 10,11,neni 25</i></p> <p><i>Ref.2 Statuti(Misioni)</i></p> <p><i>Ref.4, Rregullore e FSHL-së; Neni 5,68</i></p> <p><i>Ref.5, Rregullore e Departamentit të Sporteve Individuale ;Neni 20</i></p> <p><i>Refrenca 20: Tabelat përmbledhëse ;</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>GVJ gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, RVB, guidës në institucion, konstatoi se UST ka hartuar rregulloren e studimeve. Programi i studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike”,në UST zgjat 2 semestra, një vit kademik me 60 kredite dhe përfundon me provimin përfundimtar të diplomimit në fund të vitit të parë, punimin e një teme për diplomim , pasi studenti ka përmbyllur të</p>

	<p>gjitha detyrimet akademike dhe ekonomike. Në rregulloren e UST-së, departamenti përgjegjës në bashkërendim me Zyrën e Këshillimit, Informimit dhe Orientimit të Studentëve informon studentët për modalitetet e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar, diplomimit. Rregullorja e diplomimit, përcakton në mënyrë të detajuar procesin e diplomimit. GVJ, konstaton se procedurat për punimin e diplomës, janë në dispozicion të studentëve jo vetëm në faqen zyrtare të institucionit, por edhe ju bëhen me dije pranë departamentit apo sekretarisë mësimore. Institucioni përcakton në mënyrë të detajuar planin e diplomimit, që nga momenti i aplikimit për temë diplome, miratimin e temës dhe pedagogun udhëheqës, procesin e shkrimit të tezës, kalendarin e seancave metodologjike, e deri tek formatimi konkret i punimit, dorëzimin dhe mbrojtjen. Fazat kohore të dorëzimit dhe mbrojtjes së diplomës bëhen të ditura në fillim të çdo viti akademik. GVJ konstaton gjithashtu që sivjet është brezi i parë i të diplomuarve.</p> <p><i>Ref.2 Statuti(Misioni)</i></p> <p><i>Ref.4, Rregullore e FSHL-së; Neni 5,68</i></p> <p><i>Ref.5, Rregullore e Departamentit të Sporteve Individuale ;</i></p> <p><i>Ref.6, Rregullore e programit të studimit ;Neni 29,30,31</i></p> <p><i>Ref.18. Diplomë + Suplement.pdf</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi nga dokumentacioni se UST organizon takime të hapura për informimin e studentëve që kanë mbaruar ciklin e parë Bachelor për programin e studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike”, po ashtu publikon spote promovuese për programin e studimit dhe fletëpalosje të ndryshme.</p> <p>Gjatë vizitave në institucion GVJ konstatoi se UST ka strukturë (Drejtoria juridike, Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI) që merret me gjurmimin e studentëve dhe organizimin e ditëve të hapura për informimin e studentëve të ardhshëm mbi programet e studimit. Përgjatë ditëve të regjistrimit, njësia kryesore vë në dispozicion të studentave të interesuar për të vazhduar studimet në programin e studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike” grupe pedagogësh që japin informacionin e nevojshëm në lidhje me organizimin e programit të studimeve, kohëzgjatjen, rregulloren, mundësitë e punësimit dhe mundësitë e</p>

	<p>transferimit të studimeve në UST dhe nga UST tek universitetet me programe të ngjashme brënda dhe jashtë shtetit.</p> <p>GVJ konstatoi nga dokumentacioni dhe takimi me stafin akademik se UST organizon takime të hapura për informimin e studentëve për programin e studimit për programin e studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike”, institucioni jep informacion të hollësishëm lidhur me mundësitë në tregun e punës për këtë program studimi.</p> <p><i>Të punohet më shumë me marketingun e kësaj diplome për plotësim të kuotave të propozuara.</i></p> <p><i>Ref.2 Statuti(Misioni)</i></p> <p><i>Ref.4, Rregullore e FSHL-së;</i></p> <p><i>Ref.5, Rregullore e Departamentit të Sporteve Individuale ;</i></p> <p><i>Ref.6, Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <p><i>UST vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve në programin e Ciklit të Dytë Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike”.</i></p> <p><i>UST ka strukturë (Drejtoria juridike, Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI) që merret me gjurmimin e studentëve dhe organizimin e ditëve të hapura për informimin e studentëve të ardhshëm mbi programet e studimit</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="630 1429 847 1529"></th> <th data-bbox="847 1429 1054 1529">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1054 1429 1289 1529">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1289 1429 1482 1529">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="630 1529 847 1597"></td> <td data-bbox="847 1529 1054 1597"></td> <td data-bbox="1054 1529 1289 1597"></td> <td data-bbox="1289 1529 1482 1597" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të</p>	<p>GVJ në bazë të dokumentave referuese, planet mësimore, rregullore, statusit, takimit me drejtues të institucionit, sekretarinë</p>

hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.

mësimore, studentët konstaton se, UST vendos në dispozicion të studentëve informacionin e nevojshëm rreth strukturës, organizimit të programit mësimor dhe kohëzgjatjes së programit të studimit. Informacionin studentët e marrin nëpërmjet takimeve me stafin akademik që i pret në institucion në momentin që interesohen për programet e studimit, nëpërmjet kontakteve me Zyrën e Këshillimit, Informimit dhe Orientimit të Studentëve, si dhe vënies në dispozicion të studentëve të rregullores së brendshme dhe rregullores së programit të studimit. Bazuar në programin e studimit dhe rregulloret e UST që ndihmojnë dhe rregullojnë realizimin e programit mësimor, studentëve ju bëhet me dije që: Programi ka 60 kredite, në një vit akademik, i ndarë në 2 semestra (sem I+II) me nga 15 javë mësimore cdo semester dhe me nga 30 kredite secili semestër. Në takimin me komisionin e kurrikulave ,bazuar në udhëzimin të MAS si dhe Rregulloren e UST në program vihet re se 1 kredit ekuivalentohet në orë mësimore si më poshtë:

1 kredit leksion	10 orë në auditor
1 kredit seminar	5 orë në auditor
1 kredit laborator	12 orë në auditor
1 kredit praktike	20 orë në auditor

Ditën e parë bëhet takim informues e orientues për të gjithë studentët për aspektet e programit të studimit, syllabusin, vlerësimin, literaturën bazë dhe të rekomanduar. Në vazhdim sigurohet asistencë e posçame nga personeli ndihmës mësimor për familjarizimin e studentëve me procesin mësimor. Informacionet e hollësishme studentët i gjejnë dhe në systemin on-line të Pitagorës.

GVJ vren se në programin e studimit mungon lënda praktikë profesionale si modul më vete, por orët praktike janë të futura në lëndë të ndryshme profesionale si praktikë lëndore.

Sygjerojmë, që në vitin e ardhshëm akademik, në kuadër të rishikimit të kurrikulave sipas udhëzimeve përkatëse të MAS, për ndryshimin 20% të planeve mësimor , të vendoset moduli :Praktikë profesionale, sipas, VKM 41/2018

Ref.6, Rregullore e programit të studimit ;

Ref.7. Programi i Studimit MPTPF;

Ref.20 Tabelat Përmbledhëse; Tabela 9 Plani mësimor I ndarë sipas veprimtarive formuese(A-E),

Vizita në institucion

Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.

GVJ bazuar në referencat e vëna në dispozicion, takimin me drejtues të institucionit, takimi me stafin akademik, sekretarinë mësimore si dhe takimi me studentët konstaton se koordinatori i programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike”, mban lidhje të vazhdueshme me studentët. UST informon studentët në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike”, Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për kohëzgjatjen e programit të studimeve edhe nëpërmjet web-it.

Çdo fillim viti akademik në faqen web të UST, në hapësirën e FSHL që ofron programin e studimit bëhet publike struktura e vitit akademik. Informacioni i nevojshëm publikohet në stendat e holleve të universitetit, guida, rregullore dhe fletëpalosje, si dhe elektronikisht. Në formë të detajuar studentët kanë akses mbi ngarkesat, temat për çdo javë mësimore dhe literaturat e detyrueshme dhe ato të rekomanduara, detyrat apo diskutime të ndryshme, kreditet përkatëse, të cilat janë të shprehura qartë dhe në syllabuset e lëndëve të ndryshme. Studenti i akseson të gjitha të dhënat nëpërmjet llogarisë të dedikuar të sistemit të Pitagorës dhe faqes zyrtare on -line të UST, *Aksesi online në systemin PITAGORA*)https://ust.pitagora.rash.al/login?fac_id=10000.

Studentët asistohen gjatë gjithë kohës nga stafi pedagogjik dhe sekretaria mësimore, koordinatori për çdo paqartësi. Në fillim të çdo semestri, studentëve u vihet në dispozicion orari dhe ngarkesa mësimore semestrale. Po ashtu ora e parë studentët marrin info të detajuar nga pedagogët e lëndëve për syllabusin përkatës ku shprehen qartë: kreditet, kodi lëndor, raporti lexion: seminar: laborator: praktik, temat, literaturë bazë dhe literaturën e rekomanduar, format e kontrollit dhe vlerësimit, detyrimet për lëndën (projekte, detyra kursi), niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës etj.

Ref.6, Rregullore e programit të studimit

Ref.7. Programi i Studimit MPTPF;

Ref.20 Tabelat Përmbledhëse; Tabela 9 Plani mësimor I ndarë sipas veprimtarive formuese(A-E),

Vizita në institucion

Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.

GVJ bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, dhe gjatë takimeve në institucion, konstaton se UST, informon studentët në mënyrë të vazhdueshme për tregun e punës dhe kriteret e tij. Institucioni i kushton një vëmendje të veçantë orientimit të studentëve drejt tregut të punës, si në rang universiteti nëpërmjet Drejtorisë së Koordinimit, Marrëdhënive me Jashtë, Këshillimit të Karrierës, Alumni, ashtu si edhe Zyrës së Këshillimit, Informimit dhe Orientimit të Studentëve. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI, e cila ka dy zyra në institucion të cilat u japin studentëve informacione mbi mundësinë e punësimit. Nëpërmjet organizimit të praktikave mësimore në institucionet partnere, studentëve me performancën më të mirë u ofrohet mundësi punësimi reale ose projektet bashkëpunuese me UST. Përmes aktiviteteve të vazhdueshme të sektorit të alumnit, studentët kanë mundësi të marrin informacione dhe orjentim mbi tregun e punës.

Ref.7, Programi I Studimit;

Ref.10 Politika e jashtme per mobilitetin e stafit dhe studentet

Ref.20.Tabelat përmbledhese: (tabela Nr.5 Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese),

Ref.20 Tabelat Përmbledhëse. Tabela Nr.20 Të dhëna për bashkëpunime kombëtare dhe ndërkombëtare të institucionit)

Vizita në institucion

Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.

GVJ referuar dokumentacionit të dorëzuar, faqes zyrtare ëeb të UST dhe FSHL, si dhe vizitës në institucion, konkludon se studentëve, nëpërmjet web-it, sekretarisë mësimore dhe stafit akademik, në mënyrë të vazhdueshme u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor. Këtë informacion studentëve ju prezantojnë që ditën e parë pedagogët në e lëndëve në auditor , por jo vetëm, studentët marrin informacionin e nevojshëm në stendën informuese të institucionit, e cila gjendet, në hollin kryesor në hyrje të godinës, në një pozicion lehtësisht të aksesueshëm nga studentët. Informacioni i stendës përditësohet rregullisht me ndryshimet dhe njoftimet më të fundit. Faqja Ëeb dhe llogaritë në rrjetet sociale të universitetit dhe fakultetit janë një tjetër mjet për përditësimin e informacionit në kohë reale. Gjithashtu, koordinatori i programit të studimit informon studentët lidhur me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor dhe komunikon me studentët lidhur me ndryshimet, nevojat, problematikat, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet e nevojshme. Çdo pedagog ka parashikuar në programin e lëndës

	<p>përveç të tjerash edhe logjistikën që do t'i duhet për organizimin e lëndës përkatëse si dhe infrastrukturën e nevojshme. Çdo informacion tjetër në lidhje me procesin mësimor, kalendarin akademik dhe aktivitete të ndryshme mësimore që organizohen në UST, dërgohen përmes postës elektronike dhe sistemeve Pitagora e Teams të cilat janë të aksesueshme pa pagesë nga stafi akademik dhe të gjithë studentët.</p> <p><i>Ref. 41. Akses online në systemin PITAGORA)</i> https://ust.pitagora.rash.al/login?fac_id=10000 <i>Ref.7. Programi i Studimit MPTPF;</i> <i>Ref.20 Tabelat Përmbledhëse; Tabela 9 Plani mësimor I ndarë sipas veprimtarive formuese(A-E),</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Nga takimi me studentët, drejtues të institucionit, stafin akademik, sekretarinë GVJ konstanton se UST vë në dispozicion të studentëve informacionin, dokumentacionin dhe udhëzues të posaçëm për lëndët dhe veprimtarinë formuese të cilat shprehen qartë dhe në syllabuset e lëndëve të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike”. Studenti i akseson të dhënat nëpërmjet llogarisë personale (portali i studentit) në platformën Pitagora, që ata marrin në momentin e regjistrimit në UST nga Zyra e IT, nga ku kanë të drejtë të futen në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit edhe në distancë, on-line përmes platformës studentët mund të shohin të dhënat në lidhje me programin e studimit, si edhe të komunikojnë me mesazhe mepedagogët e lëndëve dhe moduleve. Ky system është lehtësisht i aksesueshëm prej studentëve, pedagogëve edhe nga telefonat e tyre celularë, pa pagesë dhe në cdo kohë.</p> <p><i>Ref. 41. Akses online në systemin PITAGORA)</i> https://ust.pitagora.rash.al/login?fac_id=10000; <i>Ref.7. Programi i Studimit MPTPF;</i> <i>Ref.20 Tabelat Përmbledhëse; Tabela 9 Plani mësimor I ndarë sipas veprimtarive formuese(A-E),</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <p><i>UST vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm që në fillim të vitit akademik, për objektivat, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit MP në “Trajner i</i></p>

	<i>Përgatitjes Fizike, për rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>GVJ nga takimi me stafin akademik, me studentët, me zyrën e karrierës, sekretarinë si dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit, u konstatua se Njësia e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI asiston në gjurmimin e studentëve dhe ka krijuar një databazë të të dhënave të gjurmimit të studentëve, e cila përditësohet me të dhëna çdo vit. Studentët e parë të programit të studimit MP në “Trajner i Përgatitjes Fizike” dalin këtë vit akademik 2022-2023 dhe janë 18 studentë të rregjistruar nga 80 kuota të kërkuara nga UST.</p> <p><i>Ref.13. Sekretaria.pdf : Të dhënat për kriteret , kuotata dhe tarifat financiare për studeime cikli I dytë, Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike” – UST</i></p> <p><i>Ref.13.2 Sekretaria.pdf</i></p> <p><i>Ref.13.3 Sekretaria.pdf</i></p> <p><i>Ref.6, Rregullore e programit të Studimit të FSHL;</i></p> <p><i>Ref. 7. Statuti i UST, Urdhër MAS, Nr. 124, dt 29.05.2020, Nr.11053 Prot.pdf Vizita në institucion</i></p>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin	<p>UST dhe respektivisht FSHL disponon statistika të sakta vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të Dytë “MP në “Trajner i Përgatitjes Fizike” si dhe për të gjitha programet e studimit që ofron UST. Për programin e studimit në vlerësim, nuk ka transferime nga UST në institucione të tjera të arsimit të lartë shqipëtar dhe as në të kundërt nga institucione të tjera te UST. Sekretaria mësimore na vendosi në dispozicion dosjet personale të çdo studenti, e cila krijohet që në momentin e regjistrimit të tij dhe përditësohet me të dhëna të tjera përgjatë "jetës universitare" të tij në UST. Kjo dosje përditësohet edhe me elementë</p>

<p>zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>të tjerë si dokumentacioni i ndjekjes së praktikës profesionale, apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. GVJ gjatë inspektimit të regjistrave themeltarë konstaton se nuk ka raste të studentëve, që kanë ndërprerë apo transferuar studimet.</p> <p>Për vitin akademik 2022 – 2023 janë regjistruar në këtë program, studimi 18 studentë.</p> <p><i>Ref.6, Rregullore e programit të Studimit të FSHL;</i></p> <p><i>Ref. 7. Statuti i UST, Urdhër MAS, Nr. 124, dt 29.05.2020, Nr.11053 Prot..pdf</i></p> <p><i>Ref .13. Sekretaria.pdf : Të dhënat për kriteret , kuotata dhe tarifat financiare për studime cikli I dytë, Master Profesional "Trajner i Përgatitjes Fizike" – UST</i></p> <p><i>Ref.13.2 Sekretaria.pdf</i></p> <p><i>Ref.13.3 Sekretaria.pdf</i></p> <p><i>Ref.14 Marreveshjet(Ngarkesa)</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion, RVB, referncave përkatëse konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes një sistemi të brendshëm të informacionit nga Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe nga sekretaria .Çdo student ka dosjen e tij, ku përmbahen të gjitha të dhënat; nga momenti i regjistrimit e deri në diplomim. GVJ konstatoi se këto të dhëna janë të disponueshme në sekretarinë mësimore, në formë shkresore dhe elektronikisht në sistemin Pitagora dhe sistemi TIMS, të cilat janë të verifikueshme nga personat e autorizuar, duke respektuar kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave, dhe që janë krijuar nga RASH dhe QSHA për të realizuar ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, atyre akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhemenaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit, si financat etj.</p> <p><i>Ref.10. Politikat e Jashtme për mobilitetin e stafit dhe studentët.pdf</i></p> <p><i>Ref .13. Sekretaria.pdf : Të dhënat për kriteret , kuotata dhe tarifat financiare për studeime cikli I dytë, Master Profesional "Trajner i Përgatitjes Fizike" – UST</i></p> <p><i>Ref.13.2 Sekretaria.pdf</i></p>

	<p><i>Ref.13.3 Sekretaria.pdf</i></p> <p><i>Ref.14 Marreveshjet(Ngarkesa)</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit referues, si dhe takimin me drejtues të institucionit, stafin akademik, sekretarive konstaton se UST bën kontrole periodike për procesin mësimor, kontrole periodike ose audit të brendshëm, harton raporte periodike mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Në fund të vitit kalendarik departamenti përgjegjës për programin e studimit analizon dhe harton një raport analitik mbi arritjen e objektivave formuese të programeve të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënësve dhe aftësisë profesionale, me qëllim për të identifikuar nevojat për përmirësime në të ardhmen. Një kopje e raportit të kësaj analize i përcillet dekanatit, që nga ana e vet i përpunon këto edhe mbi bazën e raporteve të ardhura nga departamentet e tjera, për të hartuar një raport analitik vjetor në nivel njësie kryesore. Ky raport shërben si bazë për hartimin e objektivave për vitin pasues si për kuotat, kriteret e pranimit, tarifën e studimit, apo të transferimit të studimeve.</p> <p><i>Ref. 2. Raporti i vlerësimit të Brendshëm Periodik.pdf</i></p> <p><i>Ref. 7. Statuti i UST, Urdhër MAS, Nr. 124, dt 29.05.2020, Nr.11053 Prot..pdf</i></p> <p><i>Ref.8: "Njësia e sigurimit të cilësisë në nivel institucioni".</i></p> <p><i>Ref. 15. Raporti i Departamentit, Vlerësimi i programit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>GVJ bazuar në vizitën në institucion dhe në veçanti takimi me përfaqësues të zyrës së karrierës, sekretarisë mësimore konstaton se institucioni i kushton një rëndësi të veçantë mbledhjes së të dhënave të studentëve të diplomuar (pavarësisht se profesionistët e parë në programin e studimeve të ciklit të Dytë "MP në "Trajner i Përgatitjes Fizike" janë sivjet 2022-2023), UST ka rregullore dhe politika të raporteve periodike mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e punësimit të tyre. Këto të dhëna jepen në formë statistikore edhe në raportet vjetore që hartohen nga institucioni. Drejtuesit e njësive bazë këtë informacion vjetor, periodik të</p>

	<p>diskutuar më parë në departament e përcjellin në dekanat, për hartimin e objektivave, kuotave për vitin pasues.</p> <p><i>Ref. 2. Raporti i vlerësimit të Brendshëm Periodik.pdf</i></p> <p><i>Ref.6 Rregullore e Programit të Studimit, Neni 10 "Kriteret e pranimit" dhe Neni 11 "Regjistrimet".</i></p> <p><i>Ref. 7. Statuti i UST, Urdhër MAS, Nr. 124, dt 29.05.2020, Nr.11053 Prot..pdf</i></p> <p><i>Ref.13. Sekretaria.pdf : Të dhënat për kriteret , kuotata dhe tarifat financiare për studime cikli I dytë, Master Profesional "Trajner i Përgatitjes Fizike" – UST</i></p> <p><i>Ref.13.2 Sekretaria.pdf</i></p> <p><i>Ref.13.3 Sekretaria.pdf</i></p> <p><i>Ref. 15. Raporti i Departamentit, Vlerësimi i programit.pdf</i></p>			
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se:</p> <p>UST realizon një audit të brendshëm periodik, mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore	Bazuar në vizitën në institucion, takimet me drejtues të UST, student, staf akademik, NJSBC si dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstaton se studentët përfaqësohen në organe dhe komisione të ndryshme vendimmarrëse dhe këshilluese të UST-së. Pjesëmarrja e studentëve në organet vendimmarrëse bëhet sipas rregulloreve të UST dhe Ligjit të Arsimit Të Lartë.

<p>dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Ndër strukturat kryesore ku studentët janë pjesmarrës mund të përmendim:</p> <p>Këshilli Studentor funksionon, organizohet në nivel tnjësie kryesore dhe realizon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese;</p> <p>Senati Akademik –ka përfaqësues të studentëve i cili zgjidhet nga studentët;</p> <p>Këshilli Etikës - një anëtar i rekomandohet Rektorit nga Këshilli i Studentëve.</p> <p>NJSBC – ka një anëtar përfaqësues nga Këshilli i Studentëve, anëtar në GVB ka një student;</p> <p>Departamenti bën cdo muaj mbledhje të hapur me studentët. një në muaj është e hapur për studentët</p> <p><i>Ref. 7. Statuti i UST, Urdhër MAS, Nr. 124, dt 29.05.2020, Nr.11053 Prot..pdf</i> <i>Ref.3. Rregullore e UST-së.pdf</i> <i>Ref.4. Rregullore E FSHL-së.pdf</i> <i>Ref.8 SBC;Neni 10, Pika 3 “Komisioni i Sigurimit të Cilësisë i UST”.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>GVJ bazuar në statutin e UST neni 95, takimin me studentët konstaton se, studentët janë të përfshirë në organet kolegjiale si më poshtë, ashtu sic referuam edhe në kriterin e mësipërm (kriteri 1): Senati akademik; Këshilli i etikës; Komisionet e përhershme të lejuara me statut; Këshillat e studentëve; GVB.</p> <p>Gjithashtu, institucioni, përmes anketimeve, vlerësimeve periodike të studentëve për pedagogët (pyetësor anonym 2 herë në vit, për cdo semestër), lëndët dhe institucionin, mbledh dhe përpunon të dhëna të cilat përdoren nga organet vendimmarrëse për menaxhimin e vet institucionit. Të dhënat e mbledhura diskutohen në nivel institucional, me qëllim evidentimin e situatave dhe marrjen e masave për përmirësim të vazhdueshëm të problematikave të dala (nuk kishin ndonjë problematik të evidentuar apo të dokumentuar).</p> <p><i>Ref. 7. Statuti i UST, Urdhër MAS, Nr. 124, dt 29.05.2020, Nr.11053 Prot..pdf</i> <i>Ref.8, SBC; Neni 18 “Këshilli i studentëve”.</i> <i>Ref.29. Pyetesori i studeteve.pdf</i> <i>Vizita në institucion(Takim me zyren e cilesise, studentët)</i></p>

<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>GVJ bazuar në takimet që realizoi në institucion, konsultimi me dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatoi se UST garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit .Përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit realizohet përmes një pyetësorit anonim me studentët, fokus grupeve. Pyetësori organizohet dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet e studimit. Ndër rubrikat e pyetësorit është që të vlerësohet edhe sylabusi i lëndës. Takimet këshilluese të studentëve me përfaqësues të Zyrës së Këshillimit, Informimit dhe Orientimit të Studentëve, në disa raste edhe në praninë e koordinatorit të programit. Gjetjet e tyre, bëhen pjesë e diskutimeve, raporteve analitike semestrale e vjetore, dhe mund të shoqërohen me ndryshime në programin e studimit.</p> <p><i>Ref. 7. Statuti i UST, Urdhër MAS, Nr. 124, dt 29.05.2020, Nr.11053 Prot.pdf</i> <i>Ref.29. Pyetesori i studeteve.pdf</i> <i>Ref.8, SBC; Neni 22, Pika 4 “Grupi i Vlerësimit të Brendshëm të Njesisë Bazë” (GVB NJB).</i> <i>Ref.20 Tabelat Përmbledhëse; Tabela 9 Plani mësimor I ndarë sipas veprimtarive formuese(A-E)</i> <i>Vizita në institucion(Takim me zyren e cilesise, studentët)</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>GVJ në takimin me stafin akademik si dhe takimet me studentët u informua se studentëve u jepet mundësia të informohen për procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, u jepet mundësia e ankimimit të rezultatit, rishikimit të vlerësimit dhe reflektimit nga ana e institucionit, njësisë, pedagogut përgjegjës të lëndës. Mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve është një proces transparent, i cili shprehet në rregulloret e brendshme të vlerësimit të studentëve dhe pasqyrohet në programin apo sylabusin e secilës lëndë. Të dhënat mbi vlerësimin hidhen nga pedagogu i lëndës në systemin Pitagora, provimet me alternativa korrigjohen në mënyrë elektronike, Clean Score. Pedagogu i lëndës përgatit tezat e provimit paraprakisht, miratohet nga shefi i departamentit dhe në provim tezat janë të sekretuara. Pedagogu ndërkoh ju ka bërë paraprakisht me dije studentëve vlerësimin e provimit të ndërmjetëm si shpjegimet për vlerësimin aktual, mundësinë e rishikimit të tezës dhe çelësit të përgjigjeve, dhe mundësia për rivlerësim nga një komision i posaçëm nëse ka ankimime ndaj vlerësimit të pedagogut. Të gjitha këto elemente të vlerësimit të</p>

	<p>studentit janë të parashikura në rregulloret e UST dhe janë tregues të transparencës dhe barazisë së procesit të vlerësimit. Studentët kanë mundësi të parashitrojnë kërkesat e tyre duke ndjekur procedurat e parashikuara në rregulloren e institucionit. Gjatë takimit me drejtuesit e institucionit dhe studentët nuk kishte një rast të dokumentuar ankimimi.</p> <p><i>Ref.4, Rregullore e FSHL-së; Neni 90 "Ankimimi"</i></p> <p><i>Ref. 7. Statuti i UST, Urdhër MAS, Nr. 124, dt 29.05.2020, Nr.11053 Prot.pdf</i></p> <p><i>Ref.8, SBC; Neni 22, Pika 4 "Grupi i Vlerësimit të Brendshëm të Njësisë Bazë" (GVB NJB).</i></p> <p><i>Ref.12. Marrëveshje me CLEAN SCORE.pdf</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>						
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <p><i>UST përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</i></p>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ bazuar në rregulloret institucionale, guidën në institucion, takimin me stafin akademik dhe studentët konstaton se ky nstitucioni siguron informim, këshillim e orientim për studentët e të gjithë programeve dhe të gjithë cikleve të studimit, si në nivel institucional dhe në nivel njësie kryesore. Informimi i studentëve nga stafi, sekretaria bëhet që në ditët e informimit (open day) për të zgjedhur këtë universitet në bazë të programeve mësimore që ofron, po ashtu të drejtën e informimit studentët e marrin fizikisht në institucion te sekretaria, drejtuesit e institucionit, me anë të posterave të afishuara në vende të dukshme të institucionit, apo në distancë nëpërmjet</p>

	<p>informimit on line me anë të sitemit të Pitagorës dhe faqes zyrtare të institucionit. GVJ konstaton se këto të drejta të informimit studentor janë të shprehura dhe në rregullore të ndryshme dhe Statutin e UST-së të cilat janë aksesueshme (fizikisht dhe on line) nga të gjithë grupet e interesuara për programin e studimit.</p> <p><i>Ref. 1. Ligji i IAL-së.pdf</i></p> <p><i>Ref.4, Rregullore e FSHL-së;</i></p> <p><i>Ref. 7. Statuti i UST, Urdhër MAS, Nr. 124, dt 29.05.2020, Nr.11053 Prot.pdf</i></p> <p><i>Ref.8, SBC; Neni 22, Pika 4 “Grupi i Vlerësimit të Brendshëm të Njësisë Bazë” (GVBNJB).</i></p> <p><i>Ref.12. Marrëveshje me CLEAN SCORE.pdf</i></p> <p><i>Ref.10 Politikat e jashtme për mobilitetin e stafit dhe studentët</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion, takimet e realizuara me stafin, drejtuesit, sekretarinë, studentët ka një sistem të mire organizuar për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor nga dita e rregjistrimit deri në përfundim të studimeve. GVJ gjatë vizitës në sekretarinë mësimore të institucioni konstatoi edhe fizikisht (rregjistrat themeltar të studentëve) dhe në formë elektronike sistemi i Pitagorës ishin të hedhura të gjitha të dhënat për procesin mësimor nga dita e rregjistrimit deri në përfundim të studimeve Gjithashtu në takimin me studentët, GVJ konstaton se atyre u ofrohet shërbim i vazhdueshëm i këshillimit të karrierës me ndihmën e Drejtorisë së Koordinimit, Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë, Këshillimit të Karrierës, ALUMNI etj. Koordinimi dhe bashkëpunimi i aktivitetit të zyrave të mësipërme në rang Universiteti është tregues i një sistemi të menaxhimit shumë të mirë të asistencës ndaj studentëve.</p> <p><i>Ref. 1. Ligji i IAL-së.pdf</i></p> <p><i>Ref.4, Rregullore e FSHL-së;</i></p> <p><i>Ref. 7. Statuti i UST, Urdhër MAS, Nr. 124, dt 29.05.2020, Nr.11053 Prot.pdf</i></p> <p><i>Ref.8, SBC; Neni 22, Pika 4 “Grupi i Vlerësimit të Brendshëm të Njësisë Bazë” (GVBNJB).</i></p> <p><i>Ref.12. Marrëveshje me CLEAN SCORE.pdf</i></p>

	<p><i>Akresi online në systemin PITAGORA)</i> https://ust.pitagora.rash.al/login?fac_id=10000 <i>Ref.10 Politikat e jashtme për mobilitetin e stafit dhe studentët</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>GVJ siç e përmendëm dhe në kriterin 2, konstaton se UST u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Studentëve u ofrohet këshillimi i karrierës, me anë të disa zyrave dhe drejtorive si, zyra e këshillimit të karrierës, drejtoria e koordinimit, marrëdhënieve me jashtë, ALUMNI. Këto zyra janë në shërbim të studentëve duke ofruar informacion në lidhje me, aktivitete të ndryshme studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, projekte të ndryshme, mundësi punësimi duke ofruar njëkohësisht asistencë për kryerjen e aplikimeve apo këshillimin e nevojshëm. Gjithashtu UST ka krijuar kontakte me kompani private dhe institucione shtetërore dhe bashkëpunon ngushtë jo vetëm në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale / intershipeve të studentëve, por edhe të punësimit të ardhshëm të studentëve në këto kompani e organizata. Këto njësi kanë krijuar kontakte të shumta me kompani private, Federata, Komitetin Olimpik Shqipëtar dhe institucione shtetërore .</p> <p><i>Ref. 1. Ligji i IAL-së.pdf</i> <i>Ref.4, Rregullore e FSHL-së;</i> <i>Ref. 7. Statuti i UST, Urdhër MAS, Nr. 124, dt 29.05.2020, Nr.11053 Prot.pdf</i> <i>20. Tabelat përmbledhëse.pdf. Tabela .5. Institucione dhe organizata bashkëpunuese.</i> <i>Ref.10 Politikat e jashtme për mobilitetin e stafit dhe studentët</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, takimet e realizuara me stafin, drejtuesit, sekretarinë, studentët GVJ konstatoi se UST ka një system të mirë organizuar për informimin, këshillimin e studentëve dhe ka disa zyra dhe drejtori të cilat ndjekin në mënyrë periodike studentët jo vetëm gjatë viteve akademike, por edhe pas punësimit të tyre për programet e tjera, pasi profesionistët e parë të programit, Master Profesional “Trajner i Përgatitjes Fizike” – UST dalin këtë vit akademik 2022-2023.</p> <p>Drejtoritë dhe zyrat përkatëse si, Drejtoria e Koordinimit, Marrëdhënieve me Jashtë, Këshillimit të Karrierës, ALUMNI mban kontakte për pjesëmarrje në trajnime pasuniversitare brenda apo jashtë vendit si dhe mban kontakte me studentët e diplomuar duke</p>

	<p>krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre (pavarësisht se këta janë studentët e parë të programit të studimit MP në "Trajner i Përgatitjes Fizike" të cilët diplomohen këtë vit akademik 2022-2023)</p> <p>Theksojmë se UST ka të ngritur një data-base e ALUMNI që e ka zbatuar dhe po e zbaton edhe për programe të tjera që zhvillohen në këtë institucion ndjekjes së karrierës pas diplomimit.</p> <p>Ref.21. ALUMNI</p> <p>Ref.10. Politikat e jashtme për mobilitetin e stafit dhe studentët</p> <p>Vizita në institucion</p>								
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se:</p> <p>UST ka njësi të posaçme të informimit e shërbimit të studentëve siç është: sekretaria mësimore, Zyra e IT, Zyra e financës, Zyra e Kurrikulave, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI dhe sistemi EMS, si konkluzion themi se IAL, ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët</p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.

GVJ në takimin me drejtuesit e institucionit, stafin, studentët, NJSBC, referencat e vëna në dispozicion, mendon se, UST, e ka të ngritur, Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe nëpërmjet NJSBC-së, siguron zbatimin një strategjie institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. NJSBC, funksion plotësisht në formën e një njësie të përhershme në strukturën organizative të institucionit dhe veprimtaria e tij bazohet dhe zbatohet sipas një rregulloreje të miratuar institucionale.

NJSBC vlerëson në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike funksionalitetin, efikasitetin dhe produktivitetin e stafit të IAL në lidhje me veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore nëpërmjet pyetësorëve anonim dy herë në vit që ju bëhen studentëve mbi aktivitetin mësimor, aktivitetin shkencor, infrastrukturën e institucionit, komunikimin me sekretarinë, administratën etj. NJSBC ka të drejtë të ketë akses dhe të kontrollojë në të gjitha materialet dhe të dhënat e institucionit në bazë të plani strategjik të zhvillimit të UST. Mësimdhënia bëhet gjithmonë në përmirësim bazuar dhe në përmirësimin në vazhdim të infrastrukturës, përdorimi i Sistemit të Pitagorës që aplikohet, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, të statutit dhe të akteve të tjera të brendshme rregullatore duke vënë në dispozicion metoda kreative jo vetëm në auditor por dhe në distancë për tematika të ndryshme mësimore, laboratore, detyra kursi etj. UST ka në përdorim kabinete të ndryshme për një mësimdhënie sa më bashkëkohore si: Kabinet i fizioterapisë, i anatomisë, i informatikës, i fiziologjisë etj. Cdo sallë leksioni ka infrastrukture shumë të mire për mësimdhënie si video projektor, systemin grohjes dhe ftohjes së ambienteve në UST.

UST në mënyrë të vazhdueshme ka ftuar e fton lektorë e Profesorë me përvojë akademike të fushës së trajnimit në edukim fizik dhe sport, për të realizuar lexione të hapura që ndikojnë në shkëmbimin e experiencave akademike.

Ref. 10. Politikat e Jashtme për mobilitetin e stafit dhe studentët.pdf

Ref.14. Marrëveshjet (Ngarkesa).pdf

Ref. 2.1 Plani Strategjik i UST- së.pdf

Prioriteti strategjik; Përmbushja e standarteve të përsosmërisë në mësimdhënie të nxënit.

Ref. 20. Tabelat përmbledhëse.pdf; Tabela 16: mjediset e fakultetit/njësieve bazë.

<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p><i>Vizita në institucion</i></p> <p>Gjatë guidës në institucion GVJ u informua se UST, ka të ngritur drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila sipas legjislacionit në fuqi zhvillon pyetësoin e studentëve për matjen e performances, në mënyrë të vazhdueshme, 2 here në vit, në fund të cdo semestri realizohet një pyetësor anonim me studentët, me disa rubrika për mësimdhënien, programin, korrektësinë e stafit, ky vlerësim menaxhohet nga, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). GVJ gjatë takimit me zyrën e NJSBC-së, u informua se NJSBC, ka filluar të funksionoj që në mars 2018, por ka marrë formën e një njësie të përhershme institucionale në vitin 2021, me miratim dhe me Vendim të Senatit Akademik të UST, aktiviteti i saj rregullohet me anë të rregulloreve të miratuara nga senati I institucionit.</p> <p>NJSBC ka ndryshuar strukturën e saj bazuar dhe në ligjshmërinë aktuale, rregulloret e funksionimit, Statutin e UST, duke bërë pjesë të NJSBC, përfaqësues nga të gjitha njësitë bazë (përfshirë këtu edhe FSHL) 1 përfaqësues nga studentët (<i>student i programit të studimit MP në "Trajner i Përgatitjes Fizike"</i>) dhe 1 ekspert i jashtëm për konsulencë të ndryshme.</p> <p>Njësia vlerëson periodikisht efikasitetin dhe produktivitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore shkencore të UST-së, duke u konsultuar edhe me ekspertë të jashtëm. Në përbërjen e NJSBC sipas Statutit të UST janë 7 anëtarë (1 Kryetari, 2 përfaqësues nga FSHL, 2 nga FVFR, 1 nga IKSHS dhe 1 përfaqësues i studentëve)</p> <p>GVJ gjatë vizitës në institucion u konstatua se UST ka ngritur drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila sipas legjislacionit në fuqi zhvillon pyetësoin e studentëve për matjen e performances</p> <p><i>Ref.1. Ligji i IAL-së.pdf</i></p> <p><i>Ref. 2. Statuti i UST-së.pdf;</i></p> <p><i>Ref. 2.1 Plani Strategjik i UST- së.pdf;</i></p> <p><i>Ref.8. SBC.pdf;</i></p> <p><i>Ref. 7. Statuti i UST, Urdhër MAS, Nr. 124, dt 29.05.2020, Nr.11053 Prot.pdf</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e</p>	<p>GVJ siç është shprehur edhe në kriteret e mësipërme, si dhe në takimin e realizuar me studentët konfirmoi se UST garanton</p>

<p>studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimin të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies. Studentët referojnë se gjatë viteve akademike, ata në formë elektronike plotësojnë një pyetësor anonim dy herë në vit (çdo semestër) para sezonit. Pyetësori ka disa rubrika të cilat lidhen kryesisht me, programin e lëndës, syllabuset, mësimdhënia, performanca e stafit akademik, ndihmës akademik, infrastrukturën etj. Studentët shprehin pa ndikim apo presion mendimin e tyre të lirë mbi rubrikat që ka pyetësori. Studentët janë pjesë e vlerësimin periodik institucional, jo vetëm me anë të pyetësorëve anonim on-line në përputhje kjo me pikat 3 & 4 të nenit 103 të Ligjit 80/2015, por edhe me anë të takimeve formale dhe informale yë studentëve me koordinatoren e programit, takimit me përfaqësues të stafit akademik dhe administrativ. Pas mbledhjes së informacioneve përkatëse të këtyre vlerësimeve, NJSBC bën një raport që ja prezanton drejtuesit të institucionit, për problematikat e dala, dhe për ti zgjidhur ato. GVJ gjatë guidës në institucion dhe referencave të vëna në dispozicion, nuk konstatoi ndonjë rast konkret problematike, që mund të kishte dalë nga ky vlerësim periodik institucional me anë të studentëve.</p> <p><i>Ref.1. Ligji i IAL-së.pdf</i></p> <p><i>Ref. 2. Statuti i UST-së.pdf;</i></p> <p><i>Ref. 7. Statuti i UST, Urdhër MAS, Nr. 124, dt 29.05.2020, Nr.11053 Prot</i></p> <p><i>Ref.8. SBC.pdf;</i></p> <p><i>Ref.29. Pyetësori i studeteve.pdf</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimin.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion dhe referencave të vëna në dispozicion, konstatoi se pranë UST është ngritur dhe funksionon Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetësorin e studentëve për matjen e performances. GVJ u informua se, të gjitha të dhënat e grumbulluara nga vlerësimin periodik institucional , në lidhje me rezultatet e shprehura nga studentët, për format dhe metodat e mësimdhënies, programit mësimor, infrastrukturën etj, mblidhen nga NJSBC-ja, përpunohen nga ana statistikore, ruhen dhe krijohet një raport vjetor i cili i paraqitet Rektorit dhe Senatit Akademik , mbi veprimtaritë e mësimdhënies, të kërkimit shkencor, mbi shërbimet e kryera nga UST si efikasiteti i sekretarisë, bibliotekës</p>

	<p>etj. Në raportin vjetor, që i paraqitet Rektorit dhe Senatit, paraqiten dhe rekomandimet për vitin e ardhshëm akademik (të tipit SWOT).</p> <p><i>Ref.1. Ligji i IAL-së.pdf</i></p> <p><i>Ref. 2. Statuti i UST-së.pdf;</i></p> <p><i>Ref. 7. Statuti i UST, Urdhër MAS, Nr. 124, dt 29.05.2020, Nr.11053 Prot</i></p> <p><i>Ref.8. SBC.pdf;</i></p> <p><i>Ref.29. Pyetesori i studeteve.pdf</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ në takimin me drejtuesit e institucionit, përgjegjësin e departamentit, NJSBC , u informua se informacioni i mbledhur i bëhet një përpunim statistikor nga NJSBC dhe i paraqitet Rektorit dhe Senatit, me rekomandimet për vitin akademik pasardhës nëpërmjet rekomandimeve të tipit SWOT, duke nxjerr në pah mangësitë në këtë raport të vlerësimit institucional. GVJ u informua se në vlerësimet periodike institucionale nuk ka hasur dhe nuk ka konstatuar ndonjë problematik. GVJ në takimin me stafin akademik, konstaton se punonjësit promovohen me anë të suportit që institucioni ju jep për nxitjen përse i përket, kërkimit shkencor në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe rregulloret e brendshme të UST. Institucioni në mënyrë të vazhdueshme stafit akademik ju mbulon fee-në e publikimeve në revista të kërkimit shkencor të indeksuara, ne PubMed etj, si dhe ju mbulon fee-në e pjesmarrjes në konferenca ndërkombëtare. Stafit akademik gjithashtu motivohet nga institucioni edhe në projekte të ndryshme që ata apikojnë si ERASMUS etj. GVJ, gjatë vlerësimit konkludoi se FSHL vlerëson arritjet e personelit të tij, duke i evidentuar këto arritje në analizat vjetore mësimore dhe kërkimore-shkencore në nivel departamenti. Personeli akademik plotëson skedën vetjake të vlerësimit të veprimtarisë shkencore, e cila dorëzohet dhe pasurohet çdo fund viti akademik.</p> <p><i>Ref.1. Ligji i IAL-së.pdf</i></p> <p><i>Ref. 2. Statuti i UST-së.pdf;</i></p> <p><i>Ref. 7. Statuti i UST, Urdhër MAS, Nr. 124, dt 29.05.2020, Nr.11053 Prot</i></p> <p><i>Ref.8. SBC.pdf; Neni 27-Komunikimi dhe publikimi I rezultateve të monitorimit, vlerësimit dhe akreditimit</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>

Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <p><i>UST ka struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, ku hartohen raporte në përmbyllje të çdo viti akademik, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të cilësisë duke u bazuar në ligjin e arsimit të lartë i cili publikohet në faqen zyrtare të UST, pra IAL ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>GVJ bazuar në referencat si dhe takimin me stafin, drejtorinë e kurrikulave, konstatoi se Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të cilësisë, bazuar në legjislacionin në fuqi në mënyrë të vazhdueshme, realizon një pyetësor anonim me studentët, me disa rubrika për mësimdhënien, programin, korrektësinë e stafit, ky vlerësim menaxhohet nga, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), e cila ka filluar të funksionoj që në mars 2018 dhe është riorganizuar nga ana strukturale, përse i përket anëtarëve të NJSBC në vitin 2021, me Vendim të Senatit Akademik të UST, ku është e përcaktuar ashtu sic e parashikon dhe legjislacionit në fuqi, Ligjit 80/2015 të IALP si dhe rregulloreve të brendshme të UST dhe Statutit të UST që NJSBC përbëhet nga 7 anëtar (1 Kryetari, 2 përfaqësues nga FSHL, 2 nga FVFR, 1 nga IKSHS dhe 1 përfaqësues i studentëve) dhe një ekspert i jashtëm. Përbërja e NJSBC është arritja e objektivave strategjike në përputhje me vizionin dhe misionin e institucionit. NJSBC funksionon në bazë Rregullore për Sigurimin e Cilësisë; legjislacionit në fuqi, si dhe rregulloreve të brendshme të UST dhe Statutit të UST</p>

	<p>GVJu informua gjithashtu se Drejtoria e kurrikulave cdo fund viti bazuar në udhëzimet e MAS bën ndryshime 20% të kurrikulave mësimore duke pasqyruar sygjerimet e pedagogëve, studentëve dhe të kurrikulave homologe Europiane.</p> <p><i>Ref.1. Ligji i IAL-së.pdf</i></p> <p><i>Ref. 2. Statuti i UST-së.pdf;</i></p> <p><i>Ref. 7. Statuti i UST, Urdhër MAS, Nr. 124, dt 29.05.2020, Nr.11053 Prot</i></p> <p><i>Ref.8. SBC.pdf; Neni 27-Komunikimi dhe publikimi I rezultateve të monitorimit, vlerësimit dhe akreditimit</i></p> <p><i>Ref. 20. Tabelat përmbledhëse.pdf ,Tab.9 Plani mësimor sipas veprimtarive (A-E)</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>GVJ mendon se UST ka një strukturë të NJSBC e cila përmbush kriteret ligjore, e cila përbëhet nga 7 anëtarë, sipas Statutit të UST ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë apo ekspertë të jashtëm (1 Kryetari, 2 përfaqësues nga FSHL, 2 nga FVFR, 1 nga IKSHS dhe 1 përfaqësues i studentëve).</p> <p>NJSBC kontrollon në mënyrë periodike dhe përpunon një raport vjetor mbi aktivitetin mësimor, kërkimor dhe mbi shërbimet e ofruara nga IAL-ja, të cilin ja paraqet Rektorit. NJSBC-ja njëkohesisht është përgjegjëse për aplikimin e pyetësorëve anonim të studentëve që bëhet dy herë në vit, mbledhjen, menaxhimin, ruajtjen dhe komunikimin e mendimeve të studntëve për mësimdhënien, programin e studimit, korrektësinë e stafit, funksionimin e bibliotekës, sekretarisë, infrastrukturës etj. Funkzioni i NJSBC bazohet, menaxhohet me anë të një rregulloreje të funksionimit të Njësisë së Vlerësimit dhe ka të drejtën e aksesit në të gjitha dokumentet, dhe informacionet e tjera të Universitetit duke ruajtur në të njëjtën kohë konfidencialitetin e dokumenteve të mbledhura.</p> <p><i>Ref.1. Ligji i IAL-së.pdf</i></p> <p><i>Ref. 2. Statuti i UST-së.pdf;</i></p> <p><i>Ref.2.1, Plani Strategjik UST-së;Prioriteti strategjik 6-Sigurimi I cilësisë</i></p> <p><i>Ref. 7. Statuti i UST, Urdhër MAS, Nr. 124, dt 29.05.2020, Nr.11053 Prot</i></p>

	<p><i>Ref.8. SBC.pdf; Neni 27-Komunikimi dhe publikimi I rezultateve të monitorimit, vlerësimit dhe akreditimit</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>GVJ, bazuar në referencat e dorëzuara, takimin me drejtuesit e institucionit u informuam se grupi ynë (GVJ) i akreditimit për programin e studimit MP në "Trajner i Përgatitjes Fizike", është duke kryer procesin e parë të vlerësimit të jashtëm të cilësisë. GVJ bazuar në, guidën në institucion dokumentat e vëna në dispozicion konstaton se, institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë.</p> <p>NJSBC ka rolin kryesor në monitorimin e cilësisë. NJSBC moniton procesin e vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike periodike, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p> <p>GVJ gjatë guidës në institucion dhe takimin me drejtues të institucionit konstatojmë se institucioni për sigurimin e cilësisë përdor: pyetësorët anonim tek studentët për aspekte të ndryshme të veprimtarisë mësimore e asaj administrative, sipas Ligjit 80/2015 të IALP; takime formale dhe informale me studentët dhe koordinatorin e programit të studimit; takimeve me stafin akademik dhe administrativ nëpërmjet e-maili ose takime të drejtpërdrejta.</p> <p>NJSBC institucionale pas mbledhjes së të gjitha informacioneve nga metodat e përdorura , sic referuam më lartë bën në aspektin taktik, raportime periodike vjetore tek drejtuesi i institucionit.</p> <p>Të dhënat e këtij monitorimi të mbledhura nga NJSBC diskutohen në njësitë bazë, dekanat, rektorat, senat dhe shohin mundësitë për përmirësimin e problematikave.(nuk ka patur ndonjë rast konkret problematik). Universiteti Sporteve të Tiranës është nënshtruar në mënyrë periodike vlerësimeve të jashtme, të lidhura me akreditimin e parë dhe atë periodik institucional (me vlerësim përfundimtar pozitiv dhe me një kohëzgjatje prej 6 vite akademike).</p> <p><i>Ref.1. Ligji i IAL-së.pdf</i></p> <p><i>Ref. 2. Statuti i UST-së.pdf;</i></p> <p><i>Ref.2.1, Plani Strategjik UST-së;Prioriteti strategjik 6-Sigurimi I cilësisë</i></p> <p><i>Ref. 7. Statuti i UST, Urdhër MAS, Nr. 124, dt 29.05.2020, Nr.11053 Prot</i></p>

	<p><i>Ref.8. SBC.pdf; Neni 27-Komunikimi dhe publikimi I rezultateve të monitorimit, vlerësimit dhe akreditimit ; Kreu III: Standarte për sigurimin e brendshëm të cilësisë</i></p> <p><i>Vizite ne institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>GVJ në takimin me drejtues të UST-së dhe referencat e vëna në dispozicion, mendon se UST përgatit në mënyrë periodike analizat vjetore në bazë institucionale, në çdo njësi bazë. Aty përshkruhet pjesa më e madhe e informacionit mbi ngarkesën mësimore, aktivitetin shkencor, cilësinë e leksioneve të miratuara më parë në departament, të dhënat e dala nga monitorimi i vazhdueshëm i stafit. Ky raport më pas u dërgohet dhe vihet në dispozicion edhe stafit akademik dhe administratës. Gjatë vlerësimit GVJ konstaton se në zbatim të akteve rregullatore, UST përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve, të cilat kontrollohen nga NJSBC dhe që janë të përshkruara dhe në syllabuset e lëndëve përkatëse, të cilat janë miratuar paraprakisht nga institucioni.</p> <p>NJSBC mbikqyr hartimin e programeve dhe planeve mësimore të disiplinave mësimore si edhe harmonizimin e tyre. FSHL ndjek me përgjegjësi problemet që lidhen me mësimdhënien dhe me zbatimin e programeve të studimit. Këto institucione përdorin disa metoda për realizimin e vlerësimit, si: pyetësorë me studentët, inspektime gjatë zhvillimit të mësimit nga përfaqësuesit e dekanatit të FSHL, leksione të hapura e dëgjime në auditor, intervista, vlerësim të detyrave dhe të provimeve të studentëve, vëzhgime gjatë kqyrjes së praktikë.</p> <p><i>Ref.1. Ligji i IAL-së.pdf</i></p> <p><i>Ref. 7. Statuti i UST, Urdhër MAS, Nr. 124, dt 29.05.2020, Nr.11053 Prot</i></p> <p><i>Ref.8. SBC.pdf; Neni 27-Komunikimi dhe publikimi I rezultateve të monitorimit, vlerësimit dhe akreditimit ; Kreu III: Standarte për sigurimin e brendshëm të cilësisë; Kreu V: Fusha dhe qasje të vlerësimeve në kuadër të sigurimit të cilësisë, pika 1,2,3,4,5;</i></p> <p><i>Ref. 15. Raporti i Departamentit, Vlerësimi i programit.pdf</i></p> <p><i>Ref.29. Pyetesori i studeteve.pdf</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <p><i>UST harton dhe zbaton politika të ndryshme me anë të rregulloreve të ndryshme, UST përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse</i></p>

	<i>dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve, të cilat kontrollohen nga NJSBC dhe që janë të përshkruara dhe në syllabuset e lëndëve përkatëse, të cilat janë miratuar paraprakisht nga institucioni. IAL harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>GVJ nga takimi me përfaqësues të institucionit konkludon se UST ka të ngritur institucione që mbulojnë aspektet kurrikulare, drejtoria përkatëse dhe ato të sigurimit të cilësisë, në zbatim të akteve ligjore e nënligjore aktualisht në fuqi, Statutit të UST dhe rregulloreve të Institucionit.</p> <p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë monitoron dhe vlerëson këto programe studimi që ofron UST, dhe bën ndryshime të herpashershme sipas udhëzimeve të MAS, cdo vit 20 %, duke e përshtatur kurrikulën me sygjerimet e pedagogëve të lëndëve, kurrikulat homolog ndërkombëtare, por gjithmon duke ruajtur raportet midis lëndëve sipas Udhëzimit Nr.41 I MAS datë, 24/01/2018. UST përdor mekanizma të drejtpërdrejta si dhe instrumente të ndryshme, sipas specifikës së fushës akademike të programit të studimit për të mbikëqyrur ecurinë dhe plotësimin e objektivave të programit si: monitorimi ne elementëve të lidhur me proceset akademike si provimet, syllabuset, literatura e përdorur, etj. Një vend të veçantë zë dhe përfshirja e studentëve në këto procese. Në NJSBC ka një përfaqësues të Këshillit të studentëve. Instrumentët kryesorë, që përdoren për përfshirjen e studentëve janë edhe zhvillimi i pyetësorëve online, focus-grupet, mbledhjet e hapura të departamenteve, etj. Rezultatet e vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit, përpilohen në formë dokumenti dhe u bëhen</p>

	<p>të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse, sikurse edhe titullarit të lëndës, përgjegjësve të grup-lëndëve, përgjegjësit të departamentit, për të evidentuar arritjet apo dobësitë e vërejtura për programin për vendimmarrje të mëtejshme.</p> <p><i>Ref.1. Ligji i IAL-së.pdf</i></p> <p><i>Ref. 7. Statuti i UST, Urdhër MAS, Nr. 124, dt 29.05.2020, Nr.11053 Prot;</i></p> <p><i>Ref.8. SBC.pdf; Neni 27-Komunikimi dhe publikimi I rezultateve të monitorimit, vlerësimit dhe akreditimit ; Kreu III: Standarte për sigurimin e brendshëm të cilësisë</i></p> <p><i>Ref. 15. Raporti i Departamentit, Vlerësimi i programit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Në takimin me përfaqësues të insitucionit dhe dokumentat e vëna në dispozicion GVJ mendon se NJSBC përgatit dhe shpërndan një analizë të vlerësimeve periodike institucionale përmes anketimeve me pyetësorë dhe fokus grupe, i cili u vihet në dispozicion Rektorit si raport vjetor.</p> <p>Në përpilimin e këtij raporti vjetor cdo strukturat drejtuese institucionale shpreh dhe raporton mbi aktivitetin e tij, në nivel departamenti, në nivel fakulteti dhe në nivel rektorati dhe më pas paraqitet në senat. Raportet e vlerësimit të NJSBC përfshijnë rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim shkencor për stafin akademik dhe studentët. Studentët shprehin mendimin e tyre në sondazhe, intervista të dryshme të realizuara nga Zyra e Karrierës dhe Alumni, apo nga e punëdhënësve të ndryshëm. Instrumentet kryesor që përdoren për përfshirjen e studentëve janë edhe zhvillimi i pyetësorëve online, fokus grupet, mbledhjet e hapura të departamenteve.</p> <p><i>Ref. 7. Statuti i UST, Urdhër MAS, Nr. 124, dt 29.05.2020, Nr.11053 Prot;</i></p> <p><i>Ref.8. SBC.pdf; Neni 27-Komunikimi dhe publikimi I rezultateve të monitorimit, vlerësimit dhe akreditimit; Neni 28: Përdorimi I të dhënave të monitorimit dhe të vlerësimit, pika 1,a,b,c,d,e.</i></p> <p><i>Kreu III: Standarte për sigurimin e brendshëm të cilësisë</i></p> <p><i>Ref. 15. Raporti i Departamentit, Vlerësimi i programit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>

Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.

GVJ konstaton se UST për mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit MP në "Trajner i Përgatitjes Fizike", ka në përdorim dhe funksionon në bazë të legjislacionit në fuqi dhe rregulloreve të brendshme institucionale, rregullore e funksionimit të senatit, rregullore programeve të studimit, rregullore e funksionimit të NJSBC, sekretarisë, bibliotekës etj. Në aktet e brendshme rregullatore, ka të përcaktuar qartë metodat kryesore që përdoren për vlerësimin zhvillimit të programit të studimit dhe ecurinë e studentëve nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre dhe në fund, daljen në tregun e punës. Në rregulloren e programit të studimit, rregulloren e fakultetit shprehet qartë se në vlerësimin e studentëve institucioni përdor: Teste të standardizuara; Dëgjime në auditor; vlerësimi me pikë (në provimet e ndërmjetëme dhe provimin përfundimtar) korrigjimi elektronik për pyetjet me alternativa (clean score). Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module sipas programit të studimit dhe syllabuseve të lëndëve.

Vlerësimi praktik me gojë dhe me shkrim, vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët që përbëjnë detyrim të vlerësimit të lëndës sipas syllabusit; mbikqyrja e studentëve gjatë kryerjes së ushtrimeve, praktikës laboratorike. Kontrolltetë herë pas hershme të zbatimit të kurrikulës dhe për realizimin e programeve, syllabuseve sipas modelit të miratuar. Për stafin akademik të kategorisë Lektor dhe Asistent Lektor, zhvillohen dhe vëzhgime në auditor nga eprori ;Përgjegjës departamenti, Dekani gjatë zhvillimit të një ore mësimi. Ky proces përfundon me plotësimin e një raporti vlerësimi. Në kushtet e përdorimit të platformave on line si Sistemi i Pitagorës, UST monitoron zhvillimin e leksioneve dhe seminareve, praktikave etj, e cila është mundësuar nga Zyra e IT në UST. IT në mënyrë të periodike nëpërmjet raporteve paraqet prezencën në mësim, mbi kohëzgjatjen e orëve mësimore, etj. Lidhur me cilësinë dhe metodologjitë e mësimdhënies, orët mësimore monitorohen nga Përgjegjësi i Departamentit në auditore, laboratore. GVJ konstaton se këto metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës bëhen dy herë në vit edhe me pyetësorët anonym. Për cdo konstatim ka një raport mbi këto vlerësime. Nga mbledhja e të dhënave nuk ka ndonjë rast konkret për tu tërhequr vëmendje.

Ref.1. Ligji i IAL-së.pdf

Ref. 3. Rregullore e UST-së.pdf

	<p><i>Ref.4. Rregullore E FSHL-së.pdf</i></p> <p><i>Ref.5. Rregullore e Departamentit të Sporteve Individuale.pdf</i></p> <p><i>Ref. 6. Rregullore e Programit të Studimit.pdf</i></p> <p><i>Ref.7. Programi i Studimit MPTPF.pdf</i></p> <p><i>Ref. 7. Statuti i UST, Urdhër MAS, Nr. 124, dt 29.05.2020, Nr.11053 Prot;</i></p> <p><i>Ref.8. SBC.pdf; Neni 27-Komunikimi dhe publikimi I rezultateve të monitorimit, vlerësimit dhe akreditimit ; Kreu III: Standarte për sigurimin e brendshëm të cilësisë</i></p> <p><i>Ref. 15. Raporti i Departamentit, Vlerësimi i programit.pdf</i></p> <p><i>Ref. 20. Tabelat përmbledhëse.pdf ,Tab.9 Plani mësimor sipas veprimtarive (A-E)</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion , takimit me stafin, studentët, NJSBC si dhe RVB, konstaton se pranë UST është ngritur dhe funksionon Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të cilësisë, e cila në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetësorët institucionalë për matjen e performancës. GVJ sic është shprehur edhe në kriteret e mësipërme konstaton se UST, ka zhvilluar auditim të brendshëm periodik të institucionit me anë të pyetësorëve anketues me studentë me qëllim përmirësimin e procesit të vlerësimit të studentëve në programe specifike. Metodat e përdorura përfshijnë: Sondazhe të fokus grupeve të studentëve që ndjekin programin e studimit, Vlerësimi me anë të pyetësorëve anonim të didaktikës mesimdhënëse, kurrikulës etj, provime me pyetje konceptuale dhe alternativa; Vlerësimi me pikë me anë testimeve dhe të sistemit Clean Score; Teste të ndërmjetëm dhe përfundimtar; provime për module të caktuara sipas syllabuseve të lëndëve; Vlerësimi i të detyrave të kursit, punëve individuale dhe punëve në grup/detyrave/projekteve që kryhen nga studentët. Të gjitha këto metoda të vlerësimit sondazhe e intervista të studentëve bazohen në rregullore të brendshme institucionale dhe syllabuset e lëndëve përkatëse të programit të studimit së programit të studimit. Metoda të vlerësimit për stafin akademik janë zhvilluar kontrolle të ndryshme në mënyrë periodike dhe sistematike nga eprori përgjegjësi njësisë bazë, dekani, zv. dekani, observim i një ore mësimore në auditor, orëve praktike në laborator dhe orëve të lëndës praktikë që zhvillohen jashtë institucionit me institucionet me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi. Rezultatet e tyre i vë në dispozicion</p>

	<p>të drejtuesëve të institucionit, të fakulteteve si dhe reflektohen në vlerësimin e performancës vjetore të çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik. Kujdes i kushtohet intervistave me studentët, gjatë shqyrtimit të performancës së stafit akademik dhe ndihmës akademik për të bërë në fund një raport periodik mbi konstatimet e gjetura gjatë vlerësimit të programit të studimit.</p> <p><i>Ref.1. Ligji i IAL-së.pdf</i> <i>Ref. 3. Rregullore e UST-së.pdf</i> <i>Ref.4. Rregullore E FSHL-së.pdf</i> <i>Ref.5. Rregullore e Departamentit të Sporteve Individuale.pdf</i> <i>Ref. 6. Rregullore e Programit të Studimit.pdf</i> <i>Ref.7. Programi i Studimit MPTPF.pdf</i> <i>Ref. 7. Statuti i UST, Urdhër MAS, Nr. 124, dt 29.05.2020, Nr.11053 Prot;</i> <i>Ref.8. SBC.pdf; Neni 27-Komunikimi dhe publikimi I rezultateve të monitorimit, vlerësimit dhe akreditimit ; Kreu III: Standarte për sigurimin e brendshëm të cilësisë</i> <i>Ref. 15. Raporti i Departamentit, Vlerësimi i programit.pdf</i> <i>Ref. 20. Tabelat përmbledhëse.pdf ,Tab.9 Plani mësimor sipas veprimtarive (A-E)</i> <i>Vizita në institucion</i></p>						
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <p><i>UST ka të ngritur struktura që mbulojnë aspektet kurrikulare, drejtoria përkatëse dhe ato të sigurimit të cilësisë, në zbatim të akteve ligjore e nënligjore aktualisht në fuqi, Statutit të UST dhe rregulloreve të Institucionit.</i></p> <p><i>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë monitoron dhe vlerëson këto programe, dhe bën ndryshime të herpashershme sipas udhëzimeve të MAS, cdo vit 20 %, duke e përshtatur kurrikulën me sygjerimet e pedagogëve të lëndëve, kurrikulat homologe ndërkombëtare, por gjithmon duke ruajtur raportet midis lëndëve sipas Udhëzimit Nr.41 I MAS datë , 24/01/2018</i></p>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="598 1769 821 1870">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="821 1769 1029 1870">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1029 1769 1252 1870">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="598 1870 821 1933"></td> <td data-bbox="821 1870 1029 1933"></td> <td data-bbox="1029 1870 1252 1933" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion si rregulloreve të brendshme institucionale, rregullore e funksionimit të senatit, rregullore e programeve të studimit, rregullore e funksionimit të NJSBC, sekretarisë, bibliotekës konstaton se me anë të tyre përcaktohet roli i strukturave akademike dhe administrative si dhe roli i Senatit Akademik lidhur me sigurimin e Cilësisë. Një nga këto politika, është ngritja pranë departamenteve e organeve këshilluese të Bordeve të Tregut të Punës. Po ashtu, përfshirja dhe angazhimi në NJSBC i një eksperti të jashtëmi, i cili i përgjigjet nevojës së Universitetit për t'u konsultuar me aktorë të jashtëm.</p> <p>Gjatë periudhës 2018-2022, UST ka arritur të sigurojë përfshirjen si partner në projekte europiane që kanë në fokus sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë. Aspektet pozitive në këto projekte lidhen me shkëmbimin e përvojave, trajnimet dhe vizitat studimore, sikurse dhe me rishikimin e akteve rregullatore, metodologjisë dhe instrumenteve për monitorimin dhe vlerësimin e proceseve në funksion të brendshëm të cilësisë në UST. GVJ në takimin me stafin akademik dhe drejtues të institucionit u informua se UST, ka patur shkëmbime të stafit akademik dhe administrativ me focus në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe trajnime të ndryshme, në kuadër të projektit Erasmus+.</p> <p>Gjithashtu në takim me drejtues të institucionit ,GVJ u informua se UST ka marrëveshje bashkëpunimi refruar, me institucione të arsimit të lartë, që operojnë në fusha të njëjta apo të ngjashme me UST, me Federata sportive të ndryshme kombëtare, KOKSH, specifikisht për këtë program studimi me FSHF, me përfaqësues biznesi e kompani që operojnë brenda fushave, me të cilët UST bashkëpunon në përshtatje me natyrën e programit të studimit.</p> <p><i>Ref.1. Ligji i IAL-së.pdf</i></p> <p><i>Ref. 3. Rregullore e UST-së.pdf</i></p> <p><i>Ref.4. Rregullore E FSHL-së.pdf</i></p> <p><i>Ref.5. Rregullore e Departamentit të Sporteve Individuale.pdf</i></p>

	<p><i>Ref. 6. Rregullore e Programit të Studimit.pdf</i></p> <p><i>Ref.7. Programi i Studimit MPTPF.pdf</i></p> <p><i>Ref. 27. Statuti i UST, Urdhër MAS, Nr. 124, dt 29.05.2020, Nr.11053 Prot;</i></p> <p><i>Ref.8. SBC.pdf;</i></p> <p><i>Ref. 20. Tabelat përmbledhëse.pdf ,Tab.5 Institucionet dhe organizata bashkëpunuese</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në takimin e realizuar me stafin dhe Studentët ,GVJ u informua se studentët përfshihen në vlerësimin periodik institucional përmes anketimit, dhe forumeve të debatit me koordinatorin e programit të studimit apo me stafin pedagogjik. GVJ në takimin me GVB, u informua se pjesë e këtij grup vlerësimi të brendshëm ishte dhe një student i programit të studimit. Stafi akademik dhe studentët me anë të senatorit të tyre të zgjedhur nga qeveria studentore në UST, janë pjesë aktive dhe përfshihen në vendimmarrje të ndryshme institucionale të UST, përmes përfaqësuesve të tyre në Senatin Akademik, dhe në Komisionin e Etikës, si dhe përfaqësisë në NJSBC. Gjithashtu, përgjegjësitë, detyrat e NJSBC janë të përcaktuara në aktet rregullatore të institucionit. Sigurimi i brendshëm i cilësisë së programit të studimit siguron harmonizimin e veprimtarisë së të gjithë strukturave drejtuese, sigurimin e burimeve njerëzore dhe infrastrukturës për cilësinë e programit të studimit si dhe përcaktimin e parimeve, standarteve dhe procedurave të përshtatshme për monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë.</p> <p><i>Ref. 3. Rregullore e UST-së.pdf</i></p> <p><i>Ref.4. Rregullore E FSHL-së.pdf</i></p> <p><i>Ref.5. Rregullore e Departamentit të Sporteve Individuale.pdf</i></p> <p><i>Ref. 6. Rregullore e Programit të Studimit.pdf</i></p> <p><i>Ref. 27. Statuti i UST, Urdhër MAS, Nr. 124, dt 29.05.2020, Nr.11053 Prot;</i></p> <p><i>Ref.8. SBC.pdf; Kreu IV. Qëllimi I sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë.</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të</p>	<p>GVJ, gjatë vizitës në institucion dhe bisedave të zhvilluara, me drejtues, stafin akademik, studentët konstaton dhe mund të pohojmë një gjithëpërfshirje në procesin e veprimtarisë së NJSBC të</p>

<p>garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>pedagogëve, stafit administrativ, të cilët organizohen në mbledhje të vazhdueshme mujore të Departamentit si hallka e parë e shprehjes së nevojave për përmirësime apo ndryshime në programet e studimit, të cilat më pas paraqiten në dekanat dhe dekanati më pas i përcjell në Rektorat dhe Senat. Gjatë takimeve të realizuara në UST, GVJ vren një frymë bashkëpunimi dhe mirëkuptimi midis drejtuesve institucional dhe midis stafit akademik dhe bashkëpunimit me qeverinë studentore, për mbarëvajtjen e procesit mësimorë, përmirësimin e tij dhe rritjen, motivimin e kërkimit shkencor në bazë të institucionit. Aktualisht si përfaqesues i FSHR-së është një anëtar, i cili është përgjegjës për mbarëvajtjen e sigurimit të cilësisë, për përgatitjen e raporteve dhe bashkëpunimin me NJSBC-në e UST.</p> <p><i>Ref.1. Ligji i IAL-së.pdf</i></p> <p><i>Ref.2.Raporti i vlerësimit të Brendshëm Periodik.pdf</i></p> <p><i>Ref. 28. Statuti i UST-së.pdf;</i></p> <p><i>Ref. 27. Statuti i UST, Urdhër MAS, Nr. 124, dt 29.05.2020, Nr.11053 Prot</i></p> <p><i>Ref.8. SBC.pdf; Kreu III, Neni 19, 20</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ, sic është shprehur dhe më lart, mendon se UST është i angazhuar në respektimin e integritetit akademik dhe në shmangien e çdo diskriminimi apo pabarazie të të gjithë palëve në këtë proces vlerësimi. Përzgjedhje e aktorëve të brendshëm në proceset periodike të vlerësimit bëhet nga personeli akademik ku merren parasysh disa kriteret të përfshirjes si, performanca akademike, integriteti, kompetencat profesionale; mundësitë për grumbullimin e informacionit dhe përpunimin e tij me qëllim realizimin e vlerësimeve të ndryshme. Procesi i vlerësimit zhvillohet duke respektuar Kodin e Etikës. Për të siguruar përfshirjen e plotë të stafit në përmirësimin e cilësisë së programit, UST ka krijuar grupet e punës për mbarëvajtjen në drejtim të kurrikulës, veprimtarisë shkencore dhe vëmendjes ndaj studentëve. Në raportet vlerësimit akademik GVJ nuk vuri re ndonjë pabarazi apo diskriminim të stafit akademik, ndihmës akademik apo të studentëve.</p> <p><i>Ref .3. Rregullore e UST-së.pdf</i></p> <p><i>Ref. 4. Rregullore E FSHL-së.pdf</i></p> <p><i>Ref.5. Rregullore e Departamentit të Sporteve Individuale.pdf</i></p> <p><i>Ref.6. Rregullore e Programit të Studimit.pdf</i></p>

	<p><i>Ref.7. Programi i Studimit MPTPF.pdf</i></p> <p><i>Ref.8. SBC.pdf Kreu V, Politika për sigurimin e cilësisë (Fusha dhe qasje të vlerësimeve në kuadër të sigurimit të cilësisë</i></p> <p><i>Ref. 27. Statuti i UST, Urdhër MAS, Nr. 124, dt 29.05.2020, Nr.11053 Prot</i></p> <p><i>Ref.8. SBC.pdf; Kreu III, Neni 19, 20</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>GVJ bazuar në referencat e vëna në dispozicion si dhe takimin me drejtues të institucionit si dhe NJSBC , konstoi se struktura e NJSBC është ndryshuar në vitin 2021 me vendim Senati duke patur në përbërje 7 anëtar (1 Kryetari, 2 përfaqësues nga FSHL, 2 nga FVFR, 1 nga IKSHS dhe 1 përfaqësues i studentëve) dhe një ekspert I jashtëm. Përbërja e NJSBC është arritja e objektivave strategjike në përputhje me vizionin dhe misionin e institucionit. NJSBC funksionon në bazë Rregullore per Sigurimin e Cilesise; legjislacionit në fuqi, si dhe rregulloreve të brendëshme të UST dhe Statutit të UST. Nisur nga struktura dhe Rregullore për Sigurimin e Cilësisë, GVJ mendon se UST, përveç vlerësimit të brendshëm periodik, element tjetër i sigurimit të cilësisë është dhe prania e ekspertit të jashtëm si konsulent po ashtu dhe vlerësimi i jashtëm i cili koordinohet nga ASCAL shërben për sigurimin të cilësisë, në lidhje me programin e studimit. Ky vlerësim kryhet nëpërmjet hartimit të raporteve të vlerësimit të brendshëm, dhe më pas nga GVJ me anë të RVJ, pasqyrohet gjendja aktuale dhe jepen rekomandime me qëllim përmirësim të përmbushjes së standardeve të cilësisë.</p> <p>Po ashtu UST është e hapur dhe shumë aktive për angazhimin e ekspertëve të jashtëm të cilët mund të japin ekspertizën dhe mendimet e tyre në bashkëpunim me strukturën e NJSBC-së, por edhe takime me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtare janë element që lidhen ngushtë me sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p><i>Ref .3. Rregullore e UST-së.pdf</i></p> <p><i>Ref. 4. Rregullore E FSHL-së.pdf</i></p> <p><i>Ref.5. Rregullore e Departamentit të Sporteve Individuale.pdf</i></p> <p><i>Ref.6. Rregullore e Programit të Studimit.pdf</i></p> <p><i>Ref.8. SBC.pdf Kreu III, Neni 19, 20, Kreu V, Politika për sigurimin e cilësisë (Fusha dhe qasje të vlerësimeve në kuadër të sigurimit të cilësisë</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p>

	<i>UST i përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët, ekspert të jashtëm, në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>GVJ konstatoi seaktiviteti, programe, rregullore të ndryshme të funksionimit të UST janë të aksesueshëm nga i gjithë stafi akademik, ndihmës-akademik dhe studentët çdo informacion në lidhje me politikat dhe praktikat që lidhen me sigurimin e Cilësisë në UST. Këto të dhëna janë transparente dhe publike për të gjithë palët e interesuara. https://ust.edu.al/veprimtaria-dhe-aktivitetet-njesia-a-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise/</p> <p>NJSBC-ja në bashkëpunim edhe me Zyrë e Këshillimit dhe Karrierës e zhvillon të organizuar sipas një planifikimi periodik, të përvitshëm, monitorimet në sektorët apo proceset që i nënshtrohen vlerësimit e që shoqërohen me raportet e detajuara vjetore dhe raportet përmbledhëse me gjetjet përkatëse dhe planin e masave dhe të rekomandimeve për përmirësim në vitet pasardhëse akademike.</p> <p><i>Ref.8. SBC.pdf Kreu III, Neni 19, 20, Kreu V, Politika për sigurimin e cilësisë (Fusha dhe qasje të vlerësimeve në kuadër të sigurimit të cilësisë)</i></p> <p><i>Ref.2. Raporti i vlerësimit të Brendshëm Periodik.pdf</i></p> <p><i>Ref. 28. Statuti i UST-së.pdf;</i></p> <p><i>Ref. 27. Statuti i UST, Urdhër MAS, Nr. 124, dt 29.05.2020, Nr.11053 Prot</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e</p>	<p>GVJ nga kontakti me përfaqësues të institucionit dhe shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar prej UST konstaton se institucioni</p>

vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.

respekton lirinë dhe etikën akademike dhe po ashtu të dhënat personale. UST ka të miratuara rregullore të funksionimit të programeve si dhe për ruajtjen e të dhënave ku përcaktohet detyrimi për mbrojtjen e të dhënave. Në faqen eeb publikohen të gjitha politikat dhe praktikat e sigurimit të cilësisë të cilat janë të aksesueshme për të gjithë. Në takim me drejtues të institucionit sic jemi shprehur dhe në standartet e mësipërme, GVJ u informuam se, NJSBC kryhen në mënyrë periodike shpërndarjen e pyetësorëve për të cilët është punuar edhe menduar që të jenë të personalizuar dhe të detajuar për secilën lëndë, modul dhe me emër mbiemër të lektorit, pedagog përkatës. Ato shpërndahen në mënyrë elektronike anonime me link dhe ose me fletë për secilin semester përpara fillimit të sezonit të provimeve. Informacioni i mbledhur i vihet në dispozicion drejtuesve të njësive bazë. Institucioni me qëllim respektimin e lirisë dhe etikës akademike, bazuar në legjislacionin në fuqi, kujdeset për ruajtjen e të dhënave personale dhe garanton të drejtat njëkohësisht edhe detyrimet e palëve. Në çdo rast publikimet mbi rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit monitorohen nga përfaqësuesi i Komisionerit për të dhënat personale duke zbatuar politikat e privatësisë – UST; Rregullores për mbrojtjen e të dhënave personale; Rregullores së Universitetit të Sporteve, Këshilli i Etikës.

Ref.3. Rregullore e UST-së.pdf

Ref. 4. Rregullore e FSHL-së.pdf

Ref.5. Rregullore e Departamentit të Sporteve Individuale.pdf

Ref.6. Rregullore e Programit të Studimit.pdf

Ref.8. SBC.pdf

Ref. 28. Statuti i UST-së.pdf

Vizita në institucion

Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.

Analiza e raporteve vjetore të vlerësimit krahas konstatimeve që vihen re përcaktohen dhe plani për plotësimin e rekomandimeve dhe ndjekjen e udhëzimeve për veprimet e marra. GVJ , në raportin vjetor të vlerësimit vren se masat, që synojnë përmirësimin e elementëve të evidentuara për rishikim, dokumentohen në formën e planeve të masave me qëllim përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë. Në zbatim të rekomandimeve angazhohet stafi akademik dhe ai ndihmës akademik. Disa nga aktivitetet e realizuara nga UST, që GVJ konstatoi në takimin me stafin dhe dokumentat e vëna në

	<p>dispozicion dhe që ne mendojmë se ndihmojnë për përmirësimin e cilësisë janë: Pjesëmarrja dhe organizim i aktiviteteve, konferencave shkencore me partnerë ndërkombëtarë;</p> <p>Zhvillimin e trajnimeve të vazhdueshme kryesisht në aspektet didaktike të mësimdhënies dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Mbështetja e stafit akademik, studentëve në aktivitete të ndryshme kërkimore shkencore, projekte brenda dhe jashtë vendit duke ju mbuluar institucioni Fee -n e pjesmarrjes;</p> <p>Leksionet e hapura nga ekspertë të fushës së rehabilitimit të realizuara në institucion; Ëorkshope të shumta me studentët e UST; bashkëpunimi ndërkombëtar në kuadër të shkëmbimit të stafit nëpërmjet përfshirjes në programin Erasmus+.</p> <p>Mbajtja e takimeve periodike orientuese dhe me diskutime të hapura për studentët (Orientim mbi praktikën profesionale, metodat e përgatitjes për trajner, nga staf akademik profesionist për programin e studimit Master Profesional në “Trajner i Përgatitjes Fizike” .</p> <p><i>Ref.1. Ligji i IAL-së.pdf</i></p> <p><i>Ref. 3. Rregullore e UST-së.pdf</i></p> <p><i>Ref.4. Rregullore E FSHL-së.pdf</i></p> <p><i>Ref. 6. Rregullore e Programit të Studimit.pdf</i></p> <p><i>Ref. 27. Statuti i UST, Urdhër MAS, Nr. 124, dt 29.05.2020, Nr.11053 Prot;</i></p> <p><i>Ref. 20. Tabelat përmbledhëse. pdf, Tab.5 Institucionet dhe organizata bashkëpunuese.</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konkludon në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga institucioni se, UST vlerëson dhe përpiqet për efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive të ndryshme në UST, për monitorimin e cilësisë me qëllim përmirësimin e programit të studimit. Konkretisht, GVJ u informua në takimin me drejtues të institucionit se cdo vit realizohet analiza e punës mësimore e cila shoqërohet nëpërmjet “kontrollit të kryqëzuar” (cross-check) që implementohet nga struktura dhe aktorë të brendshëm në UST, duke filluar nga njësitë bazë nëpërmjet drejtuesit të departamentit, përgjegjësit të grup-lëndëve, koordinatorit të programit, te strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional, Zyra e Kurrikulave,</p>

	<p>Zyra e Standardeve dhe Cilësisë e Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p> <p><i>Ref.3. Rregullore e UST-së.pdf</i></p> <p><i>Ref. 4. Rregullore e FSHL-së.pdf</i></p> <p><i>Ref.5. Rregullore e Departamentit të Sporteve Individuale.pdf</i></p> <p><i>Ref.6. Rregullore e Programit të Studimit.pdf</i></p> <p><i>Ref.8. SBC.pdf</i></p> <p><i>Ref. 28. Statuti i UST-së.pdf</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni i UST, sic GVJ është shprehur dhe në kriteret e mësipërme, në mënyrë periodike, vjetore apo semestrale, organizon veprimtarin informuese si për studentët ashtu edhe për personelin akademik në kuadër të rritjes së cilësisë në mësimdhënie, kërkim shkencor, përmirësim të programit të studimit, përmirësimin e infrastrukturës mësimore dhe në tërësi për të gjitha shërbimet e ofruara nga UST. Gjatë takimeve me studentët u konstatua se ata marrin pjesë në trajnime, veprimtari kërkimore e shkencore, konferenca studentore, takimet me përfaqësues të ASCAL-it, etj. Këto veprimtari janë të pasqyruara në faqen zyrtare të UST duke nisur nga rregullore të ndryshme të UST, program mësimor dhe aktivitete të ndryshme të organizuara nga institucioni.</p> <p><i>Ref.3. Rregullore e UST-së.pdf</i></p> <p><i>Ref. 4. Rregullore e FSHL-së.pdf</i></p> <p><i>Ref.6. Rregullore e Programit të Studimit.pdf</i></p> <p><i>Ref.8. SBC.pdf</i></p> <p><i>Ref. 15. Raporti i Departamentit, Vlerësimi i programit.pdf</i></p> <p><i>Ref. 28. Statuti i UST-së.pdf</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <p><i>UST vlerëson dhe përpiqet për refektivitetin dhe impaktin e veprimtarive për monitorimin e cilësisë me qëllim përmirësimin e programit të studimit, shërbimeve dhe performances së personelit akademik e ndihmës akademik.</i></p> <p><i>NJSBC vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore të UST e për këtë harton raporte të përkatëse të Vlerësimit të Brendshëm. Raportet të përkatëse , u bëhen</i></p>

	<i>të njohura strukturave përgjegjëse të Institucionit, janë transparente dhe efektive, dhe synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në:
“Trajner i Përgatitjes Fizike”**

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Personeli akademik cilësor i angazhuar në mësimdhënie ka grada e tituj, konform përcaktimeve ligjore, dhe staf pedagogjik me eksperiencë në mësimdhënie dhe me trajnime përkatëse në përputhje me programin e studimit Master Profesional në “Trajner i Përgatitjes Fizike”;
2. Mësimdhënia e mbështetur në metoda bashkëkohore dhe sistem e-learning në shërbim të studentëve dhe personelit akademik, sistemi Pitagora dhe TEAMS;
3. Përdorimi i literaturës së 5 viteve të fundit nga publikimet e shtëpive botuese prestigjioze si: Human Kinetics ,Pubmed, EBSCO, Mc Graë -Hill, Sage, Elsevier, Pearson etj;
4. Infrastruktura e laboratorëve për një proces mësimor sa më cilësor për studentët e Nivelit të Dytë Master Profesional në “Trajner i Përgatitjes Fizike”;
5. Marrëveshjet bashkëpunimi me institucionet të ndryshme për realizimin e praktikave pranë qendrave të fitnesitsi dhe marrëveshja e bashkëpunimit me Federatën e Futbollit Shqipëtar;
6. Licensimi i studentëve nga Federata e Futbollit Shqipëtar;
7. Mbështetja institucionale dhe trajnimi i vazhdueshëm i personelit akademik për mësimdhënie bashkëkohore si dhe për kërkimin shkencor;

b. Pika të dobta:

1. Mungesa e lëndës/modulit Praktikë profesionale në programin e studimit Master Profesional në "Trajner i Përgatitjes Fizike"(praktikat janë vetëm praktika lëndore); (*Standarti II.1 ,Kriteri 3; Standarti III.1 , Kriteri 1; Standarti III.6 , Kriteri 3;*)
2. Numri i vogël i studentëve, 18 student nga 80 kuota të kërkuara; (*Standarti V.1 Kriteri 6;*)

Rekomandime

1. Sygjerohet që në kuadër të ndryshimeve që lejon ligji për riorganizimin e programit mësimor (20%) , të përfshihet edhe lënda/moduli i praktikës profesionale,si modul me vete;
2. Sygjerohet një rishpërndarje të ngarkesës mësimore sipas ligjeve në fuqi për të gjithë stafin akademik duke ulur mbingarkesën;
3. Të punohet më shumë,për marketingun e kësaj diplome, për të rritur numrin e studentëve sipas kuotave të kërkuara, jo vetëm në numër por dhe si cilësi (notë mesatare të lartë, njohuri më të mira të gjuhës së huaj);

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Professional Master in: "Physical Training Trainer"

a. Strengths and affirmations:


1. The quality academic personnel engaged in teaching have ranks and titles, in accordance with legal provisions, and pedagogical staff with experience in teaching and relevant training in accordance with the Professional Master's study program in "Physical Preparation Coach";
2. Teaching based on contemporary methods and e-learning system at the service of students and academic staff, Pitagora and TEAMS system;
3. Using the literature of the last 5 years from the publications of prestigious publishing houses: Human Kinetics, Pubmed, EBSCO, Mc Graë-Hill, Sage, Elsevier, Pearson, etc;
4. Laboratory infrastructure for a higher quality learning process for students of the Second Level Professional Master in "Physical Preparation Coach";
5. Cooperation agreements with various institutions for the implementation of practices near fitness centers and the cooperation agreement with the Albanian Football Federation;
6. Licensing of students from the Albanian Football Federation;
7. Institutional support and continuous training of academic staff for contemporary teaching as well as for scientific research;

b. Weaknesses:

1. Absence of the subject/module Professional practice in the Professional Master's study program in "Physical Preparation Trainer" (practices are only subject practices); (*Standard II.1, Criterion 3; Standard III.1, Criterion 1; Standard III.6, Criterion 3*)
2. The small number of students, 18 students out of 80 requested quotas; (*Standard V.1 Criterion 6*)

Recommendation

1. We suggest that within the framework of the changes allowed by the law for the reorganization of the teaching program (20%), the professional practice module/module should also be included;
2. We suggest a redistribution of the teaching load according to the laws in force for all academic staff, reducing the overload;
3. More work should be done on the marketing of this degree, to increase the number of students according to the requested quotas, not only in number but also in quality (higher average swimming, better foreign language knowledge);



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përbushen pjesësisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X